L. Selinker<sup>13</sup> vendosi termin *ndërgjuhë* (“*interlanguage*”) për sistemin gjuhësor të përdorur nga nxënësi në çdo moment të procesit të të mësuarit / përvetësimit kur përpitet të komunikojë në GJ2. Autorë të tjerë si S. P. Corder<sup>14</sup> dhe W. Nemser<sup>15</sup> i referohen të njëjtë koncept përkatësisht me terma si *dialekti idiosinkratik* (“*idiosyncratic dialect*”) dhe *sistemi përafrues* (“*approximative system*”) Sidoqoftë, është termi i Selinker që hyn në përdorim të zakonshëm, ndoshta për shkak të qëndrimit neutral që përfaqëson në lidhje me gjuhën mëmë.

Sipas Ana Isabel Blaco Picado<sup>16</sup>, ndërgjuha është motori i vërtetë i procesit të të mësuarit, dhe për këtë arsyе vjen edhe vlerësimi pozitiv për gabimin. Gabimi është një

11 Sánchez Iglesias, J. J. *Errores, corrección y fosilización en la didáctica de lenguas afines: Análisis de errores en la expresión escrita de estudiantes italianos de E/LE*. Salamanca, Universidad de Salamanca, 2004, f.101.

12 Fernández, Sonsoles. *Interlengua y Análisis de Errores en el aprendizaje del español como lengua extranjera*, Madrid, Edelsa, 1997, f. 50.

13 Sánchez Iglesias, J. J. *Errores, corrección y fosilización en la didáctica de lenguas afines: Análisis de errores en la expresión escrita de estudiantes italianos de E/LE*. Salamanca, Universidad de Salamanca, 2004, f.58.

14 Po aty, f. 41.

15 Ellis, R. “The study of second language acquisition.” Oxford, OUP, 1994, f. 315.

16 Ana Isabel Blanco Picado, El error en el proceso de aprendizaje, “Cuaderno Cervantes” Época II – Año III/2012

---

mekanizëm i domosdoshëm që të ndodhë procesi i të nxënësit. Dhe po e njëjta studiuese vazhdon: *ndërgjuha* ka një karakter kalimtar, por edhe sistematik në secilën fazë të saj. Që këtej rrjedh rëndësia e analizës së karakteristikave të ndërgjuhës së nxënësve tanë. Rol i ynë si mësimdhënës në këtë proces është të ndihmojmë që sistemi personal të afrohet gjithnjë e më shumë me atë të gjuhës objektiv.

Nëse gabimet zbulojnë strategjitë e të mësuarit ose të komunikimit që nxënësi përdor në prodhimet e tij, këto strategji kanë të bëjnë me një seri mekanizmash që ai i vë në praktikë dhe që karakterizojnë ndërgjuhën e tij<sup>17</sup>. Këto dukuri janë:

**Thjeshtëzimi:** strategjitë e nxënësve ndryshojnë nga njëri te tjetri, por të gjithë tentojnë ta kufizojnë gjuhën në një sistem të thjeshtë, duke eliminuar elementet redundante, siç është rasti i nyjës shquese.

1. *Tirana y Durrës son ciudades albanesa (s)*
2. *(Las) Mujeres tienen muchos problemas*
3. *Fuerte(s) golpes.*
4. *el fin de(l) día*
5. *pantalones cort(a)s*

Nxënësit kanë brendësuar dallimin njëjës / shumës në sistemin e ndërgjuhës së tyre dhe nuk e përdorin atë. Ata gjithashtu dinë për ekzistencën e nyjes dhe as nuk e përdorin atë. Pra janë gabime prodhimi.

**Mbipërgjithësimi:** shtrirja e rregullave të mësuara nga modele gjuhësore me të cilat ka qenë në kontakt, në fushat në të cilat ato nuk janë të pranueshme sipas normës spanjolle.

1. *grandemente*, (studenti mbipërgjithëson përdorimin e prapashtesës - *mente*)
2. *no cabo (quepo), no qu(i)ero*, (për shkak të një procesi mbipërgjithësimi të rregullave të zgjedhimit të rregullt të së tashmes së dëftores, nxënësi thotë (*no cabo, no quiero*), etj.)
3. *Espero una carta de ti.* Struktura që shpreh pronësi (*ser + de + veta e 3 njëjës ose shumës*) përgjithësohet në rastet kur pronari është një vetë e parë ose e dytë, formal ose joformal, duke shmangur, ndoshta edhe prej thjeshtimit të sistemit, përdorimin e pronorëve të pasvendosur.
4. *Ahora me gusto más Tirana.* Kemi formën *gusto* të ndërtuar nga paralelizmi me mbaresat e të tashmes së dëftores.

<sup>17</sup> Ana Isabel Blanco Picado, El error en el proceso de aprendizaje, “Cuaderno Cervantes” Época II – Año III/2012

**Transferimi ose ndërhyrjet:** Transferimi është përvetësimi i mekanizmave përmes gjuhës amtare që shkaktojnë rezultate pozitive.

Ndërhyrjet prodhohen nga zbatimi i rregullave të GJ1 në GJ2, me rezultate të pasakta. Mund të gjejmë shembuj si:

1. *No me recuerdo de lo que pasó.*
2. *No me gusta Ø fútbol.*
3. *Me gustaron mucho Ana y Maria y sus padre.*
4. *Tengo que respstar. (me ndërhyrje nga fjala respuesta)*
5. *Quiero una (pieza) un trozo de pan. (nga shqipja: pieza = copë)*
6. *Acordó (se acordó de) los deberes.*

**Fosilizimi:** dukuri gjuhësore që e bën nxënësin të mbajë në mënyrë të pavetëdijskime dhe të përhershme në ndërgjuhën e tij, karakteristika të huaja për gjuhën objektiv në lidhje me gramatikën, shqiptimin, leksikun, ose aspektet e tjera komunikuese. Në përgjithësi kjo shpjegohet me ndërhyrjen e GJ1, megjithëse mund të pasqyrojë edhe një përdorim jo korrekt të një rregulli të GJ2.

Si shembull fosilizimi te nxënësit shqiptarë mund të sjellim përdorimin e gabuar të foljes *ser* dhe *estar*. Po ashtu vihet re edhe mungesa e nyjes shquese në shumë raste.

**Filtrimi:** kur përdorin struktura që dinë se i zoterojnë, nxënësit mund të bëjnë gabime. Kjo ndodh për shkak të natyrës filtruase të ndërgjuhës- thotë Ana Isabel Blanco Picado<sup>18</sup>, e cila më tej thekson: “*Kur mësohet një rregull i ri, i gjithë sistemi i njohurive të zotëruara ripërshtatet. Për shembull, një student mëson përdorimin e së pakryerës së dëftorës dhe kjo është mënyra e vetme që ai njeh për të folur për të shkuarën. Do ta përdorë atë për të folur për të shkuarën derisa të mësojë format e tjera nga e shkuara, gjë që do ta detyrojë që të ristrukturojë të gjithë sistemin përsëri. Dhe ky është momenti kur ndodhin gabimet<sup>19</sup>.*”

**Ndryshueshmëria:** Për Ana Isabel Blanco Picado, prodhimet e një studenti ndryshojnë në varësi të situatave komunikuese në të cilat ndodhin. Ndikojnë faktorë si afektiviteti, spontaniteti, shpejtësia, etj. Gabimet janë më të shpeshta në të shprehurit me gojë sesa në ato me shkrim<sup>20</sup>.

Në këto kushte, gabimet zakonisht, janë të karakterit gjuhësor, leksikor e ndoshta edhe fonetik. Por ndodh që, nga ana komunikative ose pragmatike, një prodhim të mos jetë i pranueshëm edhe pse është i saktë nga pikëpamja morfolologjike<sup>21</sup>. Kështu gjejmë

<sup>18</sup> Ana Isabel Blanco Picado, El error en el proceso de aprendizaje, “Cuaderno Cervantes” Época II – Año III/2012

<sup>19</sup> Po aty

<sup>20</sup> Po aty

<sup>21</sup> Po aty

edhe shembuj të kësaj natyre. Shembuj:- *¿Que tal andas? (Si shkon?) - Pues con los pies, como todos los días. (Në këmbë, si çdo ditë) - ¿Tienes hora? (A ke orë) –Si (Po)*

Këto janë gabime që pretendohet që të janë kalimtare por shpesh ato zënë vend te ndërgjuha e nxënësit dhe është e vështirë që të çrrënjosin.

## Mendime mbi korrigjimin

Pavarësisht se i njohim shkaqet që çojnë në gabime nxënësit tanë, gabimi vazhdon të shihet si një “mëkat” ndaj të cilit merren masa ndëshkuese. Korrigjimi i gabimeve mund të jetë, nganjëherë, jo në favor të punës sonë apo të nxënësit, sepse krijon tek ai përshtypjen e gabuar sikur po dështon në mësimin e gjuhës së huaj, kështu që ai demotivohet, shkurajohet, mbylljet në vetvete me frikën se mos bëhet qesharak në sytë e të tjerëve. Demotivimi arrin kulmin kur korrigjimi shoqërohet me një notë negative në regjistër nga mësuesi.

Në vend të korrigjimit në kuptimin klasik të fjalës, sot, është duke zënë më shumë hapësirë një perceptim tjeter, natyrisht më i favorshëm, i cili quhet “riparim”. Me këtë nocion të ri ne kuptojmë “trajtimin e problemeve që lindin gjatë përdorimit të gjuhës gjatë bisedave tona me bashkëbiseduesit e tjerë. Ky nocion është më i gjerë se ai i “korrigjimit” dhe tregon aktivitetin e përhershëm të rregullimit ose përmirësimit gjatë bisedës midis një folësi dhe një dëgjuesi. Është një aktivitet shumë i rëndësishëm në procesin e të mësuarit sepse përbën një mekanizëm kontrolli dhe *feedback*-u për vetë nxënësin. Nga ky këndvështrim i ri theksojmë se korrigjimi ka të bëjë vetëm me trajtimin e gabimeve. Gjatë bisedës midis dy ose më shumë bashkëbiseduesve të së njëjtës gjuhë ose të gjuhëve të ndryshme, puna e riparimit është e organizuar në mënyrë të tillë që të shmanget korrigjimi klasik ose të paktën të bëhet në ato raste kur është e nevojshme dhe konsiderohet e pranueshme, dhe gjithmonë duke mbajtur parasysh që të mos vendoset në situatë të vështirë personi që mendohet se ka bërë gabimin. Prandaj, gabimet e nxënësit nuk duhet të korrigohen, madje as të qeshim me to, por t'u jepet koha e nevojshme për t'u vetë-korriguar. Natyrisht, realiteti i auditorit është i ndryshëm nga mjedisi natyror, kështu që, domosdoshmërisht, ndryshojnë edhe teknikat dhe mënyrat e punës. Por pikërisht këtu mendojmë se ka një paradoks të caktuar: nga njëra anë nxënësi duhet të mësojë një gjuhë të re, me kode gjuhësore / kulturore të reja e të ngjashme me ato të një folësit vendas dhe nga ana tjetër, të mësosh një kod të ri do të thotë të mësosh gradualisht për t'i dhënë vlerë vetes, rezultateve të punës që bën për të mësuar, domethënë të zhvillosh brenda vetes tënde kapacitete për vetë-korrigjim dhe vetë-kontroll. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë të jesh i vetëdijshëm për procesin e të mësuarit, i cili është një nga qëllimet arsimore të shkollës sonë, i pasqyruar edhe në kurrikulën e gjuhëve të huaja, qëllimi kryesor i të cilit është zhvillimi i aftësive të komunikimit. Në këtë kontekst, është e nevojshme të gjenden

mënyrat më të përshtatshme për zhvillimin e këtyre kapaciteteve te studentët tanë.

Një shembull i mirë do të ishte përvoja e çdokujt prej nesh. Jemi të bindur që ne, mësuesit me ose pa shumë përvojë, gjithmonë kemi pasur mundësi të komunikojmë me folës amtarë të një gjuhe tjeter, qoftë në Shqipëri ose në vendet përkatëse, gjuhë të cilën ne e njohim dhe flasim. Të gjithë kemi kaluar nëpër situata në të cilat kemi hezituar të përdorim një strukturë, një theks tonik ose një intonacion ose ndoshta kemi përdorur ndonjë fjalë ose shprehje që nuk është shumë e saktë dhe dëgjesi i huaj ka reaguar në njérën apo tjetrën mënyrë. Të gjithë e kujtojmë atë reagim. A mund t'i shfrytëzojmë këto sjellje, duke u përpjekur t'ua përshtatim kushteve të klasës, ku rolin e “korriguesit” duhet ta bëjmë ne? Ne mendojmë se një përvojë e ngashme, plotësisht e natyrshme dhe aspak e detyruar, pasi është e rrënjosur në përvojën jetësore të secilit prej nesh, do të ishte pozitive në kushtet e klasave tona. Duhet theksuar këtu që një praktikë e tillë nënkuption pranimin e njérës prej dy hipotezave të mëposhtme:

Ekziston një analogji e caktuar, një ngashmëri strukturore midis rolit të mësuesit në klasë dhe atij të gjuhës amtare në një mjedis tjeter natyror. Ky i fundit përdor një “didaktikë natyrore” të caktuar që konsiston në aftësinë për të ndërvepruar me folës jo-amtarë dhe për t'i ndihmuar ata në mësimin e gjuhës së huaj përmes dhënies së *inputit* të duhur në fazën e njoburive që ata zotërojnë përmes ndihmës për të kapërcyer vështirësitet me të cilat ballafaqohen, duke korriguar këto të dhëna në fazën e përdorimit të tyre nga folësi jo-amtar, domethënë në *output*.

Kjo “didaktikë natyrore” nuk është asgjë më shumë sesa përdorimi i strategjive të duhura të komunikimit në situata problemore që nuk lehtësojnë të mësuarit në vetvete, por më tepër rrjedhën e komunikimit. Por këto strategji shpesh kanë një efekt tjeter anësor, atë të promovimit të të mësuarit. Sidoqoftë, në të dy rastet, nga pikëpamja pedagogjike, studimi i këtyre proceseve të riparimit në një kontekst natyror është me shumë interes.

Tri janë kategoritë e veprimtarive që kryhen për të riparuar gabimet.

- Veprimtaria e riparimit në kodin gjuhësor. Fokusi qëndron në formën dhe / ose funksionet e Gjuhës së huaj;
- Veprimtaria e riparimit në mesazh. Fokusi qëndron në transmetimin e informacionit, emocioneve, mendimeve, opinioneve, etj.
- Veprimtaria e riparimit në vetë veprimtarinë didaktike. Fokusi qëndron në organizimin e mjedisit didaktik, në mënyrën e organizimit të veprimtarive në klasë.

Këto tri veprimtari riparuese mund të janë “ndihmë”, domethënë “përpiken për të ndihmuar”, “vlerësimi” domethënë “përpiken për të vlerësuar”. Përveç këtyre veprimtarive kemi edhe një tjeter, i cili mund të jetë objekt i një studimi tjeter, *vetë-riparimi*, ashtu siç mund të jetë, padyshim edhe korrigimi në klasë, me format e tij të larmishme e bashkëpunuese me nxënësin.

## BIBLIOGRAFIA

- Baralo, M., *Errores y fosilización*. Colección Aula de español. Fundación Antonio de Nebrija, Madrid, 1994
- Blanco Picado, A. I., El error en el proceso de aprendizaje, “Cuadernos Cervantes” Época II – Año III/2012
- Bustos Gisbert, J. M., *La construcción de textos en español*. Salamanca, Universidad de Salamanca, 1996.
- Corder, S. Pit. “The significance of learners’ errors”, nё *IRAL*, 5, 1967
- Corder, S. Pit, *Introducing applied linguistics*. London, Penguin, 1973
- Ellis, R. “The study of second language acquisition.” Oxford, OUP, 1994
- Richards, J. C. et al. *Diccionario de lingüística aplicada y enseñanza de lenguas*. Barcelona, Ariel, 1997
- Sánchez Iglesias, J. J. *Errores, corrección y fosilización en la didáctica de lenguas afines: Análisis de errores en la expresión escrita de estudiantes italianos de E/LE*. Salamanca, Universidad de Salamanca, 2004
- Sonsoles Fernández, *Interlengua y Análisis de Errores en el aprendizaje del español como lengua extranjera*, Madrid, Edelsa, 1997

GAZETA REPUBLIKA E BOSTONIT, PARAROJË E PËRKTHIMIT TË  
DON KISHOTIT NGA NOLI

**Dr. Admira Nushi**

Departamento de Lengua y Literatura Española  
Facultad de Lenguas Extranjeras, Universidad de Tirana  
E-mail: admira.nushi@unitir.edu.al

**PËRMBLEDHJE**

Fan Noli shqipëroi kryeveprën e Cervantes-it *Sojliu mendje – mprehtë Don Kishoti i Mançës* dhe e batoi në gazetën shqiptare të përvjetorës së Amerikës, *Republika*. Kjo gazetë e cila trajtoi temën e Shqipërisë e të shqiptarëve, me preokupimin kryesor përparimin e vendit, batoi shkrime kritike mbi librin si dhe artikujt e Nolit mbi eksperiencën e tij përkthimore. Botimi i librit pati jehonë në disa revista në Amerikë dhe u konsiderua emancipim i lexuesit shqiptar, sukses i gjuhës shqipe, gjenialitet i përkthyesit. Ne i kemi dhënë vend e rëndësi komenteve të Nolit mbi eksperiencën e tij përkthimore, sepse na tërheqin drejt botës së përkthyesit dhe analizave, vendime që ai mori gjatë procesit të përkthimit, duke i vlerësuar këta artikujt si origjinalë me vlerën e patjetërsueshme të dokumentit. Rëndësi në këtë artikull kanë marrë edhe emrat e komentet e personaliteteve shqiptare të kohës, të cilët të përfshirë në debatin kulturor disa herë me ngjyrime politike, vijnë më së shumti me pseudonimet e tyre. Ata na zbulojnë panoramën kulturore, ideologjike e politike të kohës duke na përcjellë dhe ndërthurjen e këtyre panoramave.

Fjalët çelës: debat, gazetë përparimtare, kulturë, shkrime kritike, roman i përkthyer.

**ABSTRACT**

Fan Noli translated Cervantes's masterpiece *Sojliu mendje – mprehtë Don Kishoti i Mançës* and published it in the Albanian weekly newspaper in America, *Republika*. This newspaper, which addressed the topic of Albania and the Albanians, with the main concern of the country's development, published critical writings on the book as well as Noli's articles on his translation experience. The publication of the book was echoed in several magazines in America and was considered an emancipation of the Albanian reader, success of the Albanian language, genius of the translator. We have given place and importance to Noli's comments on his translation experience, because they draw us into the world of the translator and the analysis and decisions he made during the translation process, valuing these articles as originals with the invaluable value of the document. The names and comments of the Albanian personalities of the time have also taken importance in this article, who were involved in the cultural debate and several times with political nuances, come mostly with their pseudonyms. They reveal to us the cultural, ideological and political panorama of the time, transmitting to us the intertwining of these panoramas.

Keywords: critical writing, culture, debate, progressive newspaper, translated novel.

## Hyrje

Diplomati, shtetari, prifti, shkrimtari, muzikologu e përkthyesi Fan Noli shqipëroi vëllimin e parë të kryeveprës së Cervantes-it, titulluar në shqip *Sojliu mendje – mprehtë Don Kishoti i Mançës*, në vitet 1932- 1933, në pesë vëllime dhe e batoi në gazetën shqiptare të përvjetorës së Amerikë, *Republika*. Kjo gazetë cila u themelua nga Noli ndërsa u rikthye në Boston nga Europa, batoi shkrime me karakter shoqëror, politik, letrar, trajtoi temën e Shqipërisë e të shqiptarëve me preokupimin e rëndësishëm, përparimin e vendit. Ndërtë tjetra, themeluesi i gazetës dhe përkthyesi i librit batoi shkrime kritike mbi librin si dhe shënimet e tij mbi eksperiencën përkthimore.

Noli me një pasion të jashtëzakonshëm i jepet përkthimit të librit pas betejave të rëndësishme politike në parlamentin shqiptar dhe si udhëheqës shteti. Ai udhëhoqi Revolucionin Demokratik të Qershoris të vitit 1924, dështoi e më pas i ligështuar e i zemëruar mori rrugën e mërgimit. Si intelektual iu përkushtua përkthimit te klasikëve botërorë dhe mund të krahasohet me mjeshtrit më të mëdhenj të përkthimit.

Kadare mendon se veprat që Noli përzgjodhi për përkthim kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetin politik e shoqëror të tij dhe u vunë në shërbim të tij.

*Don Kishoti u përkthyte në shqip nga peshkopi i Shqipërisë. Ky peshkop ishte në luftë me mbretin e ardhshëm të Shqipërisë. Peshkopi përpinqe ta përbyste monarkun. Për t'u dhënë guxim njerëzve e në radhë të parë vetes, në fillim përktheu Hamletin dhe Makbethin dhe arriti vërtet ta përbyste mbretin. Më pas, mbreti e rrëzoji përsëri peshkopin dhe u përbysa situata dhe, ndërsa peshkopi ishte i ngujuar tejet i trishtuar, iu vu përkthimit të Don Kishotit. (Kadare 46)*

Botimi i parë, i plotë librit të përkthyer shqip, *Sojliu mendje – mprehtë Don Kishoti i Mançës*, u realizua në Boston, nga Shtëpia Botuese Mass, në vitin 1933. Vepra u shoqërua me introduktën e shkruar nga vetë Noli, e cila zevendëson prologun e shkruar nga Cervantes-i. Punën e tij përfundimtare është Kishotin në shqip e filloj aty nga viti 1930, pasi kishte shqipëruar më parë disa kryeveprash të letërsisë botërore si *Otello*, *Jul Qezari*, *Makbethi*, *Hamleti* të Shekspirit, *Kasollja* e Vicente Ibañez, *Armiku i Popullit*, *Zonja Ingra e Ostrotit* të Ibsen, e *Rubairat* e Omar Khajam.

### 1. Noli krijues i shkollës së re të përkthimit

Noli e prezantoi *Don Kishotin* në gazetën Republika me dëshirën e mirë që lexuesi shqiptar ta merrte në duar sa më parë, ndërsa rriti dhe numrin e abonimeve në gazetë nxiti lexuesin ta blejë e ta lexojë librin numër pas numri, me premtimin që nuk do zhgënjen por do ta pëlqejnë e do ta njohin si të ishte shqiptar.

*Për ta mbaruar (së lexuari) duhet thënë me të drejtë se vetëm fajja e katërt e "Republikës", ku botohet Don Kishoti i shqipëruar, vlen pajtimi, që kërkojmë për gazetën tonë... mos u kurseni, po na dërgoni pajtimet.... Jua kërkojmë jo vetëm ne, po jua kërkon dhe i dëgjuari kalorës i arratisur, Don Kishoti i Mançës, që po jua paraqitim me takie e fustanellë. Në mos ia mbarofshi dëshirën, athere nuk do ta këndoni dot historinë e tij shqip, në gjuhën e vendit që i përshtatet sot më tepër se çdo tjetër nga anakronizma. (Noli, 1931:1)*

Noli shkroi se ai e ka realizuar një shqipërim të veprës, ndërsa e ndërthuri organikisht elementë të kulturës e gjuhës shqipe "takie e fustanellë", "anakronizma". Vëmë re se kritika shqiptare e të gjitha kohërave e ka mbështetur këtë pretendim, pra bëhet fjalë për një shqipërim dhe jo përkthim të saj. Duhet theksuar se fjalori zyrtar i gjuhës shqipe nuk njeh dallime kuptimore mes përkthimit dhe shqipërimit por kritika letrare duke filluar nga Noli vetë, me termin shqipërim nënkupton një përkthim krijues, jo besnik ndaj tekstit original, rikrijim. Studiuesi Aurel Plasari pranon se Noli ka një metodë tijë përkthimore, e cila tashmë qëndron në themel e shkollës shqiptare të përkthimit dhe që quhet shqipërim, rikrijim. Kjo metodë i lejon përdorimin e gjuhës popullore dhe liri veprimi mbi tekstin. (Plasari, 201-202)

Noli e kishte lexuar librin në spanjisht, pasi e njihte gjuhën e Cervantes-it, kjo ia mundësoi përkthimin nga gjuha e autorit, pra u solli shqiptarëve një përkthim nga teksti original dhe konsultoi botime në gjuhë të tjera para se të ndërmarrë botimin e *Don Kishotit*. Noli, kishte lexuar një literaturë të gjerë studimore në gjuhë të ndryshme mbi librin *Don Kishoti* dhe autorin, gjithashtu pati sintetizuar qëndrimin e tij kritik ndaj veprës dhe personazheve, kur ende ishte në proces përkthimi, gjë që e shprehu në artikuj të ndryshëm gazetareskë. Mendojmë se këto janë arsyet kryesore pse përkthimi i tij i qëndron kohës.

"Noli si shqipérues, dallohet për një kuptim mjaft të mirë të tekstit original. Nga një ballafaqim i originalit me shqipërimin, dallohet sa ai ka përdorur për këshillim dhe përkthime në gjuhë të tjera si: italisht, anglisht, frëngjisht. Siguria në të kuptuarit e tekstit bie në sy edhe në ato vise të veprës për të cilat përkthimet e tjera kanë luhatje." (Plasari 202)

Gjuha e Nolit në përkthim është e fuqishme dhe ekspressive. Përkthimi shkëlqeu, jo vetëm për arësyte të talentit të përkthyesit, por dhe të njoħjes me themel të disa gjuhëve, të njoħjes së kulturës e historisë botërore, e spanjolle. Ky përkthim ishte cilësor edhe sepse Noli ishte një njoħes shumë i mire i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqipe. Këtë e vërtetojnë dhe disa artikuj të botuar nga ai vetë në Gazetën *Republika*, si dhe Introdukta që i ka bërë librit.

R. S. Lizaralde, përkthyes e shkrimtar spanjoll, njoħes i mirë i gjuhës e letërsisë shqipe, mendon se shkurtimet që Noli i bëri veprës:

“...mund të konsideroheshin si një krim i vërtetë përkthimor, nuk ia heqin as vlerën më të vogël punës së tij të guximshme: pasuria semantike që shpalos, gjithmonë në gjuhë popullore, aftësia për të riprodhuar deri ngjyrime satirike shumë të holla qoftë dhe në shprehje, toponime apo emra njerëzish, gjallëria e gjuhës, përdorimi i arkaizmave orientale për të riprodhuar efektin parodik të arkaizmave servantine të romanit kalorësiak, e gjitha kjo (shto të tjera) e shndërron versionin e Fan S. Nolit në një kryevepër të vërtetë në gjuhën shqipe, si për nga stili i mrekullueshëm dhe magjepsës ashtu dhe për nga forca dhe aftësia e tij për të depërtuar (njëlljo si Kishoti origjinal) në të gjitha shtresat e popullsisë. sojliu dhe shqyrtari i tij u shndërruan në personazhe plotësish të integruar në imaginatën dhe mendësinë e shqiptarëve të asaj kohe dhe të atyre të mëvonshme.” (Lizaralde 46)

Mendojmë se Noli realizoi shkurtimet përgjatë rrugëtimit të përkthimit, pasi ai pati parashikuar ta nxirre librin me gjashtë vëllime por e nxori me pesë. Prologun dhe poezitë janë shkurtimet më të rëndësishme, por jo të vetmet. Akti i shkurtimit në vettvetë është një kontribut që përkthimi të konsiderohet shqipërim rikrijues.

Ky përkthim me të drejtë është quajtur rikrijues, pasi përkthyesi i ka lejuar vetes të ndërhyjë e të operojë në tekst lirshëm, ka shmangur shumë elementë kulturorë të tekstit original, si rrjedhim procesi i përkthimit është shoqëruar me humbje të pakthyeshme.

## **2. Sojliu mendje- mprehtë Don Kishoti i Mançës në gazetën Republika**

Nolit u bë zëri i parë kritik serioz mbi veprën *Don Kishoti i Mançës* në Shqipëri, me parathënen të cilën e quajti Introduktë, ku zbuloi shtysat për të sjellë *Kishotin* për shqiptarët. Emancipimi kulturor i lexuesit shqiptar ka rëndësi parësore për Nolin. Kjo është arsyesa pse ai i sjell lexuesit në shqip një “kryevepër letrare”, “një dhuratë të lezeçme”, “veprën më të lezeçme të botës”, “një nga veprat më popullore të botës”, “libër që pati një sukses aq të madh”, etj. (Noli, Introdukta 5)

Introdukta është një vijim logjik i disa artikujve që Fan Noli dhe të tjerë personazhe publike kanë botuar në gazetën Republika, ndërkohë që libri përkthehej dhe botohej në po këtë gazetë. Lexuesi shqiptar i fillim shekullit të XX ishte i pakët në numër, duke iu referuar të dhënavë të kohës, pasi analfabetizmi arrinte 93% të popullsisë, por artikullshkruesit përgatisnin terrenin për lexuesin duke sjellë informacion mbi veprën ndërkombëtarisht të përkthyer, rëndësinë kulturore dhe emancipuese të saj, filozofinë që ajo mbart, heroin kryesor dhe autorin.

“Don Kihoti, kalorësi trim – jo i arratisur- i Mançës është i dehur me një ideal- jo ideal të vdekur por të gjallë. Për këtë ideal Don Kihoti është gati të përballe çdo mundim dhe çdo hidhërim, të japë shpirtin e tij. Don Kihoti rron jashtë vetes tij, rron për të tjerët rron për botën, rron të shkulnjë shejtantelet e njerëzve me gjithë rrënje, të lëftonjë forcat e padrejtësisë. Për veten e tij as mejtohet fare.” (Studenti 2)

Artikullshkruesi, Studenti, ndërsa sjell figurën e Kishotit, replikon me Fan Nolin dhe analizën që ky i fundit i dedikon Kishotit si personazh, në një artikull të tij botuar në gazeten Republika të datës 1 tetor 1931. Studenti, në analizën e tij mbështetej në një studim të shkrimtarit të përmendur rus Turgenievit, ai mendonte se Noli, keq interpretonte personazhin, kuptimin e tij. Ky debat u shoqërua nga të tjerë, në periodikët e kohës të cilët btoheshin jashtë Shqipërisë, ndërsa vepra ende nuk ishe botuar si libër i plotë, ndërsa përkthyesi botonte në Gazetë Republika, të Bostonit në gjuhën shqipe, pjesë – pjesë përkthimin e tij.

Kishoti, ra pre e debateve që në prezantimin e tij, u bë i njohur ende pa u lexuar shqip sipas interpretimeve, u debatua për të sikur të ishte një hero me mish e kocka, një hero real.

Artikujt e fillimit të viteve 30 në gazeten Republika të Bostonit, na dëshmojnë se Noli, përkthyesi i romanit është njëherësh studiuesi i parë i veprës së Cervantesit. Ai hodhi bazat e receptimit të kësaj vepre edhe në Introduktën që shoqëroi botimin e romanit duke krijuar kështu një horizont pritës të veprës në Shqipëri. Fan Noli nxiti lexuesin shqiptar drejt leximit të librit me këto fjalë: “Don Kishoti i Mançës ka qenë, për çdo komb e për çdo vend, një nga veprat më populllore të botës, popullore dhe për çilimijtë, dhe për filozofët e vrenjtur, si Kanti, Shopenhaueri, Eduard Fitzgerardi, përkthyesi i dëgjuar i Omar Khajanit, e quan si veprën më të lezeçme të botë.” (Noli Introdukta 5-6)

Duket se Noli kishte pritshmërinë e përligjur që vepra nga më populloret në botë të bëhej tejet popullore për shqiptarët, dhe ju kërkon shqiptarëve të mos e quajnë të huaj, në prezantimin e parë që i bëri *Don Kishotit*, u kërkon ta marrin për të tyrin: “E kemi njëkombas, arnaut të kulluar...” (5) Sipas Nolit në Shqipëri ka me mijëra Don Kishotër.

Fan Stilian Noli, në vitin 1931, ndërsa ishte përfshirë në procesin e përkthimit të librit dhe botimit në gazeten *Republika*, në Boston të SH B A, shkruan artikullin, *Për Don Kihotin*. (Noli, Don Kihotin 1) Noli shpërfaq vizioni e tij për personazhin, para lexuesve të pritshëm, dhe inkurajon leximin e romanit mbështetur mbi filozofinë e tij:

Së pari, ai vlerëson vlerat artistike të veprës: “*Ka nja njëzet a tridhetë kryevepra letarare të cilat s’duhet të vdesë njeriu para se t’i këndonjë. Një prej këtyre është “Don Kihoti” i shkrimtarit spanjoll Miguel de Cervantes Saavedra. Kemi nisur t’ao botojmë në “Republikën” që prej dy javësh. Është dhurata më e lezeçme që mund t’ju bëjmë kendonjës të dashur. Jemi shigur që do ta shijoni. Është e pamundur të mos ju pëlqejë. Këndojeni me vërejtjen që meriton.*” (1)

Së dyti, Noli u flet lexuesve për karakterin komik dhe tragjik të librit pasi ai shkruan: “*Të vjen të qash e të qeshësh me ato që thot’ me ato që bën... Kështu kanë qeshur e kanë qarë, dyke kënduar Don Kishotin, me miliona njerëz qindra vjete me radhë.*” (1)

Së treti, Noli zbulon karakterin gjithëkohor dhe universal të veprës: “*Se Don Kishoti është një tip i pavdekshëm. Hidhni syrin ku të doni e do t’ao shihni të gjallë përpara jush në çdo çip e në çdo çap.*” (1)

Së katërti, Noli e vlerëson gjuhën shqipe si mjaft të përshtatshme në përkthimin e Kishotit, madje ai i prenton lexuesit një *Kishot* pranë traditës shqiptare, por që ta lexojnë duhet të paguajnë abonimin në gazetë: “*Mos u- kurseni, po na dërgoni pajtimet. Jua kërkojmë jo vetëm ne por por jua kërkon dhe i dëgjuari kalorës i arratisur, Don Kihoti i Mançës, që po juu paraqitim me takie e me fustanellë. Ju bëftë mire!*” (1)

Së pesti, Noli zbulon pikëpamjen që ai ka për Shqipërinë duke e lidhur me Kishotin si simbol i prapambetjes, naivitetit, komicitetit, i cili ka shëmbëlltyrat e tij në Shqipëri: “*Në Shqipëri kemi me mijëra Don Kihotë, reaksionarë të padjallëzuar, që përpilen t'a kthejnë rrotën e historisë prapa, njerëz që rrojnë me prallat dhe fandazmat e patriakalizmës dhe feodalizmës orientale. Këta reaksionarë janë komikë, se të bëjnë të qeshësh me prapambetjen e tyre, por janë dhe tragjikë, se sakrifikoohen për ato pralla dhe për ato fantazma tamam si Don Kishoti.*” (1)

Së fundmi, Noli ngre një pyetje ekzistenciale përfatet e Shqipërisë, ky është shqetësimi më i madh i Nolit dhe i klasës intelektuale që ai përfaqëson: “*Don Kihoti, vdiq ashtu si rroj, si kalorës i kohës së mesme, i arratisur në kohën moderne. A do të vdesin kështu dhe Shqiptarët?*” (1)

Ndërsa Noli u kërkon shqiptarëve të mos e quajnë përfundimtari, në prezantimin e parë që i bëri *Don Kishotit*, u kërkon ta marrin përfundimtari: “*E kemi njëkombas, arnaut.*” Sipas Nolit në Shqipëri ka me mijëra Don Kihotë. Këto grupe sociale, kérkonin rikthimin e kohëve të vjetra të shoqërisë. Noli e vuri veprën në shërbim të qëllimeve politike e demokratike që aspironte e ndiqte. Interpretimi që Noli i bën figurave të romanit nuk është shterues, e as i mjaftueshëm e ndonjëherë as i saktë. Ai më fort u përpoq ta sillte në bashkëkohësi, se sa të zbulonte dykuptimësinë e shumëkuptimësinë e figurave të romanit. Sot interpretimi i Nolit duket i njëanshëm.

Në gazetën Republika, të Bostonit, me datë 22 tetor 1931, artikullshkruesi me pseudonimin Studenti, shkruan artikullin *Don Kishoti dhe Shqipëria*. Me një gjuhë shumë entuziaste, ai shpreh gjëzimin që ky roman po vjen në gjuhën shqipe, si dhe paraqet vlerat e përkthyesit, domethënien e madhe që mban përkthimi i librit për Shqipërinë dhe shqiptarët. “*Besojmë padashim se ky “kalorës i pendës” që po shqipëron kryeveprën e Cervantesit, përfundimtari i gjithë: jo vetëm përfundimtari, por që duan të vdesin përfundimtari.*” (Studenti 1)

Studenti, në vijim ndërton polemikë me Nolin, artikullshkruesin e një shkrimi mbi Kishotin, me datë 3 tetor 1931. Dy artikujt përballen në konceptet se çfarë përfaqëson figura e heroit dhe idealin që mbart ai. Studenti, qartë e kthjellët shprehët se nuk është e vërtetë që në Shqipëri kemi me qindra Don Kihotë, por:

“*Shqiptarët do të ishin më të lumturit e botës po të kishin me të vërtetë kaq shumë Don Kihotë në mes tyre. ...Don Kihoti lëfton përfundimtari që nuk lëftojnë dot përfundimtari e tyre ....Ka burra të tillë Shqipëria vallë? Asnjë! Po jo se një mund t'a ketë, po mijëra s'ka as Shqipëria, as ndonjë vend tjetër. Bota e tërë ka nevojë të madhe përfundimtari si Don Kihoti....pa përpjekjet e Don Kishotëve do t'i kish ngrënë mortja njerëzit dhe qytetërinë e tyre.*” (Studenti 2)

Figura e heroit të romanit të Cervantesit, ka ngritur një polemikë të rëndësishme dhe kontradiktore. Kjo polemikë nuk pushoi as në vijim pasi e mban ndezur dhe e ushqen Fan Noli, përkthyesi i veprës i cili nuk ndan të njëjtin mendim me Studentin.

Sipas analizës së Saverina Pashos, përkthyese e studiuese e letërsisë botërore :

*Nuk duhet harruar që përkthimi nuk është një proces thjesht teknik, por një proces ideologjik pra edhe politik që nuk i përgjigjet vetëm kërkesave të besnikërisë ndaj tekstit burimor, por edhe kërkesave të kohës, vlerave që lidhen me horizontin prites së veprës së përkthyer gjithashtu. Në rastin e Nolit, duhet të marrim parasysh përveç kësaj edhe vetë personalitetin e tij emblematik, faktin që ai nuk ishte vetëm përkthyes por edhe poet i pajisur me një mendim të rafinuar e të pasur, me një erudicion filologjik e religioz, me një frysme polemizuese e me pasione të forta politike. Kështu mund ta kuptojmë më mirë pse Noli zgjodhi për të përkthyer Don Kishotin si dhe pse e pajisi me Introduktën që është kontestuar kaq fort në debatet e kohëve të fundit mbi nevojën e ripërkthimit të kësaj vepre.* (Pasho 102)

Në dhjetor të vitit 1931, po në gazeten Republika, Noli shkruan në rubrikën *Andej – Këtej*, një artikull ku trajton katër çështje të cilat ai i ndeshi gjatë procesit të përkthimit dhe i vlerësoi të rëndësishme t’ia bënte të ditura publikut lexues. Secila çështje vjen si nëntitull i artikullit, nga ku kemi përzgjedhur disa. Si lexues ndërsa i japim vëmendje këtij artikulli zbulojmë dëshirën e përkthyesit për bashkëpunim me lexuesin në këtë proces *live*. Dëshirën që të mos humbasë apo mërzisë lexuesin, sepse heroi po ndryshon emër. Dëshirën e përkthyesit të argumentojnë së bashku për çështje përkthimore.

E para: *Don Kihoti apo Don Kishoti?* Noli ka vendosur të rishikojë shqiptimin në shqip të emrit të heroit të veprës, nga Kihoti në Kishoti për disa arësy: “*Kështu më shumë ia prononcojnë emrin edhe Frenqtë edhe Italianët. Vija re se më të shumtët e shqiptarëve e prononconin emrin e Kalorësit të Mancës, Don Kioti, që është një gjynah i pandjerë. Kjo më shtrëngoj t’ia transkriboj emrin ashtu si ia prononconin Spanjollët në shekullin e shtatëmbëdhjetë, domethënë Don Kishoti.*” (Noli, Andej –Ketej 1)

E dyta: *Tragjik apo Komik?* Noli mendon se Kishoti është: “*Tragjik subjektivisht, domethënë për veten e tij, dhe është komik objektivisht, domethënë për të jashtmit. A mund të quhet atëhere tragjikomik? Nofta, po as kjo s’i jakështis tamam, se është çehit më vete.*” (1)

Noli është njohës i mirë i kritikës letrare bashkëkohore mbi veprën, prandaj ai ndërton tezat e tij pro dhe kundër. Për Nolin ka rëndësi të madhe shtresa sociale nga vjen heroi, për të kuptuar e shpjeguar sjelljen e tij, kështu ai nuk bie dakord me kritikën letrare botërore e cila nuk i jep rëndësi të veçantë kësaj teze. Noli i quan të lajthitura shumë kritika letrare që i janë bëre romanit, prandaj me forcë kundërshton “shkrimitarin rus Turgenjev, që e paraqet Don Kishotin si një kryetrim tragjik një radhë me Hamletin” (1) dhe të tjerë si shkrimitari francez, Anatole France i cili e paraqet si: “një palaço komik me të cilin qeshin çlimijtë.” (1)

E treta: C'farë bejlurçine? Noli argumenton se figura e Kishotit ka të njëtat karakteristika me bejlurçinën e katundit. “Se kjo është karakteristika e bejlurçnës, që s'ka ngjyrë, s'ka bazë, s'ka karakter e s'ka moral. Se kllasi i bejlurçinës s'ka bazë e qëndron n'erë.” (1) Noli e paraqet Kishotin si përfaqësues të një shtrese sociale pa vlera shoqërore, pa bosht, të rënë nga vakti, që është e aftë të bëjë çdo gjë për ta rimarrë parajsën e humbur.

E katërtë: *Sakrifikohet për reaksionin*. Për Nolin, Kishoti nuk është idealist e as sakrifikohet për ideal. “Admirojmë njerëz që sakrifikohen për idealet e përparimit të njerëzisë. Për ato që sakrifikohen për ideale mitologjike, si ato të Don Kishotit, qeshim, s'kemi veç se të qeshim, e diku mallengjehemi për foshnjérinë e tyre.” (1) Sipas tij idealet e Kishotit nuk sjellin asnje gjë të mirë, asnje përfitim, por i shërbejnë reaksionit që dëshiron të kthejë historinë mbrapa.

Në vitin 1932, me nëntitull *Tragjedia e Shqipërisë*, Noli nënvízon një ide të parashtruar më parë e së cilës do t'i qëndronte edhe do ta mbronte në vazhdimësi: “...tragjedia e Shqipërisë është ajo e katundarit të varfër e të paditur që i vete pas bejlurçinës së tipit të Don Kishotit.” Autori analizon klasat e shoqërisë shqiptarë, duke ngritur pyetjen - *nga do t'i vijë shpëtimi vendit?* (Noli, Tragjedia 1)

Sipas Nolit përkatësia klasore e dy personazheve është shumë e rëndësishme deri përcaktuese në sjelljen e tyre, zgjedhjet e vendimet që ata ndërmarrin. Në Gazeten Republika, nr 59, Noli vë re se: “Shumica e kritikëve as e përmendin këtë gjë, ndonëse kjo është rrënja e karakterit të Don Kishotit.” (1) Duke ndërtuar paralelizma mes dy protagonistëve si përfaqësues të klasave të caktuara shoqërore dhe klasës së bejlurçinës e të laros në Shqipëri, Noli gjen arsyen kryesore pse kjo vepër do të pëlqehet tek ne. Interpretimi i veprës nga ana e tij, në gazeten Republika lidhet ngushtë me qëndrimin politik të Nolit, luftë kundër reaksionit borgjezo çifligar të viteve 30 në Shqipëri.

### 3. Debat i për Kishotin në gazeta të tjera të kohës

Kishoti në Shqipëri erdhi ende pa u përkthyer romani *Sojliu mendje mprehtë Don Kishoti i Mançës* nga Noli. Shtypi shqiptar në Boston, në vitin 1909, i referohet figurës së Don Kishotit dhe Sanço Pançës, duke e marrë të mirëqenë se lexuesi i tij shqipfolës i njeh ata, ende pa u përkthyer libri në gjuhën shqipe. Artikulli titullohej *Don Kishoti i 1908*. Artikullshkruesi me pseudonimin Shtegu- Pelës, preokupohet jo për heronjtë e Cervantes-it, por për gjendjen e Shqipërisë nën perandorinë Osmane të Turqve të Rinj, në kushtet kur lëvizja shqiptare për pavarësi ishte në kulmet e saj. Figura e dy personazheve vjen në simbolikën e tyre, e aktualizohet në kontekstin shqiptar të kohës. Autori i përshkruan heronjtë e Cervantes-it:

*Don Quichoti “harron gjendjen e tij të vërtetë dhe epet me fandasi kaqë tepër sa të luftojë me erën dhe me hijet e lisave dhe t'i duket sikur është herua i vërtetë. Don Quichot'i sotmë (Zhon Turqit dua të them) duke vajtur në përëndim, ca me të hollat e patishahut dhe ca të rënë në gazep të tij, u dhanë si Don Quichoti në fandasi dhe deshnë t'a përsëritin Turqinë, së cilës i merreshin këmbët si kalit Don Quichoti.”* (Shtegu i Pelës 1)

Është mjaft interesante të lexojmë se, nuk është Noli i pari që idealizoi dy personazhet e Cervantes-it, madje ata vendosen në kontekstin shqiptar dhe mbartin portretizime aktuale për kohën që në vitin 1909. Shtegu –Pelës, trishtohet nga sjellja e shqyrtarit ndjekës të cilin e quan pasës, të bindur e të përulur, të cilin e barazon me popullsinë fshatare shqiptare që ishte dominuese në vend, e cila ruan të njëjtën përulje në sjellje.

“*Sado të çudiçime që të ishin idetë e Don Quichotit, gjeti një pasës, Sanço Pançen e përjetëshmë, Shqiptarët... Mua, si Shqipëtar, s'më hyn kaqë në punë herua i romanit, sa më hyn pasësi... Sa për Sanço Pançet mund t'a themi se në mos e mbajtin dot emrin e shtrejtë Shqipëtar, mund t'a këmbejnë me çdo emër, po jo me emër barbar Osmanlli; dini cdo me thënë osmanlli?...Shtërgjysh i Hamidit nga Tataristani!!”* (Shtegu i Pelës, 1909:1)

Në vitin 1928, profesori i letërsisë nga Shkodra, njëkohësisht pëkthyes dhe përshtatës veprash letrare për teatër, Ndoc Vasija, përktheu pjesë nga dy librat e Cervantesit, *Don Kishoti i Mançës*. Shtypi shqiptar i kohës i bëri jehonë përkthimit në gjuhën shqipe të librit me titull *Aventurat e Don Kishjoti të Cervantes*. Ky është prezantimi i parë i librit përparrë lexuesit shqiptar, prandaj Revista Dituria, paraqet një përbledhje të shkurtër të veprës, ku zbulimi i karaktereve të dy personazheve mban peshën kryesore. “*Është histori e një njeriu që rron me një endrrë, me një ideal... kurse Sançua, shërbëtori i tij, që s'thellon nga mendja dhe kujdes teprë barkun dhe qejfin, i jep këshilla urtësije, kërkon t'a zgjojë, t'a bjerë në realitet, në të vërtetënë përdhese.”* (Dituriya 355)

Revista e përcjell romanin me një qasje humoristike, duke u bërë vend në këtë mënyrë personazheve të adhurueshëm për nga mendimi dhe sjellja e tyre, dhe ndërsa e përgatit lexuesin të qeshë, përgjithëson shembullin e Kishotit; ai nuk është thjeshtë një tip por arketip. “*Don Kishoti është një pasqyrë: sa njerëz janë si heronj i këtij romani, të lumturë në marrëzinë e tyre shpirtmadhe, të shogruarë në një veprë të kandshme për ta, që u jep gjëzim dhe kënaqësi intime shpirtit.*” (Dituriya 355)

Në gazetat e fillim shekullit të XX, vepra u parapri me komente entuziaste, si dhe shpjegime të qarta përsë po përkthehej në shqip *Don Kishoti*. Këto komente disa here kishin veshur kontekste politike vend e pavend, por në raste të tjera përkthimi lidhet ngushtë me zhvillimin e përparimin kulturor të vendit dhe shqiptarëve, me pasurinë e gjuhës shqipe. “*Sido që të thonë miqtë dhe sidon që të bëjnë armiqtë, Shqipëria po përparon. Përkthimi i Don Kihotit në gjuhën shqipe, mund të themi është në mos më e madhja fare, një nga shenjat më të mëdha të këtij përparimi*”. (Studenti 1)

Revista *Diturija* e Lumo Skëndos, ishte një nga organet e rëndësishme të shtypit të kohës, e cila trajtonte çështje të letërsisë, gjuhës dhe kulturës, e cila njoftoi lexuesin për botimin e romanit në shqip. *Kishoti*, vjen në profilin e tij letrar, prezantohet si: “*një roman shkurtore e një vepre shkruar spanjisht, por e bërë botënore, e përkthyerë në gjithë gjuhët e dheut, e kënduarë prej miliunë njerëz, që tre shekull e tëhu.*” (Revista Diturija 355)

Në vitin 1933, Fiqiri Llagami. sjell një koment të shkurtër të librit *Don Kishoti* në Gazetën *Besa*. Nënfaqja e gazetës *Besa*, në 6 pjesë, batoi një përbledhje të librit të shoqëruar me komente. Duket se artikullshkruesi e ka lexuar librin italisht pasi emrat e përvçëm ai i ka sjellë italisht, si: Michele Cervantes, Ronzinante, Don Kishotti, Sancio Panza, etj. (Lagami 1)

Në vitin 1934 romani i Cervantesit dhe figura e Kishotit u vunë në qëndër të një debati mes intelektualëve shqiptarë në revistën “*Ilyria*”. Tajar Zavalani dhe Vangjo Nirvana, përfaqësues të rretheve intelektuale, u përfshinë në një debat ideologjik, i cili në i cili ishte shprehje e shqetësimit qytetar për të ardhmen e Shqipërisë. Klasa intelektuale shqiptare jep shenja pjekurie ndërsa debaton: “*Në kohën tonë përpjekja e mendimeve bëhet sidomos me anën e fjalës së shtypur dhe atëhere merr formën e polemikës.*” (Zavalani 1)

Vangjo Nirvana, është emri me të cilin firmoste shkrimet e tij intelektuali Vangjel Koça, i cili shkroi në një artikull: “*Ata që duan të çajnë një rrugë të re në jetën e Shqipërisë, ata që duan të krijojnë një frymë të re në botën shqipëtare, janë Don Kishotër sot për sot.*” (Nirvana 1)

Ndërsa Tajar Zavalani e kundërshtoi Nirvanën, pasi Kishoti sipas tij ishte:

“*Tipi i mbaruar i kalorësit në një kohë kur roli historik e social i kalorësisë mesjetare kishte marrë fund... Përfaqëson një botë historikisht të kapërcyer, lëfton për do ideale dhe sidomos me do mjete që s'janë të kohë së tij dhe prandaj në çdo hap bëhet qesharak.*” (Zavalani 1)

“*Jo Don Kishot, po militant të frymës së re do ta quaja unë typin e Përpjekjes s'onë.*” (Zavalani 2)

Debati zhvillohet në dy drejtime, së pari Zavalani nuk quante “*donkishoteske*”, qesharake e utopike, kërkimet e inteligjencës bashkëkohore për një ideal të ri social, i cili do ta tërhiqte kombin tonë në rrugën e progresit e të qytetërimit perëndimor. *Së dyti*, Zavalani i përmbahej po atij vlerësimi që pati formuluar Noli për Kishotin, si simbol i forcave shoqërore reaksionare, që përpinqeshin ta kthenin prapa rrjedhën e historisë. Tajar Zavalani, shihte të shkonin në dy kahe krejtësisht të kundërt - Kishoti personazh dhe klasën intelektuale shqiptare, e cila kërkonte shkëputjen nga e shkuara, e nuk ishte e verbuar nga èndrrat e fantazisë, nga utopia. Kjo ide zbulohet qartë që në titull: *Don Kishotë apo Pioneerë*.

Polemikën është e ndezur mes dy intelektualëve shqiptarë, të cilën Nirvana e quan “*luftë ideologjike*”. (Nirvana 1) Secili dëshiron të lavdërojë përpjekjet e klasës intelektuale ideologjinë e së cilës mbështet e përfaqëson, por nuk bien dakord, nuk kanë të njëjtin kuptim mbi vlerat e personazhit Kishot, i cili nga letërsia erdhi e u mishërua si të që një human i vërtetë. Pas këtij debati intelektual qëndrojnë padyshim bindjet politike të tyre dhe jo çka ofronte vetë teksti i romanit.

Është mjaft interesante të shikosh si vijon debati, pas botimit të librit *Don Kishoti*, gjatë viteve 30, nga dy grupimet e ndryshme politike që etiketohen Don Kishotër. Në vitin 1934, në debatin intelektual të zhvilluar në revistën “Illyria”, Tajar Zavalani dhe Vangjo Nirvana, përfaqësues të rretheve të caktuara intelektuale e politike, përcollën preokupimin për të ardhmen e Shqipërisë, të cilat nuk ishin thjesht personale. Vangjo Nirvana ndërton qartë idenë e tij në një artikull të datës 8 korrik, 1934, të gazetës *Illyria*. Sipas tij Kishoti nuk është një figurë qesharake siç pandehet përgjithësisht, po një hero i vërtetë në kuptimin e thellë të fjalës. Shpreh heroizmin e një shpirti që përpinqet për një gjë të bukur e të drejtë, kundër çdo konvicioni, poshtërsie, egoizmi e vulgariteti.

## BIBLIOGRAFÍA

- Cervantes, Migel. *Aventurat e Don Kishotit të Cervantes*. Shkodër: Zonja e Papërlyeme. 1928. Print.
- Kadare, Ismail. “Don Kishoti në Ballkan”. *Unaza në Kthetra*. Tiranë: Onufri. 2001. 46. Print.
- Lizaralde, Ramon Sanchez. *Shqipëria në pasqyrën e letërsisë*. Tiranë: Onufri. 2008. 46. Print.
- Llagami, Fiqiri. “Aventurat e Don Kishot-it”. Nënflleta e Gazetës Besa. 5- 10 gusht 1933: 1. Print.
- Nirvana, Vangjo. “Ana tjetër e medaljes”. *Gazeta Illyria*. Tiranë. nr. 18. 8 korrik 1934:1. Print.
- Noli, Fan. “Andej –Ketej”. *Gazeta Republika*. nr 59. Boston: Mass. 17 dhjetor 1931:1. Print.
- Noli, Fan. “Andej –Ketej. Tragjedia e Shqipërisë”. *Gazeta Republika*. nr 67. Boston: Mass. 18 shkurt 1932: 1. Print.
- Noli, Fan. “Andej- Këtej. Për Don Kihotin”. *Gazeta Republika*. nr. 48. Boston: Mass. 1 tetor 1931: 1-2. Print.
- Noli, Fan. “Introdukta”. *Don Kishoti i Mançës*. Tiranë: Onufri. 2008. Print.
- Noli, Fan. “Parathënia”. *Don Kishoti i Mançës*. Tiranë: Naim Frashëri. 1977: 5- 6. Print.
- Pasho, Saverina. ”La traduction des œuvres littéraires- nécessite ou tendance?” *Atelier de traducción*. nr. 18. Universiteti Stefan cel Mare. Suaceva. 2012: 99-109. web. 09. nëntor 2020.
- Plasari, Aurel. *Don Kishoti zbret në Shqipëri*. Tiranë: Naim Frashëri. 1990: 201- 202. Print.
- Studenti. “Don Kishoti dhe Shqipëria”. *Gazeta Republika*. Boston: Mass. 22 tetor 1931: 1- 2. Print.
- Studenti. “Don Kishoti dhe Shqipëria”. *Gazeta Republika*. Boston: Mass. 3 tetor 1931: 2. Print.
- Shtegu- Pelës. “Don Quichot i 1908”. *Gazeta Dielli*. Boston: Mass. 23 mars 1909: 1. Print.
- Uçi, Alfred. “Si u prit Don Kishoti në Shqipëri”. *Gazeta ABC*. Tiranë. 17 dhjetor 2005: 2. Print.
- Zavalani, Tajar. “Don Kishotë apo pionierë?”. *Gazeta Illyria*. Tiranë. 24 qershor 1934: 1- 2. Print.
- Mit’hat Frashëri. *Revista Diturija*. Vol.III. Nr. 9. 10. 11. Tiranë. korrik. gusht. shtator. 1928: 355- 358. Print.

## ENVER HOXHA – LA CREACIÓN DE UN CULTO

**Doctoranda Edlira Gabili**

Departamento de Lengua y Literatura Española  
Facultad de Lenguas Extranjeras, Universidad de Tirana  
E-mail: gabili.edlira@hotmail.com

### RESUMEN

Enver Hoxha subió al poder en 1944 y lo mantuvo hasta su muerte 1985. Durante su trayectoria política, centralizó los poderes y se convirtió en el único protagonista de la historia del país. El presente tiene como objetivo entender las razones históricas que ayudaron al dictador de Albania subir al poder y mantenerlo por casi cuarenta años, un régimen que se construyó y giró alrededor de su persona. Pretendemos analizar brevemente los hechos históricos que marcaron su posición política y las reformas que él hizo para mantener el status quo, escondiéndose tras la ideología marxista - leninista.

Palabras clave: Albania, comunismo, Hoxha, independencia, poder.

### ABSTRACT

Enver Hoxha came to power in 1944 and held it until his death in 1985. During his political career, he centralized powers and became the sole protagonist in the country's history. The present aims to understand the historical reasons that helped the Albanian dictator rise to power and maintain it for almost forty years, a regime that was built and revolved around him. We intend to briefly analyze the historical facts that marked his political position and the reforms he made to maintain the status quo, hiding behind the Marxist-Leninist ideology.

Keywords: Albania, communism, Hoxha, independence, power.

## Introducción: la conquista de poder

Enver Hoxha tenía 36 años cuando el 28 de noviembre del 1944 entró como Primer Ministro en Tirana, junto con los demás partisanos. La fecha fue elegida a propósito, para que coincidiera con el mismo día en que 32 años antes, cuando Ismail Qemali había alzado el águila bicéfala y había declarado la independencia de Albania del imperio otomano. Albania acababa de ser liberada de la ocupación de los fascistas y nazis, después de 5 años de lucha del pueblo. El grupo de los partisanos fue el que se quedó con la victoria contra los ocupadores, dejando de un lado las otras dos fuerzas albanesas combatientes, y como consecuencia, fueron los partisanos liderados por Hoxha los que entraron en Tirana y declararon la liberación del país.

En su propio libro de memorias “*Cuando se echaban los cimientos de la nueva Albania*” describe detalladamente el viaje que hicieron desde Berat, en donde estaban reunidos los partisanos del partido comunista, hasta Tirana, añadiendo descripciones sobre los pueblos y las ciudades por las que pasaron. Entre otras, dice que eligió a propósito esta fecha:

“Propuse que el Gobierno entrara en Tirana el 28 de noviembre, en el día celebre de la Declaración de la Independencia. El hecho de elegir este día para la imposición del Gobierno Demócrata en la capital liberada por las armas partisanas tendría sentido completo” (586).

Hoxha dirigía el paso del gobierno recién creado, tenía la posición central desde que se había convertido en jefe del gobierno provisional en el congreso de Permet en mayo del 1944 y reconfirmado unos días antes en Berat, en donde el Consejo Antifascista Nacional Liberador le había encargado el deber del Jefe del Gobierno Democrático. En el mismo libro Hoxha escribe sobre la entrada en Tirana, y compara las fechas con el momento histórico de la independencia. Según su mensaje, los años después de la independencia con el reino de Albania no existen, él simplemente las omite, refiriéndose solo como el tiempo de los traidores. Él, al describir su aparición ante el pueblo de Tirana, se pone en la posición de Ismail Qemali, el creador del país, después de cinco siglos de ocupación otomana. Así es como empieza el discurso, publicado posteriormente en el primer volumen de sus *Obras escogidas*:

### “Pueblo albanés:

*En un día memorable como este, en 1912, después de un largo periodo de esclavitud, nació la Albania independiente. Cuando nuestro país era amenazado por todas partes por los enemigos del exterior, cuando para nuestro pueblo se forjaban nuevas cadenas de esclavitud, el venerable anciano Ismail Qemali, junto con un puñado de valientes patriotas, enarboló la bandera de la libertad en Vlora, y el pueblo albanés pudo al fin respirar. Quedamos victoriosos, pero de nuevo fieros vendavales azotaron a nuestro infeliz pueblo, y la bandera fue pisoteada, los sátrapas del pasado régimen utilizaron abusivamente, la convirtieron en moneda de cambio, se sirvieron de ella para cubrir las ignominias y los*

actos de bandolerismo contra nuestro pueblo. Mas la bandera del pueblo, la bandera de Ismail Qemali, permaneció incólume en los corazones de los patriotas albaneses, fue izada, enarbolada por las férreas manos de los combatientes del pueblo y atravesó por entre huracanes y tempestades, siempre invencible, inquebrantable, símbolo de libertad y de independencia.

Después de tantos combates heroicos contra el fascismo, la bandera roja de Vlora, bañada con la sangre de los héroes del pueblo caídos en el transcurso de esta guerra antifascista, flamea hoy alta y brillante bajo el cielo de Albania libre.” (Obras 1, 427 – 428).

Tal y como vemos más arriba, Hoxha habla de los dos momentos históricos como si fueran uno, se refiere a la bandera como una sola, que fue izada primero por I.Qemali, luego de un largo periodo de esclavitud, y después por Hoxha el día 28 de noviembre del 1944, tras ser pisoteada y usada de manera abusiva. Podríamos hablar aquí de dos victorias: la contra los ocupadores, y la victoria personal de Hoxha, ya que está ahora en el mismo nivel histórico que Ismail Qemali.

Más que eso, por primera vez Albania fue aceptada internacionalmente como país existente e independiente después de los eventos del 28 de noviembre de 1912. En su propio discurso de victoria habla de estas dos fechas, de 1912 y de 1944, y para él no tienen diferencia alguna, cinco años de ocupación (y algunos más del “traidor” Zogu) valían lo mismo históricamente como quinientos años:

“De una tribuna simple saludé el pueblo con el caso del Día de la independencia, un día que por primera vez después de tantos años de guerra lo estábamos celebrando libres: Nuestra bandera gloriosa, enrojecida con la sangre de los héroes del pueblo caído en esta guerra antifascista, vuela hoy orgullosa en el cielo de la Albania libre. Cinco años han pasado de la grave esclavitud fascista, cinco veces en las calles de las ciudades de Albania, cada 28 de noviembre se ha derramado la sangre de los hijos heroicos que luchaban contra las bayonetas de los ocupantes y los traidores. El Día de la Bandera se ha hecho dos veces sagrada, el Día de la Declaración de la Independencia y el Día de la unión del pueblo albanés... Las dos fechas representan dos períodos distintos, pero gloriosas del pueblo albanés, dos períodos que van a brillar con toda su majestuosidad con el paso de los años y los siglos” (472 - 473).

## 1. Los orígenes de Enver Hoxha

Pero, ¿quién era Hoxha, este hombre que acababa de compararse con el padre de la nación albanesa? Y, lo más importante, ¿cómo llegó a convertirse en el centro del poder por más de 40 años, definiendo la nación y marcando para siempre la historia?

Para poder entender los eventos del 28 de noviembre tenemos que hacer un breve recorrido histórico en la vida del que se acababa de proclamar líder del país.

Enver Hoxha nació en la ciudad de Gjirokaster, en el sur de Albania y ahí es donde pasó su infancia. Venía de una familia de clase media. Su carácter empezó a ser moldeado

cuando, gracias a una beca, se transfirió para continuar sus estudios en el Liceo Francés de Korca. Sin duda Korca era muy distinta a la ciudad natal de Hoxha: llena de comerciantes, doctores, abogados, extendida en una llanura muy fértil, con avenidas anchas y casas señoriales, tenía poco que ver con las casas – torres de piedra en Gjirokaster montañosa. Tras los estudios en el Liceo, en verano del 1930, pudo viajar hacia Montpellier en Francia, para estudiar en la Facultad de Biología. Francia influenció mucho a Hoxha en el nivel personal, tanto que fue el único país con el que mantuvo relaciones normales durante el comunismo y siempre se interesó por su cultura.

Hoxha volvió a Albania y empezó a trabajar primero como maestro de francés en Tirana y luego en el Liceo de Korca. Estuvo ahí hasta el inicio de la guerra. Fue en esta ciudad en la que se piensa que se conectó con el movimiento comunista, dado el carácter bohemio y ciudadano que tenía la clase intelectual de Korca.

Cuando el Liceo Francés se cerró y se convirtió en una escuela italiana, se quedó sin trabajo. Junto con un amigo (Esat Dishnica) alquilaron una tienda en el centro de Tirana, que lo llamaron Flora y ahí vendían cigarrillos. Este sitio se convertiría luego en la sede de toda la actividad política de Hoxha.

Según Fevziu (62), Hoxha accedió al partido gracias a Koco Tashko, líder del Grupo Comunista de Korca. Parece que al grupo de los comunistas de Korca le faltaba un miembro musulmán, y el líder de este grupo acepta las recomendaciones de los enviados del Komintern ruso, los serbios Miladin Popovic y Dusan Mugosha. De esta forma, Hoxha participó en la primera actividad importante de su carrera política, la creación del Partido Comunista. Además de su origen religioso musulmán, Hoxha era interesante porque, era un joven apuesto que había estudiado al extranjero y sabía expresarse bien.

En Albania en aquel tiempo había tres grupos comunistas: los Comunistas de Shkoder, los de Korca y el Grupo de los Jóvenes, y los enviados yugoslavos para unir estos grupos bajo el paraguas de un partido comunista, porque esas eran las instrucciones de los soviéticos y Tito. Si recurrimos de nuevo a Fevziu (68), él dice que los yugoslavos optaron por apoyar a Hoxha como líder del Partido Comunista porque él era el único que no había mostrado ningún interés ni ambición en la Junta de la Creación del Partido Comunista. Todos los demás, sobre todo los líderes de los grupos comunistas habían mostrado más afán en consolidar sus figuras como protagonistas en la lucha, que empezar la lucha contra los fascistas. Hoxha no era como los demás líderes comunistas, su imagen era casi desconocida y, al tener habilidad para expresarse, tenía la ventaja sobre los demás partisanos. Se consideraba la elección de Hoxha como una solución temporal mientras uno de estos líderes lograba imponerse como figura central.

Al convertirse en miembro del Comité Central del Partido Comunista, el talento de Hoxha en la oratoria y estrategia política empezó a destacar: fue uno de los que apoyaron la idea de que el PC no tuviera un líder hasta una segunda reunión. Este Comité se componía por siete miembros, cada uno con sus tareas, la de Hoxha era cuidar las finanzas y las técnicas. El habla detalladamente del proceso de elección de los representantes del partido en su obra “*Cuando se echaban los cimientos de la nueva Albania*” (395-458).

Desde que empezó a participar activamente en la vida política del país, cuando se convirtió en miembro del Comité Central de PC, trabajó y optó por varias medidas para consolidar su poder como líder hasta convertirse en la persona más poderosa, adorada y temida del país. A continuación, hemos compilado una lista de algunas de estas medidas:

Una de las primeras reformas que él hizo para establecer los cimientos de su poder, era eliminar los otros posibles candidatos partisanos para líder del Partido Comunista. Tal y como esta mencionado más arriba, Hoxha era el candidato menos elegible para convertirse en miembro del Comité Central primero, y Primer Secretario del Partido Comunista después. No era ni un partisano destacado por su valentía y luchas, ni líder de cualquiera de los tres grupos comunistas que existían en Albania en el 1941(M.Vickers 138 -151). En dos años, hasta 1943, aprovechó para eliminar a todas las personas que eran posibles candidatas para liderar el Partido Comunista. Dio varias justificaciones para las ejecuciones, sobre las cuales podemos leer detalladamente en la biografía que el periodista Blendi Fevziu le dedica al dictador de Albania.

Tras posicionarse como líder de los partisanos, hizo uso de la organización del congreso de Permet, el 24 de mayo del 1944 para establecerse como protagonista. Era el primer congreso de la historia del Partido Comunista, organizado en la ciudad sureña de Permet, una posición ideal ya que el sur era controlado mayoritariamente por los comunistas. A través de este congreso, Hoxha consolidó el Partido Comunista como el grupo principal político del país y aprovechó para lanzar su promoción como su líder. Durante y después del congreso, Hoxha aprovechó para acumular una serie de títulos políticos con los cuales centralizaba el poder en sus manos, le otorgaron el título general – coronel y Jefe del Comité Provisional Antifascista Nacional Liberador, en otras palabras: primer ministro del Gobierno Provisional. También era Ministro de Defensa en este gobierno y Jefe del Cuartel General del Ejército.

Unos meses después, durante la segunda junta del congreso del partido comunista, esta vez en la ciudad de Berat, él fue sometido a una serie de críticas por parte de los demás partisanos, con intención de destituirle. Pero, al ser un estratega, preparó y leyó una autocritica en los días anteriores a la liberación. A través de esta maniobra, pudo calmar las pretensiones de sus rivales, y se las gestionó para sobrevivir al ataque político desviando la atención de los participantes hacia la importancia de entrar en la capital librada el día 28 de noviembre. Aquí es cuando por primera vez Hoxha quiere y expresa la importancia de esa fecha, argumento que resultó persuasivo ya que sus críticas se calmaron y le permitieron seguir con el plan (M.Vickers 150).

Ya mencionamos al inicio de este trabajo la importancia de la fecha que eligió para entrar victorioso en la capital después de la liberación de los alemanes. Aun hoy en día, es la fecha más importante del pueblo albanés y, si hablamos del contexto de la liberación de la ocupación de la segunda guerra mundial, nos podemos imaginar la carga histórica que tenía este día. Hoxha estaba consagrando la liberación de los albaneses de los ocupadores y lo estaba poniendo en la misma posición histórica que el hecho que creó la identidad albanesa: la independencia después de cinco siglos de ocupación turca (M. Vickers 152).

En el mismo día, se organizó un baile en el emblemático Hotel Dajti celebrar la victoria y la entrada del Gobierno provisional en Tirana. En ese evento Hoxha aparece con su prometida Nexhmije Xhuglini. La presentación oficial de ella como su mujer, una partisana con la cual llevaba un par de años relacionado, en el primer acto público del país liberado, marcaba la consolidación de la “dinastía” Hoxha en el poder (B. Fevziu 15-20).

## 2. La consolidación en el poder: primeras purgas

Tras asegurar su posición en el poder, el siguiente paso consistió en eliminar la oposición política: al convertirse en Primer Secretario del Partido Comunista y, con el avance del Frente Nacional Liberador en contra de los ocupadores italianos y alemanes, Hoxha empezó a planear la extensión de su poder sobre todos los demás grupos políticos. De esta forma, “desaparecieron” de la escena los otros dos grupos políticos importantes: La Legalidad bajo la dirección de Abaz Kupi y el Frente Nacional de Mit’hat Frasheri (M. Vickers 151 - 155).

Después de las elecciones del 1945 y la reafirmación del gobierno liderado por el partido comunista como única fuerza política, Hoxha empieza su gobernación con una serie de reformas económicas: como el “*impuesto extraordinario de la guerra*” y la reunión “voluntaria” de las tierras agrarias bajo el nombre de “cooperativas agrícolas”, las cuales tenían como objetivo político eliminar el poder y control de la clase rica de la sociedad albanesa del siglo XX, deteniendo primero solo los que rechazaban estas reformas y con el paso del tiempo, a todos los albaneses adinerados, y todos los que tenían en su posesión una propiedad privada (M. Vickers 167).

Hay que mencionar que una de las reformas que más afectaron la mentalidad y la percepción de la población albanesa, fue la creación del “Sigurimi”, la institución del Servicio Secreto Albanés, que garantizaba la seguridad del régimen encargándose de sus enemigos. Un sistema creado según el modelo yugoslavo, y que llegó a tener alrededor de más de doscientos mil agentes durante los 46 años que hubo comunismo en el Albania. Sigurimi era la herramienta con la cual Hoxha logró conservar el poder, ya que a través de sus operaciones y “archivos” que recopilaban con información detallada sobre los enemigos del sistema, se organizaban los juicios contra los “enemigos del estado” (B. Fevziu 150-151).

Además del Sigurimi, en el país se construyó una red entera de prisiones, comisarías de investigación, campos de concentración y trabajo forzado, que alojaban a los prisioneros y servían de recordatorio para todos los que se expresaban en contra del sistema. Si, por alguna razón, este recordatorio no era eficiente, y, para asegurarse de la eliminación de sus enemigos, se creó el sistema de la “biografía”: todos los que eran familiares de primera generación de los condenados políticos los llevaban en los campos de concentración. La segunda y tercera generación tenía derecho a una educación básica, no podían tener

trabajos normales y eran vigilados todo el tiempo por los agentes del servicio secreto ya que eran de “mala biografía”. Con esta herramienta, Hoxha estaba garantizando el futuro, las generaciones de la clase intelectual ya no serían más intelectuales por la falta de educación, ni tendrían noción de poner en cuestión su liderazgo. Al mismo tiempo, el resto que no tenía mala biografía y tenía acceso a la educación superior, no se atrevería a decir algo en su contra por el mismo miedo de perjudicar no solo su vida, sino la de sus familiares también (B. Fevziu 143-158).

Durante los años del régimen de Hoxha, hubo algunos aliados que se fueron ganando y perdiendo por él, y que lo acompañaron en su trayectoria política desde los eventos de la guerra hasta el final de su vida. Con diversas acusaciones y maniobras políticas, se desprendió de los países que amenazaban su poder: los aliados anglo-americanos de la Guerra de Liberación, los yugoslavos, los rusos y los chinos, hasta el aislamiento absoluto del país en los años 70. Hay que mencionar, que a través de estas rupturas políticas, Hoxha se aprovecha para eliminar sus posibles oponentes políticos, acusándolos de traidores y conspiradores con los países extranjeros. Empezando por la misión anglo-americana, la cual fue expulsada oficialmente del país en el 1946, dos años después de la guerra. Ellos habían sido los únicos aliados de los albaneses durante la guerra y habían apoyado la imposición de Hoxha en frente del Gobierno. El enfriamiento de Stalin con Tito, y la carta que envió Stalin a Hoxha sirvieron de pretexto para que Albania empezara la ruptura de alianza con Yugoslavia (1949). Hoxha narra su versión en extensivamente en su obra “Los Titistas”, sabe aprovechar el expansionismo de Tito (que era real) para “vender” la idea que la soberanía albanesa está en peligro, y que sólo él (y el PTA) pueden salvar esa soberanía de los yugoslavos. Usando de la crisis política, aprovecha para eliminar a Koçi Xoxe, entre otros personajes, uno de los protagonistas del poder del partido comunista, y aliado preferido de Yugoslavia (Obras 2, 122 – 128).

Con los rusos, sobre todo durante el mandato de Stalin, Albania vivió la mejor época de relaciones diplomáticas. Mantuvo inicialmente buenas relaciones con la Unión Soviética de Jruschev, hasta que este último decidió acercarse a Yugoslavia y criticar el legado de Stalin a través del revisionismo. (M. Vickers 177 – 179). Con el tiempo, Hoxha llegó a interpretar este acercamiento como un intento de quitarlo del poder. En los años 1960 – 1961 la separación con la Unión Soviética se hizo real (Hoxha, Superpotencias, 59).

Cuando en el 1961 Hoxha sustituyó los rusos por los chinos, lo hizo por el interés de lo que significaba ser aliado de la República Popular China: la garantía en contra de los ataques rusos, yugoslavos, capitalistas etc., y la ayuda económica que ellos le dieron a Albania. La alianza duró diecisiete años y terminó cuando China restableció la relación con los americanos. Esto se consideró como una traición por parte de Hoxha (1978). Por primera vez, Albania quedaba sin NINGÚN aliado exterior: se consolida el mito de la fortaleza inexpugnable del socialismo (Hoxha, Superpotencias, 460-462). Estamos hablando de una época en donde Hoxha domina completamente todos los aspectos de la vida del país, es el único líder en el área política (mas tarde se aprovecha para eliminar

hasta Mehmet Shehu (1981), su amigo y el único partisano protagonista que quedaba con vida), económico, social, histórico cultural etc. También es la época cuando tenemos una producción masiva de todo tipo de libros que servían de propaganda por el Instituto de los Estudios Marxista-Leninistas, liderado por la mujer de Hoxha. A nivel personal, también es la época cuando Hoxha escribe la mayor parte de sus libros y memorias. La promoción de la imagen de Hoxha en las producciones mediáticas: películas, documentales, campañas de propaganda que bombardeaban al pueblo con informaciones e ideología del líder – héroe, la censura y control ejercido por el Instituto de los Estudios Marxista-Leninistas y el Sigurimi, posicionan a Hoxha como único protagonista de la vida de los albaneses. Como ejemplo de lo mencionado podemos mencionar la relación con el escritor más famoso del momento: Ismail Kadare. Hoxha citó al célebre escritor en su casa, para informarle sobre su deseo de ser personaje en la siguiente obra de Kadare, ya que su estilo se había convertido famoso mundialmente. Aunque la novela fue censurada, y le cambiaron el título, a Hoxha le gustó el retrato que le había hecho Kadare en “El gran invierno”, y no lo eliminó. Habla del deseo de Hoxha de llegar a los niveles de lo épico, inmortalizado para siempre por el mejor y más conocido escritor de toda la historia de Albania y los albaneses (B. Fevziu 255-260).

La prohibición oficial y definitiva de las religiones en el año 1967, siguiendo el ejemplo de la Revolución Cultural de Mao, reflejan su deseo de imponer su autoridad como la única que podía “unificar” más al país, sin dependencias hacia el Vaticano, los ortodoxos griegos y serbios o musulmanes. Se trata de la interpretación más extrema del marxismo- leninismo, que ya se había empezado a imponerse en noviembre del 1949 con la creación de una ley que le exigía a las comunidades religiosas que desarrollasen entre sus miembros el sentimiento de lealtad hacia el poder del pueblo y la República Popular de Albania (Hoxha, Cuando se echaban los cimientos de la nueva Albania 27-33).

## Conclusiones

Aparte de las reformas políticas, económicas, culturales y religiosas, el dictador de Albania marcó su poder y posición también con su vida personal. Empezó a vivir en un barrio central de la capital, que luego se convirtió en el famoso “Bloque”, ubicándose político y geográficamente en la cumbre de la jerarquía política y de poder del país: Tirana está geográficamente en el centro de Albania, el barrio “Blloku – Bloque” está en el centro de la capital, y la casa de Hoxha estaba en el centro del barrio. Todo giraba alrededor de su sede. En este barrio, aislado por los militares, con una única calle de entrada y salida, por la cual solo los que vivían ahí, y los que tenían permiso podían entrar, se habían reunido en una serie de casas en las que habitaban los políticos más importantes del gobierno comunista albanés. La ubicación y cercanía de cada una de estas casas con la del líder, daba información sobre la posición política de sus habitantes (B. Fevziu 217-230).

No era solo el sitio donde vivía Hoxha, sino también cómo funcionaba todo alrededor de este barrio lo que lo hizo mítico: la organización de casas, el secretismo, la clausura, el hospital privado, inclusive la protección personal de Hoxha y su familia, desde los coches que usaba para moverse cuando salía del barrio y de la ciudad, hasta los miles de soldados que vigilaban el barrio donde él vivía, y los cientos de personas que trabajaban y servían ahí en todo momento (B. Fevziu 233-241).

Por último, podemos decir que, aunque fue el dictador del país que marcó el presente y el futuro de los albaneses, es cierto que Hoxha fue un líder único, que se alzó sobre los cimientos de una Albania orgullosa de su pasado histórico, pero turbulenta, y él se aprovechó de cada uno de los momentos por los que pasaba el país para fortalecer su posición. A través de las reformas mencionadas más arriba, empezando por el primer acto oficial el 28 de noviembre del 1944 como líder héroe de los albaneses, se apropió de cada uno de los aspectos públicos y privados de la vida del pueblo, empezando por lo político e histórico, continuado con lo económico y social, y terminando con lo intelectual y espiritual. Hoxha se creó su propio mito, se inmortalizó en la mente de sus coetáneos, y en la historia de los descendientes de los albaneses.

## BIBLIOGRAFÍA

- Hoxha, Enver. *Obras Escogidas Tomo I*. Instituto de Estudios Marxistas – Leninistas adjunto al CC del PPA. Casa Editorial 8 de Noviembre. Tirana, 1974.
- Hoxha, Enver. *Obras Escogidas Tomo II*. Instituto de Estudios Marxistas – Leninistas adjunto al CC del PPA. Casa Editorial 8 de Noviembre. Tirana, 1975.
- Hoxha, Enver. *Con Stalin*. Instituto de Estudios Marxistas – Leninistas adjunto al CC del PPA. Casa Editorial 8 de Noviembre. Tirana, 1982.
- Hoxha, Enver. *Los Titistas*. Instituto de Estudios Marxistas – Leninistas adjunto al CC del PPA. Casa Editorial 8 de Noviembre. Tirana, 1982.
- Hoxha, Enver. *Años de la infancia*. Instituto de Estudios Marxistas – Leninistas adjunto al CC del PPA. Casa Editorial 8 de Noviembre. Tirana, 1983.
- Hoxha, Enver. *Cuando se echaban los cimientos de la nueva Albania*. Instituto de Estudios Marxistas – Leninistas adjunto al CC del PPA. Casa Editorial 8 de Noviembre. Tirana, 1984.
- Hoxha, Enver. *Las Superpotencias*. Instituto de Estudios Marxista – Leninista adjunto al CC del PPA. Casa Editorial 8 de Noviembre. Tirana, 1986.
- Hoxha, Enver. *Diario 1955-1957*. Instituto de Estudios Marxistas – Leninistas adjunto al CC del PPA. Casa Editorial 8 de Noviembre. Tirana, 1987.
- Hoxha, Enver. *Años de la juventud*. Instituto de Estudios Marxistas – Leninistas adjunto al CC del PPA. Casa Editorial 8 de Noviembre. Tirana, 1988.
- Vickers, Miranda. *The Albanians, A modern history*. Editorial I. B. Tauris & Co. London-New York, 2016, 2017. ISBN 978 178076 695 9
- Fevziu, Blendi. *Enver Hoxha*. UET Press Tirana, 2014. ISBN 978 99956 39358

## KARLOS RUIZ ZAFON, TRAJEKTORJA E TIJ LETRARE DHE SUKSESI I JASHTËZAKONSHËM NË SHQIPËRI

**Dr. Flavia Kaba**

Departamenti Gjuhës Spanjolle  
Fakulteti Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: flavia.kaba@unitir.edu.al

### PËRMBLEDHJE

Shkrimtari spanjoll Karlos Ruiz Zafon i përkthyer në mbi 45 gjuhë dhe i botuar në pesë kontinente, pasi u përkthye edhe në gjuhën shqipe, u mirëprit nga lexuesi shqiptar, të cilët, krijuan forume apo klube leximi për të ndarë ndjesitë e tyre mbi veprat zafoniane. Pena dhe stili zafonian të krahasuar me atë të Kunderës, Borgesit apo edhe Dikensit, korrën një sukses të jashtëzakonshëm edhe në vendin tonë, sigurisht falë edhe përkthimeve dinjitoze të përkthyesve. Trajektorja letrare e Zafonit ndonëse e shkurtër në kohë, përbëhet nga 9 romane, 3 prej të cilave janë romane për të rinj, me të cilat Zafoni nisi edhe karrierën e tij si shkrimtar dhe një libër me tregime. Në këtë punim modest do të japid një panoramë mbi këtë trajktore letrare dhe suksesin e jashtëzakonshëm që korri Zafoni në Shqipëri.

Fjalët çelës: letërsi spanjolle bashkëkohore, përkthime, romane, Zafon etj.

### ABSTRACT

Carlos Ruiz Zafon a Spanish novelist is translated into over 45 languages and published on five continents, after being translated into Albanian, it was also welcomed by the Albanian readers, who created forums or reading clubs to share their feelings on Zafonian works. The Zafonian pen and style is compared to that of Kundera, Borges or even Dickens, had a big success in our country as well, certainly thanks to the dignified translations of the translators. Zafoni's literary trajectory, although short in time, consists of 9 novels, 3 of which are novels for young people, with which Zafoni started his career as a writer and a book of stories. In this modest work, we will give an overview of this literary trajectory and the extraordinary success that Zafoni has in Albania.

Keywords: contemporary Spanish literature, novels, translations, Zafon etc.

## Zafon dhe letërsia për të rinj

Lindi në qytetin e bukur të Barcelonës në vitin 1964. Në vitin<sup>1</sup> dhe qytetin e dragonjve të cilët aq shumë i deshi dhe i koleksionoi përgjatë gjithë jetës së tij duke i bërë pjesë të pandashme edhe në narrativën e tij letrare. Krijimtarinë letrare e nisi në vitin 1993 me botimin e romanit të parë për të rinj të titulluar ‘Princi i mjegullës’ i cili fitoi edhe çmimin Edebe.<sup>2</sup> Një vit më vonë ai do të transferohet në qytetin e Los Angeles të cilin aq shumë e kishte ëndërruar në fëmijërinë e tij. Nga qyteti i dragonjve në qytetin e engjëjve, simbole të cilat ndeshen shpesh edhe në narrativën e tij letrare duke i shndërruar deri diku edhe në personazhe gati-gati thelbësorë për veprat e tij. Në vitet pasardhëse, përkatësisht në vitin 1994 botoi romanin ‘Pallati i mesnatës’, një roman plot mistere sikurse edhe ai vetë e adhuronte misterin, një histori që zhvillohet në Kalkutën e viteve 30’, për të vazhduar më pas në vitin 1995 me publikimin e romanit po për të rinj ‘Dritat e shtatorit’, rrëfim mbi një fabrikues misterioz lodrash. Të tre këta libra për të rinj formuan *Trilogjinë e Mjegullës*. Në vitin 1999 do të botonte romanin *Marina*, një ndërthurje tipike e Zafonit mes tragjedisë dhe intrigës në Barcelonën e viteve 80’.

## Romanet e sagës së Varrezës së Librave të Harruar

Zafon u bë i njobur ndërkombëtarisht me veprën *Hija e Erës*, roman i botuar në vitin 2001, romani i parë i sagës së Varrezës së Librave të Harruar, ku flitej mbi botën magjike të kësaj varreze, aty ku shumë lexues gjetën, humbën dhe rigjetën veten dorë për dore me personazhet e romanit, i cili shiti në mbarë botën më shumë se 15 milion kopje duke e renditur kështu Zafonin, shkrimtarin e dytë më të lexuar pas Servantesit dhe romanin e tij *Hija e Erës* si romanin me shitjen më të madhe pas Don Kishotit. Një fenomen letrar për të cilin u shkrua pafund dhe për të cilin kritika letrare nuk hezitoi ta krahasonë narrativën dhe peshën e historive të personazheve të tij me shkrimtarët më të mëdhenj të të gjithë kohërave si Dikens, Borges, Kundera, Allan Poe, etj, aq sa tashmë Zafon njihet ndryshe edhe si Dikensi i Barcelonës.<sup>3</sup> Libri u shndërrua në një *best-seller* në Spanjë, Shtetet e Bashkuara, Gjermani, Itali, etj. Pas një pushimi të gjatë prej gati shtatë vitesh, Zafon do të rikthehet me romanin e dytë të kësaj sage të titulluar ‘Loja e engjëllit’. Sërisht ngjarjet do të zhvillohen në Barcelonën e Zafonit, një Barcelonë e turbullt dhe e trazuar e viteve 20’, ku një shkrimtar riosh i fiksuar pas një dashurie të pamundur do të pranojë ofertën

1 Sipas kalendarit kinez, njerëzit e lindur nga 13 shkurti i vitit 1964 dhe 1 shkurti i vitit 1965 i përkasin shenjës së Dragoit.

2 Çmimet Edebe i Letërsisë për Fëmijë dhe të Rinj, janë çmime që jepen nga Shtëpia Botuese Edebe për të promovuar veprat letrare për fëmijë dhe të rinj. [www.edebe.com](http://www.edebe.com)

3 Flavia Kaba: Et recordarem semper, Carlos. Faleminderit Zafon. [www.startnews.com](http://www.startnews.com)

e një redaktori misterioz për të shkruar një libër që kurrë më parë nuk ka ekzistuar, në këmbim të një pasurie të madhe. Intriga, bota gotike, mistere, aventura dhe shumë pyetje pa përgjigje do të ngërthejnë sërisht mijëra lexues anembanë botës. Saga do të shtohet me romanin e tretë pas tre vitesh, pikërisht në vitin 2011 me romanin e titulluar *I burgosuri i qiellit*. Një roman plot intriga por edhe emocione të fortë të cilat ndihen që në faqet e para të romanit me shfaqjen e një personazhi sa misterioz po aq edhe shqetësues, i cili do të vizitojë librarinë e familjes Sempere dhe do t'i kërcënjojë ata me zbulimin e një sekreti, i cili gjendet i varrosur prej dy dekadash në kujtesën e errët të qytetit. Romani i tretë i sagës së Varrezës së Librave të Harruar, është një hap më shumë drejt brendësisë së ngjarjeve, çka është dhe gërshtimi thelbësor në të cilin mbështeten edhe katër librat. Zafon ka dashur që secili prej romaneve të kishte veçantinë e vet, strukturë të ndryshme por që në të njëjtën kohë të kishin lidhje me njëri tjetrin. Në këtë rast, mbi të gjitha, si referencë për prezencën e personazhit të Ferminit, toni është më i lehtë, më pikaresk dhe narrativa ka një ritëm më të zhdërvjelltë dhe më të shpejtë, krahasuar me dy romanet paraardhëse, një ndjesi që ka lidhje me natyrshmërinë e rrëfimit, i cili është një kreshendo drejt finales së madhe që na pret në përfundimin e pjesës së katërt.<sup>4</sup>

Fundin e lënë të hapur te romani *I burgosuri i qiellit*, lexuesit do ta gjejnë të mbyllur te romani fundit i sagës *Labirinti i shpirtrave*, i botuar në vitin 2016, plot pesëmbëdhjetë vite pas botimit të romanit të parë të sagës së Varrezës së Librave të Harruar, roman i vendosur në Barcelonën e regjimit të Frankos të fund viteve 50', ku do të zbulohet historia e familjes së personazheve duke i dhënë kështu prekjen përfundimtare kësaj sage. Në këtë roman përmbylli së sagës, lexuesit do të ritakohen me personazhet e njohura edhe në romanet e mëparshme, me tema të cilat do të fillojnë të gjejnë zgjidhje sikurse edhe shumë pyetje do të marrin përgjigjet e munguara.

### Tregimet e Zafonit, të botuara para dhe pas vdekjes së tij

E nisi krijimtarinë e tij letrare me romane për të rinj për të vazhduar më pas me romanet për të rritur dhe sakaq gjatë udhëtimit të tij letrar, fatkeqësisht të shkurtër, në vitin 2020, nën titullin *Qyteti i avullit*, Zafonit iu botuan në shenjë homazhi për të gjithë lexuesit e tij por edhe lamtumire, edhe disa tregime, katër prej të cilave nuk ishin botuar më parë. Karlos Ruiz Zafon e konceptonte këtë vepër, përvçe se në vetvete, si një mirënjoyje për lexuesit e rij, të cilët e kishin ndjekur përgjatë gjithë sagës që filloi me *Hija e erës*. Sot, për shkak të karakterit postum të botimit, shndërrrohet edhe në një homazh të shtëpisë botuese për vetë Autorin, një mirënjoyje së cilës, me siguri, do t'i bashkohen lexuesit e njërit prej shkrimtarëve më të admiruar të kohës sonë.<sup>5</sup>

4 Gazeta Shqiptare, Të katra historitë e mia. fq. 27, 2 dhjetor 2012

5 Flavia Kaba, *Qyteti i avullit*, Shtëpia Botuese Dituria, fq. 7, 2021

Këto tregime risollën atmosferën, vendet, personazhet, misteret, terrin, botën gotike, etj. që u formësuan dhe rrodhën nga tetralogjia e Varrezës së Librave të Harruar. *Gaudi në Manhattan* njëri nga tregimet, u botua në vitin 2002 në faqet e së përditshmes spanjolle *La Vanguardia*, duke qenë se Barcelona e shpalli vitin 2002<sup>6</sup> si vitin ndërkombe të Gaudit për të përkujtuar arkitektin e famshëm spanjoll në 150 vjetorin e tij të lindjes. Po kjo e përditishme spanjolle do të botonte edhe një tjetër tregim të Zafonit, *Legjenda e Krishtlindjes*.

Këto dy tregime, së bashku me *Gruaja e avullt* – të shfaqura te e përditshmja *El País* - dhe *Alisia në agim*, asokohe e pabotuar, formësuan librin e vogël *Barcelona Gotike*, botuar nga Librat e Vanguardia dhe Librat Renfe brenda projektit “tregime në tren” të vitit 2008, për të nxitur leximin hekurudhor.

Po atë vit, *Shtëpia Botuese Planeta* realizoi një edicion promovues të *Alisia në agim* së bashku me tregimin *Burra në gri*. Gjithashtu në edicionin e Planeta u shfaq në vitin 2012 tregimi i gjatë, pothuajse një *nouvelle*, *Princi i Parnasit*, i vendosur në Barcelonën e shekullit të XVI dhe me personazh Migel de Servantes, ku Ruiz Zafon shënjoin gjurmët mbi gjenezën e Varrezës së Librave të Harruar, kontribut i tij tashmë i pashlyeshëm në mitologjinë letrare.

Një tjetër tregim, paksa më i shkurtër, *Trëndafili i zjarrit*, u shfaq në revistën *La Vanguardia* në vitin 2012.<sup>7</sup>

### Zafon, sukses i jashtëzakonshëm në Shqipëri

Shkrimitari spanjoll bashkëkohor është përkthyer në mbi 45 gjuhë të huaja dhe në të pestë kontinentet dhe në Shqipëri ky kolos i letërsisë spanjolle ka ardhur falë botimeve të Shtëpisë Botuese Dituria. Botimet e Zafonit, ndryshe nga trajektorja e tij letrare e lartpërmendur me datat përkatëse për çdo botim, në Shqipëri janë sjellë deri diku me disa ndryshime datash, kjo si rrjedhojë e kohës që i është dashur qoftë shtëpisë botuese për marrjen e të drejtave të autorit por edhe përkthyesit për të sjellë të shqipëruar veprën zafoniane. Ndërkohë që në Spanjë libri që i solli famën ndërkombe të botua në vitin 2001, *Hija e erës*, te ne, do të vinte aq mjeshtërisht e përkthyer nga i madhi dhe i ndjeri Ardián Klosi nga gjuha gjermane në vitin 2006. Si një hixe që frys mbi ne, për të ringjallur dashurinë, përveten dhe të tjerët. Vjen e nuk mundet të ndalet, edhe kur ata që duan ta mbajnë i kanë drejtuar armën e kohës moderne: harresën e fjalës dhe dashurisë! Ky do të jetë gjithnjë shkrimitari, ose më saktë, pasoja e shkrimitarit – fjalë -, të cilën moderniteti kërkon ta lërë në një stacion ku trenat nuk nisen e mbërrijnë kurrë. Por era e dashurisë përfjalën dhe fuqinë e saj do ta fryjë. Do ta fryjë për të ecur gjithnjë më shpejt se treni

6 [https://elpais.com/cultura/2002/06/02/actualidad/1022968801\\_850215.html](https://elpais.com/cultura/2002/06/02/actualidad/1022968801_850215.html)

7 [https://www.elespanol.com/cultura/20201117/pistas-carlos-ruiz-zafon-relatos-ineditos-postuma/536697306\\_0.html](https://www.elespanol.com/cultura/20201117/pistas-carlos-ruiz-zafon-relatos-ineditos-postuma/536697306_0.html)

modern i pafjalësisë.<sup>8</sup>

Romani i dytë i sagës i përkthyer po aq mjeshtërisht nga përkthyesja Ledia Dushi nga gjuha italiane, do t'i prezantohet lexuesit shqiptar në vitin 2009 për të vazhduar më pas me veprën e tretë të kësaj sage nën titullin *I burgosuri i qiellit*, përkthyer nga Flavia Kaba nga gjuha originale e veprës, gjuha spanjolle, sjellë për lexuesin shqiptar në vitin 2012.

Sakaq, në vitin 2011, Ledia Dushi do të sillte në shqip librin *Marina* dhe në vitin 2014 Flavia Kaba do të sillte në shqip tre romanet e para për të rinj, me të cilat Zafon nisi karrierën e tij si shkrimtar, tre libra që u botuan në një botim të vetëm nën titullin *Trilogjia e mjegullës*.

Lexuesi shqiptar do të duhej të priste edhe shtatë vite të tjera për t'i dhënë fund kureshtjes mbi këtë sagë dhe pritjes kaq të gjatë me botimin e romanit përmbyllës të sagës nën titullin *Labirinti i shpirtrave*, sjellë në shqip sërish nga Flavia Kaba në vitin 2019.

Sakaq, lajmet se Zafon ishte duke përgatitur një tjetër roman për lexuesit e tij e ndërsa lexuesit në mbarë botën tekxa e prisnin këtë botim i riktheheshin leximit të veprave të botuara, më 19 qershor të vitit 2020, të gjithë zafondashësit do të tronditeshin nga lajmi i ndarjes së parakohshme nga jeta e këtij kolosi letrar. Në moshën 55 vjeçare, pas dy vitesh lufte të vazhdueshme me sëmundjen e keqe, Zafon do të dorëzohej për t'u ndarë kaq herët dhe kaq papritur nga jeta. Shtëpia Botuese Planeta, së cilës Zafoni paraprakisht i kishte besuar mbledhjen dhe botimin e tregimeve të tij, mundësoi botimin postum të veprës *Qyteti i avullit*, përkthimi në gjuhën shqipe i të cilit erdhi sërish nën emrin e Flavia Kaba në vitin 2021.

Të gjitha romanet e Zafon tashmë janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe janë mundësuar nga shtëpia botuese Dituria.

*Hija e erës* është botuar dhe ribotuar respektivisht në vitet 2006 me një tirazh prej 1500 kopje, në vitin 2009, 2013, 2016, 2018 dhe në vitin 2021 të njëjtin tirazh, 1500 për çdo ribotim.

Të njëjtin sukses ribotimi ka pasur edhe romani *Loja e engjëllit*, i cili botimin e parë e ka patur në vitin 2009 me një tirazh prej 2000 kopjesh për të vazhduar më pas në vitin 2013 me 1500 kopje, në vitin 2017 me 1000 kopje e së fundmi në vitin 2020 me 1500 kopje.

Libri për të rinj, *Marina*, do të sillej në gjuhën shqipe për herë të parë në vitin 2010 duke u botuar me një tirazh prej 1300 kopjesh për t'u ribotuar sërish në vitet 2014, 2017 dhe 2019 me një tirazh prej 1000 kopjesh. Romani i tretë i sagës së Varrezës së Librave të Harruar, *I burgosuri i qiellit* do të vinte për lexuesin shqiptar në vitin 2012 me një tirazh prej 1300 kopje, për t'u ribotuar më pas në vitin 2016 me 800 kopje dhe në vitin 2019 me 1200 kopje. Romani i fundit i sagës aq të dashur për lexuesin shqiptar, *Labirinti i shpirtrave*, do të batohej për herë të parë në vitin 2019 me një tirazh prej 2000 kopje.

*Trilogjia e mjegullës*, botimi ku janë përfshirë tre librat e parë të krijimtarisë së Zafonit, përkatesisht, *Princi i mjegullës*, *Pallati i mesnatës* dhe *Dritat e shtatorit*, do të batohej në vitin

2014 me një tirazh prej 1300 kopje, për t'u ribotuar më pas në vitin 2015 dhe në vitin 2019 me nga 800 kopje. E gjithë krijimtaria zafoniane do të mbyllt me botimin postum të librit të tij me 11 tregime, *Qyteti i avullit*, i cili u botua në vitin 2021 me një tirazh prej 1300 kopje.

Në shtypin vendas secili prej botimeve do të kishte jehonën përkatëse me tituj kumbues sikurse do të krijoeshin edhe shumë grupe apo forume zafondashëse në rrjetet sociale që, edhe sot, pas thuajse një viti nga ndarja ngajeta e Zafonit vazhdojnë ende të diskutojnë dhe shkruajnë mbi këtë ikonë letrare spanjolle.

Nuk kishte si të ndodhë ndryshe me këtë shkrimtar bashkëkohor spanjoll i cili jetën e tij letrare ia kushtoi lexuesit duke ia fituar zemrën me të gjithë romanet e tij. Edhe lexuesi shqiptar e priti me një entuziazëm të pashoq këtë shkrimtar duke i dhënë atij meritat e merituara dhe të njobura edhe nga ndërkombëtarët.

Kritikët ndërkombëtarë e kanë pozicionuar sagën e Varrezës së Librave të Harruar në kategorinë e “klasikëve bashkëkohorë” duke e cilësuar veprën e tij si një nga universet letrare më emocionuese të shekullit të ri.

Jehona e romaneve të Zafonit nuk do të shuhet kurrë edhe sepse jeta e tij u shua përgjithmonë duke lënë ndezur shpirtin që endet në labirintin e jetëve të çdo lexuesi. I paharruar do të jetë dhe do të kujtohet përherë në labirintet e jetëve dhe shpirtrave të çdo lexuesi anembanë.

Sikurse shkruante Zafon edhe në romanin e tij *Hija e erës*, “ekzistojmë për aq kohë sa dikush na kujton”, për aq kohë do të kujtohej edhe i madhi letërsisë spanjolle Karlos Ruiz Zafon.

## BIBLIOGRAFÍA

- Gazeta Shqiptare, *Të katra historitë e mia.*, fq. 27, 2 dhjetor 2012
- Kaba, Flavia, Et recordarem sempre, Carlos. Faleminderit Zafon. [www.startnews.com](http://www.startnews.com)
- Kaba, Flavia, *Qyteti i avullit*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2021.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Hija e erës*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2006.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Loja e engjëllit*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë `2009.
- Ruiz Zafon, Carlos, *I burgosuri i qiellit*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2012.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Labirinti i shpirtrave*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2019.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Trilogjia e mjegullës*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2014.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Marina*, Shtëpia Botuese Dituria, Tiranë 2014.
- Ruiz Zafon, Carlos, *La sombra del viento*, Shtëpia Botuese Planeta, Barcelonë 2001.
- Ruiz Zafon, Carlos, *El juego del angel*, Shtëpia Botuese Planeta, Barcelonë 2008.
- Ruiz Zafon, Carlos, *El prisionero del cielo*, Shtëpia Botuese Planeta, Barcelonë 2011.
- Ruiz Zafon, Carlos, *El laberinto de los espiritus*, Shtëpia Botuese Planeta, Barcelonë 2016.
- Ruiz Zafon, Carlos, *El principio de la niebla*, Shtëpia Botuese Edebë, Barcelonë 1993.
- Ruiz Zafon, Carlos, *El palacio de la medianoche*, Shtëpia Botuese Edebë, Barcelonë 1994.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Las luces de septiembre*, Shtëpia Botuese Edebë, Barcelonë 1995.
- Ruiz Zafon, Carlos, *Marina*, Shtëpia Botuese Edebë, Barcelonë 1999.
- Ruiz Zafon, Carlos, *La ciudad de vapor*, Shtëpia Botuese Planeta, Barcelonë 2020.

## SITOIGRAFÍA

- [www.carlosruizzafon.com](http://www.carlosruizzafon.com)
- [www.edebe.com](http://www.edebe.com)
- [https://www.elespanol.com/cultura/20201117/pistas-carlos-ruiz-zafon-relatos-ineditos-postuma/536697306\\_0.html](https://www.elespanol.com/cultura/20201117/pistas-carlos-ruiz-zafon-relatos-ineditos-postuma/536697306_0.html)
- [www.pressreader.com](http://www.pressreader.com)
- [https://elpais.com/cultura/2002/06/02/actualidad/1022968801\\_850215.html](https://elpais.com/cultura/2002/06/02/actualidad/1022968801_850215.html)

## PËRKTHIMI I KOPERTINËS NGA IMAZHI TE FJALA

**Dr. Viola Adhami**

Departamenti i Gjuhës Italiane  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: viola.adhami@unitir.edu.al

### PËRMBLEDHJE

Kërkimet në lidhje me përkthimin ndërsemiotik të kopertinave të librave nuk janë të shumta. Roli i elementeve paratekstuale në disa raste edhe nënveftësohet. Në këtë studim synojmë të analizojmë rolin e rëndësishëm të elementeve vizuale në tregun e përkthimit dhe ndikimin e drejtpërdrejtë që ai ka në shitjen e librave. Kopertinat e librave na jepin një përmbledhje vizuale të historisë dhe lexuesit krijojnë një përshtypje të parë për librin. Thelbi i librit është përkthyer në atë hapësirë të kopertinës. Studimi merret me përkthimin e ilustrimeve të librave dhe rolin e dizajnit në strategjitet e përkthimit që zgjedhin botuesit në epokën e globalizmit. Ata bëjnë një përzgjedhje të qëllimshme të shenjave vizuale që përfaqësojnë shenjat verbale. Këtu roli i dizajnerit është shumë i rëndësishëm.

Fjalët çelës: dizajn, kopertinë libri, ndërsemiotik, përkthim, vizual.

### ABSTRACT

Researches on the intersemiotic translation of the book covers are not so extensive. The role of the paratextual elements some time is even neglected. In this study it is attempted to analyze the important role of the visual elements in the translation market, and the direct influence on the book sale. Book covers provide a visual summary of the story and the readers create a first impression of the book. The essence of the book has been translated into the space of that cover. The paper explores illustration book translations and the role of design in the translation strategies used by the editors in the era of globalisation. They make a purposeful selection of visual signs to represent verbal signs. Here the role of the graphic designer is very important.

Key words: book cover, design, intersemiotic, translation, visual.

Kopertina e librave në fillesat e veta, tekstu sinkretik dhe praktikë sociale me një vlerë të madhe komunikuese, ishte thjesht një letër apo karton që mbronte librin. Nga fundi i shekullit të XV fillon të marrë funksionin e prezantimit të librit, shpesh edhe me imazh. Në Shqipëri kopertinat e librave me imazhe i gjejmë relativisht vonë aty nga fillimi i shekullit të XX. Kur më pas lind tregu i vërtetë i librit, afirmohet si një praktikë e botimit. Pra, vetëm me zhvillimin e proceseve të shtypit, fabrikimin e letrës, kromolitografinë, autotipinë, publikun e gjerë etj., ajo sot ka marrë një fuqi të madhe komunikuese dhe informuese.

### **Kopertina dhe përkthimi ndërsemiotik**

*“Kopertinat e librave mund t’i shikojmë si një portë përmes së cilës ne i hedhim një vështrim të shkurtër tekstit [...] Ato janë hyrja nga skena publike ku libri qëndron për tu shitur drejt botës më intime të tekstit ku autorri na flet vetëm neve”*

Kopertina kryen tri funksione kryesore: “mbrojtëse, zbulurues, publicitare”<sup>2</sup>. Sipas Genette<sup>3</sup> kopertina dhe periteksti editorial janë “vendi i markës”. Dhe këtu i drejtohemë teorive të Jean-Marie Floch-it që është marrë shumë me anën vizuale. Sipas tij marka është “një çështje besimi, një marrëdhënie kontraktuale mes subjekteve ose, me terma semiotikë, kontratë vërtetësies”<sup>4</sup>. Ndërsa për Semprini-n: “marka ushtron një fuqi krijuese mbi produktin dhe produktifiton qenësi semiotike (po aq të rëndësishme sa ajo e vërteta) vetëm në masën që ia jep marka”<sup>5</sup>. Po të shohim kopertinën ajo i krijon lexuesit një hapësirë ndërmjetësimi dhe meditimi që ai të bëhet pjesë e një sistemi vlerash të reja ose edhe t’i refuzojë ato. Kemi të bëjmë me një rast emblematik periteksti dhe rast të veçantë “marke”. Kjo “veshje zbulurues” që kanë librat, ka funksion peritekstual. Pra, një nga elementet peritekstuale është pikërisht kopertina. *“Kopertina është një peritekst që – sipas Eco-s – mund ta përcaktojmë si të krijuar me qëllimin për të ekzistuar që të mund të përfaqësojë një tekst të caktuar. Gjithsesi, siç e dimë, semiotika merret me format e shfaqjes së kuptimit pavarësisht nga qëllimi i atij apo i atyre që e kanë realizuar, duke i përcaktuar si natyrore ose të qëllimshme.”*<sup>6</sup> Por elementi që e bën të dallueshëm një libër është imazhi në kopertinë. Si duhet të jetë ai imazh në kopertinë? E kundërtë e ekfrazës – e

1 Weedon, A. (2007). *In Real Life: Book Covers in the Internet Bookstore* N. Matthews&N. Moody, f. 117.

2 Puglisi, P. (2003) *Sopraccoperta*, Associazione Italiana Biblioteche, Roma, f. 11

3 Me termin paratekst, Genette përbledh tërësinë e elementeve që e rrethojnë ose e zgjasin tekstin, që ai “të jetë i pranishëm”. Parateksti përbëhet nga epiteksti dhe periteksti. I pari përcaktohet si “çfarëdo element paratekstual që nuk është brenda tekstit të të njëjtë libër, por që qarkullon në një farë mënyre i lirë, në një hapësirë fizike dhe sociale virtualisht të pakufizuar” (Genette, G. (1989) *Soglie, I dintorni del testo*, Einaudi, Torino, f. 337).

Periteksti është ajo pjesë e paratekstit që vendoset “rreth tekstit, në hapësirën e tekstit” Po aty, f.6.

4 Floch J.M. (2006) *Bricolage, Lettere ai semiologi della terra ferma*, Meltemi, Roma, f. 208.

5 Semprini, A. (1996) *La marca. Dal prodotto al mercato, dal mercato alla società* Lupetti, f. 31.

6 Eco, U. (1975) *Trattato di semiotica generale*, Milano, Bompiani, f.32.

përcakton Calasso<sup>7</sup>. Por nuk mjafton që imazhi të jetë i duhuri. Shumë sy të huaj duhet ta perceptojnë si të tillë. Ata nuk dinë ç'do të gjejnë në atë libër. "Situatë paradoksale, thuajse komike në parehatinë e vet." Imazhi që ofrohet në kopertinë duhet të jetë tèrheqës që një i panjohur ta zgjasë dorën pa hezitim dhe plot kureshtje për të parë se çfarë i ofron ky send për të cilin informacionet i ka pothuajse zero, përveç emrit të autorit (që shpesh e sheh për herë të parë), titullit, emrit të botuesit dhe, në varësi të librit dhe përkushtimit të shtëpisë botuese, edhe kthesës së kopertinës. "Por në të njëjtën kohë imazhi i kopertinës duhet të rezultojë të jetë ai i duhuri edhe pasi i panjohuri ta ketë lexuar librin. Në mos për gjë tjeter të paktën që të mos mendojë se botuesi nuk e di se çfarë ka botuar". Kështu këto veshje kthehen në metafora të kopertinave të librave. Ka veshje që të rrinë mirë, ashtu sikurse ka kopertina që janë të përsosura për librin që mbulojnë. Por disa veshje, nuk të shkojnë dhe një gjë e tillë mund të ndodhë edhe me kopertinat. Në ditët e sotme, ashtu siç thotë edhe Jhumpa Lahiri, kopertinat nuk shërbejnë vetëm për të mbajtur bashkë fletët e një libri, ato janë kthyer në një mesazh për lexuesin. Ato luajnë një rol shumë të madh në shitjen e librave. Sipas dizajneres Cora Spoladores "Nuk mund të harrojmë që kopertina është fytyra e librit, pra duhet të jetë e përsosur. Sa më tèrheqëse është ajo, aq më shumë do të flitet për librin".

Ne e dimë se gjuha jo verbale është po aq e rëndësishme sa edhe ajo verbale. Një skemë për interpretimin e aspekteve të kësaj gjuhe e ka realizuar semiotika sociale që ndryshe nga ajo tradicionale e Saussur-it, që përqendrohet tek pjesët e ndryshme të gjuhës të para si një sistem i vetëmjaftueshëm, studion përdorimin e shenjave (verbale dhe jo verbale) në një kontekst të caktuar socio-kulturor. Pra, teksti verbal dhe imazhi në një kopertinë duhet të studiohen si një i vetëm pasi të dy komunikojnë me lexuesin. Elementi pamor u kthye në një pikë të fortë të vizionit të vet estetik dhe kulturor nga Futurizmi, element që u ndoq më pas nga një revolucion edhe në shtyp, një faqosje që me zgjedhjet grafike tèrheq publikun me anë të emocionit. Gunter Kress dhe Theo Van Leeuwen, në librin e tyre na thonë pikërisht këtë: "Imazhi dhe teksti verbal duhet të studiohen si një e tèrë, duke pasur kujdes kompozimin e hapësirave, në mënyrë që të identifikohet vlera e elementeve me informacionin e nevojshëm që ato kërkojnë të shprehin, vendosja dhe ndërthurja e elementeve që përbëjnë dhe përqellin mesazhin"<sup>8</sup>

Atë që teksti e shpreh nëpërmjet gjuhës, përmes zgjedhjes së fjalëve dhe strukturave semantike, në komunikimin vizual shprehet me anë të ngjyrave, sipas një përzgjedhjeje të caktuar, apo strukturave të ndryshme të kompozimit.

Kopertinat e librave ofrojnë një përbledhje vizuale të përbajtjes së një libri për lexuesit që mund ta lexojnë atë. Kopertina e një libri përmban elemente verbale dhe

<sup>7</sup> Ekfraza ishte një term që përdorej në Greqinë e lashtë, për të treguar atë proces retorik, që konsiston në përkthimin në fjalë të veprave të artit. Ekzistojnë shkrime – si *Imazhet e Filostratit* – që i kushtohen vetëm ekfrazave. Mes modernëve, virtuozi më i madh i ekfrazës ka qenë Roberto Longhi, duke mos harruar mjeshtrin e pakrahasueshëm të ekfrazës Baudelaire-in. (sh.a.)un

<sup>8</sup> Gunter Kress & Theo Van Leeuwen, (2006) *Reading images. The grammar of visual design*, Routledge, f.45.

vizuale. Elementet verbale janë: emri i autorit, përkthyesit, titulli, emri i botuesit, etj. Këto janë të dhëna tipografike. Elementet vizuale janë: piktura, imazhe fotografike dhe ilustrime të cilat janë të dhëna mbi imazhin. Genette i klasifikon të gjitha këto elemente si pjesë të peritekstit. Shenja të forta për të përfaqësuar gjeste të forta interpretuese, përkthime vizuale herë-herë të tejskajshme, herë të tjera tërësisht të lexueshme, që prezantojnë një fytyrë të re dhe të pasur të fushës së botimit. Në format e tij nga më të ndryshmet imazhi i kopertinës nuk e zbulon magjinë e librit, por ndërsa lexuesi e përkthen, i krijon atij një ide dhe nis kështu një marrëdhënie e ngushtë me tekstin e shkruar.

Përshtypjen e parë lexuesi e krijon në mendjen e tij nga imazhi në kopertinë. Pra, ana vizuale e kopertinës i jep atij një mesazh të parë për librin. Përbajtja e tij përkthehet në atë imazh që ai ka përpara syve, pikërisht të atij libri që e ka tërhequr dhe tan po e mban në dorë.

Kopertina lind si përkthim ndërsemiotik i tekstit letrar, por nuk duhet të harrojmë se aty gjejmë shumë forma interpretimi që i përkasin formave të ndryshme të grafikës dhe ikonografisë që lidhen me gjini të caktuara letrare apo forma të tjera grafike që identifikohen me një kolanë të caktuar apo zgjedhje grafike që përfaqëson identitetin e shtëpisë botuese për ta dalluar atë nga shtëpitë e tjera botuese. Mund të përmendim dizajnin në kolonën e poezisë së shtëpisë botuese Faber&Faber, kopertinën me relief dhe shkronja të arta të shtëpisë botuese Ombra GVG, logon e kalit të detit të shtëpisë botuese Aleph që ndryshon ngjyrë sipas kopertinës, të bardhën e kopertinave të shtëpisë botuese Einaudi etj.

Si teksti ashtu edhe imazhi lexohen, lexohet edhe konteksti socio-kulturor, dhe në këtë rast merr një vlerë të jashtëzakonshme në kuptueshmërinë dhe suksesin e një fushate publicitare. Sot gjuha e imazheve ka të njëjtën vlerë dhe rëndësi në procesin e kuptueshmërisë, ndonëse funksionet që kryejnë janë të ndryshme dhe plotësojnë njëratjetren. Kodet publicitare veprojnë në një regjistër të dyfishtë verbal dhe pamor. Kur imazhi dhe teksti i shkruar janë pjesë e një kopertine-reklamë, studimi i gjuhës nuk mund të bëhet pa studimin e anës vizuale, që do të thotë se përkthimi nuk mund të jetë i plotë pa kombinimin e të dyjave. Kjo do të thotë që si në përkthimin e tekstit të librit, ashtu edhe në përkthimin e anës vizuale të kopertinës nuk duhet të harrojmë përshtatjen me konteksttin kulturor në të cilin vjen përkthimi. Çdo element i imazhit ka vlerën e vet. Dhe vetë ngjyrat e zgjedhura luajnë rol vendimtar. “Çdo ngjyrë ka karakteristika të ndryshme që nuk duhen anashkaluar gjatë procesit të disenjimit”<sup>9</sup>.

<sup>9</sup> Pastoureau M., Simonnet D., (2006) *Il piccolo libro dei colori*, Ponte delle Grazie, Milano, f.148.

## Dizajni si proces përkthimi

Një vepr arti siç është kopertina mund ta shohim si një tekst që vjen nga një proces përkthimi. Dizajni është përkthim, sepse së pari ka të bëjë me një *akt semiosik*, aty ku merr jetë kuptimi, vetë semiosi sipas Petrilli-t është një proces përkthimi”<sup>10</sup>, është pra një akt që dizajni e ka të njëjtë me përkthimin: të jetë faktor në *ndërmjetësim* dhe *qasjen* e një tërësie përbajtjes tek lexuesi. Dikush do të hyjë në një botë semantike se nuk di “gjuhën” ose sepse nuk arrin “ta shohë” qartë apo edhe për shkaqe të tjera, kjo është dhe arsyja përsë përkthehet. Në fakt jeta jonë kulturore sipas Peirce-t është e konceptuar si një varg shenjash dhe mendimesh që janë në një gjendje të vazhdueshme interpretimi; ne i perceptojmë gjérat nga shenjat, çdo njoftje e re na vjen në perceptim nga një e mëparshme. Studimi semiotik më i rëndësishëm mbi përkthimin, që i merr fillesat pikërisht nga teoria e Peirce-t është ai i Jakobsonit, eseja ku morën formë tri llojet e përkthimit, që rimerret pastaj nga George Mounin, Umberto Eco, Susan Bassnet me shembujt e shumtë të Translation Studies etj. Le të ndalemi pak në arsyetimin e Zingale-s duke qenë se kemi një akt ndërmjetësimi dhe *njohjeje* si në rastin e dizajnit, ashtu edhe të përkthimit. Kjo bën që të dy të mbështeten në logjikën e një funksioni matematikor ku teksti-artefakt ose teksti mbërritës (TM) është ndryshore që varet nga teksti burimor (TB), që përbën ndryshoren e pavarrur:

$$TM=f(TB)$$


Duke u nisur nga sa më sipër mund të themi se një imazh i krijuar për një kopertinë është një nga shumë format e mundshme të shprehjes që mund të burojnë nga teksti i shkruar. Pra dizajnerit nuk i kërkohet të “krijojë” por të përkthejë në *imazh*, gjë që mund të bëhet në variante nga më të ndryshmet, ashtu si edhe të shumta janë përkthimet e një teksti nga njëra gjuhë në tjetër. Për ta ilustruar do të marrim dy shembuj të ndryshëm duke marrë në konsideratë edhe dy mënyrat e ndryshme të kalimit nga njëra gjuhë në tjetër *lokalismin* dhe *internacionalizmin*. Lokalizmi ose *target-oriented*, është mesazhi i personalizuar, për çdo vend dhe kulturë mbërritëse, ku respektohen të gjitha ndryshimet kulturore dhe gjuhësore të popujve, duke i dhënë një rëndësi të veçantë targetit me të cilin krijon komunikimin.<sup>11</sup>

Shikojmë fillimi i dizajnit e kopertinave të librit të shkrimit të njohur italian Claudio Magris, botuar në vende të ndryshme të botës. Këtu më poshtë kemi sjellë imazhet e kopertinave të disa librave të botuar. Shohim se imazhet janë pothuajse të njëjta me origjinalin në gjuhën italiane. Në këtë rast kemi të bëjmë me internacionalizëm të imazhit të kopertinës. Përkthimi i kopertinës mbetet i njëjtë në gjuhë të ndryshme. Kopertina shpreh qartë për lexues të ndryshëm atë që ata do të gjejnë në libër, në

10 Petrilli, S. (2014) *Riflessioni sulla teoria del linguaggio e dei segni*, Mimesis, Milano. f.96.

11 Adhami, V. (2015) *Përkthimi, publiciteti dhe globalizmi - studim përkthimologjik krahasues me tekste publicitare në italisht dhe shqip*, punim doktorate, f.102.

kombinim me anën verbale të kopertinës (autori, titulli, logoja), ana vizuale, pra, imazhi zbulon marrëdhënet mes peizazhit, kohës, identitetit dhe pasigurisë, hijes së vdekjes. Ngjyrat në kopertinë të sjellin aromën e mëngjesit dhe të muzgut, në përgjithësi janë tone të “ftohta” të blusë dhe jeshiles që sjellin qetësi, por edhe ligështim. Protagonistë të ngjarjeve të librit janë edhe gurët, valët, rëra, banorët e ishujve, jetët e njerëzve dhe misteret që mbartin. Të gjitha këto momente vijnë në mendjen e lexuesit që merr librin në dorë. Dhe konteksti kulturor dhe social në këtë lloj përkthimi i kalon kufijtë e shteteve dhe merr përmasa globale.



Më poshtë shohim disa nga kopertinat e librit “Prilli i thyer”, të shkrimitarit të famshëm, Ismail Kadare, të botuar në vende të ndryshme. Në këtë rast kemi të bëjmë me lokalizëm të kopertinave. Në kopertinën e botuar në Shqipëri, imazhi përcjell mjaft mirë tragjizmin e historisë, personazhi me veshje tipike të malësorit, rruga e vështirë ku kalon karroca, tonet e ngjyrave ku mbizotërojnë tonet e forta të portokallisë dhe të kuqes - ngjyra të gjakut, të luftës, ngjyra emocionale që irisin rrahjet e zemrës dhe frysëmarrjen. Ndërkokë në kopertinat e librave të përkthyer nuk gjemjë asnjë element karakteristik të vendit nga vjen ngjarja. Kopertinat janë përkthyer duke u përshtatur me kulturën dhe kontekstin social të vendeve mbërritëse. Në botimin portugez këmisha me gjak dhe natyra që të kujton një perëndim buzë detit.



Në botimin italian imazhi me kodrinat, dritën, shtëpitë dhe personazhin në rrugë e krijon atmosferën e pezullt që vërtitet në ajër. Diçka ka ndodhur ose pritet të ndodhë. Në botimin izraelit imazhi të bën të mendosh se diçka ka ndodhur në mes të një pylli që të kujton atë tropikal. Në botimin anglez ngjyrat janë në harmoni me ngjarjen; e zeza e romaneve triller, e kuqja e titullit, e bardha që dhe ajo përfaqëson vdekjen, pushka në dorën e personazhit, të gjitha këto elemente që i paraprijnë ngjarjes.

“Në *thelb*, *kopertina e librit* është si një reklamë që në *fillim* përdor *kuptimin vizual* për të tjerhequr vëmendjen drejt tekstit”<sup>12</sup>. Vetë arti është komunikim qoftë ai vizual apo verbal. “*Forma e multimodalitetit gjithnjë varet nga lloji(et) e kodeve që dikush dëshiron të përdorë për të shprehur një ide në një mënyrë të caktuar*”<sup>13</sup>.

## Përfundime

Përkthimi vizual është po aq i rëndësishëm sa dhe ai i verbal. Është një mënyrë komunikimi mes gjuhëve dhe kulturave të ndryshme. Nga analiza e kopertinave të ndryshme pamë se kopertina duhet të ngjallë të njëjtat ndjenja te lexues me shije të ndryshme dhe të arrijë të jetë térheqëse si për lexuesin e gjuhës burimore, ashtu edhe për atë të gjuhës mbërritëse. Përkthimi me anë të dizajnit është një formë shprehëse për të thënë qartë diçka që nuk mund të shprehet ndryshe, për të thënë ndryshe diçka që është thënë në forma të tjera, por ajo që është më e rëndësishmja na ndihmon për të krijuar lidhje me lexuesin. Ilustrimi i kopertinave në variante dhe forma nga më të ndryshmet, nuk e zbulon ngjarjen, por përkthimi i kopertinës është për lexuesin fillimi i një marrëdhënieje të ngushtë me historinë e shkruar.

12 Sonzogni, M. (2011) *Re-covered Rose: A case study in book cover design as intersemiotic translation*, John Benjamins Publishing Company, f.15.

13 Aba-Carina, P. (2019) *Intersemiotic Translation: Literary and Linguistic Multimodality*, Palgrave Pivot, f.32

## BIBLIOGRAFÍA

- ABA-CARINA P. (2019) *Intersemiotic Translation: Literary and Linguistic Multimodality*, Palgrave Pivot.
- ADHAMI V. (2015) *Përkthimi, publiciteti dhe globalizmi - studim përkthimologjik krasues me tekste publicitare në italisht dhe shqip*, punim doktorate.
- CALASSO R. (2013) *L'impronta dell'editore*, Adelphi, përkthyer dhe botuar në 2020 me titullin *Gjurma e botuesit*, Aleph.
- ECO U. (1975) *Trattato di semiotica generale*, Milano, Bompiani.
- FLOCH J.M. (1992) *Semiotica, marketing e comunicazione, Dietro i segni, le strategie*, Franco Angeli, Milano.
- FLOCH J.M. (2006) *Bricolage, Lettere ai semiologi della terra ferma*, Meltemi, Roma.
- GENETTE G. (1989) *Soglie, I dintorni del testo*, Einaudi, Torino.
- GUNTER KRESS & THEO VAN LEEUWEN, (2006) *Reading images. The grammar of visual design*, ROUTLAGE.
- JAKOBSON R. (1959) *On Linguistic Aspects of Translation* nw Brower, R. A. *On Translation*, Harvard University Press.
- JHUMPA LAHIRI (2016) *The Clothing of Books*, Vintage.
- PASTOUREAU M., SIMONNET D., (2006) *Il piccolo libro dei colori*, Ponte delle Grazie, Milano.
- PETRILLI S. (2014) *Riflessioni sulla teoria del linguaggio e dei segni*, Mimesis, Milano.
- PUGLISI P. (2003) *Sopraccoperta*, Associazione Italiana Biblioteche, Roma.
- SEMPRINI A. (1996) *La marca. Dal prodotto al mercato, dal mercato alla società* Lupetti.
- SONZOGNI M. (2011) *Re-covered Rose: A case study in book cover design as intersemiotic translation*, John Benjamins Publishing Company.
- WEEDON, A. (2007). *In Real Life: Book Covers in the Internet Bookstore* N. Matthews&N.  
[www.amazonbooks.com](http://www.amazonbooks.com)  
[www.yourfuturedesign.com](http://www.yourfuturedesign.com)
- ZINGALE S. (2012) *Interpretazione e progetto, Semiotica dell'inventiva*, Franco Angeli, Milano.

# VËSHTRIM HISTORIK E PËRQASËS NDËRMJET QASJEVE DHE METODAVE NË MËSIMDHËNIEN E GJH

**Prof.Asoc.Dr. Aida Gjinali**

Departamenti i Gjuhës Italiane  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: aida.gjinali@unitir.edu.al

**Prof.Asoc.Dr. Leonard Xhamani**

Departamenti i Gjuhës Italiane  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: leonard.xhamani@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Punimi në vijim ka si qëllim të sjellë një panoramë përbledhëse të qasjeve dhe metodave në mësimdhëni e gjuhëve të huaja që në filsat e tyre e deri më sot. Do të sjellim jo vetëm një këndvështrimin historik të tyre dhe përfaqësuesit përkatës, orientimin ku grupohen, por edhe karakteristikat, tiparet e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet tyre. Do të përpinqemi të japid kështu një përqasje modeste, pa pretendim ezaurues, e cila synon të vërvë në dukje teoritë ku ato bazohen, filozofinë bazë, aspektet gjuhësore, pedagogjike, kulturore dhe shkallën në të cilën secila prej tyre i merr në konsideratë, si dhe avantazhet dhe dizavantazhet përkatëse. Është më se e qartë që e gjithë moria e qasjeve dhe metodave nuk mund të përfshihet në këtë punim modest. Gjithsesi, jemi përpjekur të sjellim metodat që jo vetëm kanë lënë gjurmë në historinë e didaktikës botërore, por edhe ato që sot shërbejnë për formimin e përgjithshëm të mësuesit të gjuhës së huaj. Ato shërbejnë edhe si burim i nevojshëm informacioni, nga ku çdo mësues i gjuhës së huaj mund të vjelë atë çka e konsiderohen të vlefshme dhe të nevojshme për ta aplikuar në klasat e tij të gjuhës së huaj. Fjalë çelës: qasje, nxënës, metodë, metodologji, mësues.

## ABSTRACT

The following paper aims to provide an overview of approaches and methods in foreign language teaching from their inception to the present day. We will bring not only a historical point of view of them and the respective representatives, the orientation where they are grouped, but also the characteristics, common and distinctive features between them. We will thus try to give a modest approach, without exhaustive pretensions, which aims to point out the theories on which they are based, the basic philosophy, the linguistic, pedagogical, cultural aspects and the degree to which each of them takes into account, as well as respective advantages and disadvantages. It is very clear that the whole multitude of approaches and methods cannot be included in this modest paper. However, we have tried to bring methods that have not only left their mark on the history of world didactics, but also those that today serve the general formation of the foreign language teacher. They also serve as a necessary source of information, from which any foreign language teacher can pick up what they consider valuable and necessary to apply in his or her foreign language classes. Keywords: approach, method, methodology, teacher, student.

## Hyrje (Qartësime të disa çështjeve terminologjike)

Përpara se të fillojmë me paraqitjen e qasjeve e të metodave, objekt i punimit tonë, është e nevojshme të bëjmë disa qartësime të domosdoshme në lidhje me çështjet terminologjike që lidhen ngushtë me mësimdhënien dhe mësimnxënien e një gjuhe të huaj, por jo vetëm.

Nodoh shpesh që çështjet terminologjike glotodidaktike dhe dallimi dhe përkufizimi i quartë ndërmjet tyre të jetë objekt diskutimi, madje shpesh burim konfuzioni ndërmjet gjuhëtarëve, glotodidaktëve, mësuesve etj., sepse në shumë raste këto lloj përkufizimesh apo dallimesh interpretohen dhe përcaktohen ndryshe.

*“Pothuaj e gjithë literatura e gjuhëtarëve dhe psikologëve karakterizohet nga një konfuzion i veçantë, ndërmjet mësimit të një gjuhë të dytë apo mësimdhënies së një gjuhë të dytë” (Selinker 10:3, 1972:209)*

Termave të cilave po u referohemi janë si në vijim:

- Qasje
- Procedurë
- Metodologji
- Metodë
- Teknikë etj.

Çfarë është saktësisht një metodë?

Stern-i (Stern, 1983:452) thotë që një përkufizim i vërtetë se ç’është një metodë për mësimin e gjuhëve të huaja, nuk është arritur ndonjëherë.

Në vitet ’60, Anthony propozon fillimisht dallimin ndërmjet termave “qasje”, “metodë” dhe teknikë”, duke i vendosur në tri nivele me renditje hierarkike, të paraqitura në formën e një piramide (Rizzardi&Barsi, 2007:15). Aty konceptohet qasja si e përbërë nga një sërë teorish mbi natyrën e gjuhës dhe mbi procesin e të mësuarit, metodën si një bashkësi zgjedhjesh të bazuara mbi supozimet teorike të pozicionuara në nivelin e qasjes, për të seleksionuar, përshkallëzuar dhe paraqitur gjuhën që do të mësohet, ndërsa teknikat si procedura të vëna në veprim nga mësuesi në klasë.

Kështu, një teknikë bazohet te një metodë dhe si rrjedhojë te një qasje teorike.



Fig. 1 – Anthony, Qasja, metodat dhe teknikat, (Anthony,1963: 63-67)

Këtij propozimi të Anthony do t'i kthehen sërisht Richard e Rogers duke sugjерuar një propozim të ri, ku në pozicionin kryesor është metoda me të cilën lidhet “qasja”, “design” dhe “procedura”. Këto dy të fundit lidhen me teknikat e Anthony. Por në ndryshim nga Anthony, që vë në pozicion dominant qasjen, sikur është teoria ajo që përcakton në mënyrë ekskluzive metodën, Rodgers dhe Richard ngulmojnë mbi domosdoshmërinë që çdo element të jetë në ekuilibër dhe në harmoni me gjithë të tjera. (Rizzardi&Barsi, 2007:15)

Në lidhje me termin metodologji, vetë Rodgers në një artikull të tij (Rodgers, 2001)<sup>1</sup> zëvendëson termin metodë me metodologji. Me termin “metodologji” në përgjithësi do të përfshinte kuptimin e praktikave pedagogjike, teorive dhe kërkimit përkatës. Po në të njëtin artikull do të kërkojë të ofrojë kontributin e tij për qartësimin e termave “qasje” dhe “metodë”, duke nënvisuar që ato paraqesin një *continuum* që vë në një anë metodat me karakteristikat e tyre didaktike dhe nga ana tjetër qasjet që dallohen nga sugjerime me të përgjithshme që kanë të bëjnë me parimet teorike bazë.

Një tjetër ndarje në nivele epistemiologjike, të rimarrë nga Anthony, e gjejmë te Balboni, i cili i vendos sërisht konceptet në nivel hierarkie, duke vënë në krye fillimisht teorinë, por të pozicionuar jashtë sferës së kësaj ndarjeje, pavarësisht shkëmbimeve të vazhdueshme ndërmjet teorisë dhe qasjeve. Kjo, për arsyen e thjeshtë se detyra e një glotodidakti nuk është ajo që të përpunojë teori mbi gjuhën dhe kulturën, edukimin gjuhësor dhe të mësuarin. Glotodidakti duhet të marrë nga teoritë e përpunuara atë që i duhet për të zgjidhur problemin e edukimit gjuhësor.

1 Rodgers C. , Language Teaching Methodology, “Erik Clearnghouse on Language and Linguistic” Artikull, 2001. [http://www.cal.org/resources/digest\\_rodgers.html](http://www.cal.org/resources/digest_rodgers.html)

NIVELE EPISTEMOLOGJIKE	PARAMETRA VLERËSIMI
Teoria	E vërtetë/ false
Qasje E bazuar tek E aftë të gjenerojë një ose më shumë	E drejtë / e gabuar në qëllimet e saj E bazuar/ e pabazuar në teori të vërteta
Metoda Koherente me Dhe e aftë të realizohet në	Koherente/ jokoherente në brendësi të saj E përshtatshme / e papërshtatshme për të realizuar qasjen
Teknika Koherente me	Efikase/ joefikase në arritjen e objektivit Efikase/ joefikase në realizimin e metodës dhe qasjet.

Fig. 2 – Nivelet epistemiologjike të glotodidaktikës (Balboni, 1994: 48)

## 1. Qasjet, metodat dhe grupimi i tyre

Është e qartë që në çdo qasje dhe metodë mund të identifikosh parime të përbashkëta në lidhje me çështje: si të përshkruajmë një gjuhë, ç’do të thotë të njohësh një gjuhë dhe kështu që çfarë sjell mësimdhënia / mësimnxënia e një gjuhë të huaj; cilat janë mekanizmat gjuhësorë, psikologjikë dhe socialë që një folës duhet të zotërojë për të marrë pjesë aktive në një ndërveprim komunikativ; cilat situata apo praktika didaktike favorizojnë mësimin e gjuhës.

Duke u bazuar pikërisht nga përgjigjet në lidhje me këto çështje, qasjet dhe metodat janë grupuar në tri orientime: gjuhësor, komunikativ dhe humanist –afektiv (Rizzardi & Barsi: 17).

- a) Në orientimin gjuhësor gjemjë dy lloj metodash:
  - Deduktive/ konjitive, ku futen: metoda gramatikore – përkthyese, metoda e leximit dhe qasja konjitive.
  - Induktive, ku futen: metoda direkte, metoda oral-situacionale, audiolinguale dhe audiovizive.
- b) Në orientimin komunikativ futen:
  - Silabi situacional, metoda komunikative apo nociional- funksionale dhe qasja leksikore.

c) Në orientimin humanist-afektiv futen:

- Konsulencia në grup, metoda e heshtjes, metoda TPR e përgjigjes fizike totale, modeli didaktik bimodal, modeli i intelijencave të shumëfishta, programacioni neurolinguistik, të mësuarit kooperativ, qasja natyrore dhe sugestopedia. Rizzardi & Barsi, 2007:21)

## 1.1 Klasifikimi dhe ndarja sipas M. Danesi-it

Danesi në librin e tij propozon një klasifikim tjetër të bazuar kryesisht mbi tipologjinë psikolinguistike.

Kateg. tipologjike	Deduktive		Induktive	Funksionale	Humaniste-Afektive
Metodat kryesore	Gramtikore-përkhyyese	Konjitive	Direkte Intensive konstrastuese Audio-orale Audiovizive	Nocional-funksionale Komunikative	TPR Konsulencia në grup Natyrale Silent Way (metoda e heshtjes) (Strategic interaction) Ndërveprimi Strategjik
Baza gjuhësore	Asnjë/formale tradicionale	Gjenerativiste– transformacionale	Strukturalizmi	Sociolinguistica Pragmalinguistica	
Bazat psikologjike	Të papërcaktuara	Psikologjia konjitive	Neokomportamentizmi	Konjitzivizmi Gestalt	Psikologjia humaniste
Objektivat parësore	Kompetenca gjuhësore			Kompetenca komunikative	
Roli i mësuesit	Qendror dhe drejtues			Ndërveprues	I larmishëm

Fig. 3 – Klasifikimi sipas Danesi-t (Danesi, 1988:30)

Më vonë, në vitin 2005, Danesi propozoi një klasifikim të ri, duke i ndarë qasjet dhe metodat në katër kategori thelbësore:

- Metoda deduktive-konjitive, ku parashikohet që rregullat e gjuhës të mësohen qartazi të shtjelluara: p.sh. metoda gramatikore-përkthyese;
- Metoda deduktive - që i mundësojnë nxënësit të bëjë hipoteza dhe të kuptojë me intuitë rregullat bazë te një tekst, siç ndodh në metodën direkte dhe atë audio-orale;
- Qasjet komunikative – të cilat kanë si qëllim të mësojnë aftësinë e komunikimit efikas në GJH;
- Metodat afektive – sipas së cilave mësimi i gjuhëve ndodh në një ambient të qetë, duke i dhënë përparësi aspekteve afektive dhe emotive gjatë procesit të nxënies (Danesi, 2005:30).

## 1.2 Klasifikimi sipas S. Borneto-s

Borneto i ndan qasjet dhe metodat sipas një vlerësimi të bërë në bazë të aspekteve teorike gjuhësore – pedagogjike, objektivave didaktike, llojeve të veprimitarive dhe materialeve të përdorura.

Humaniste afektive	Komunikative	Individuale
Community Language Learning (C. Curran)	Qasja Komunikative (D. Hymes)	Natural Approach Qasja natyrore (S. Krashen)
TPR (J. Asher)	Project work (N. Prabhu)	Të mësuarit shumëgjuhësh (C. Benveniste)
Sugestopedia (Lazanov)	Interazione strategica /Strategic Interaction (R. Di Pietro)	Të mësuarit individual (L. Dickinson)
Silent Way (C. Gattegno)	Kompetenca ndërkulturore (S. Bachmann)	Teknologjité reja (R. Marigliano)
	Qasja leksikore (Willis e Lewis)	

Fig. 4 – Klasifikimi i S. Borneto-s (Borneto, 1998:17-18)

### 1.3 Klasifikimi sipas Catricalà-së

Një klasifikim tjetër vjen nga Catricalà, në të cilin vlerësohen qasjet më aktuale dhe i ndan ato ndërmjet metodave që i referohen nga njëra anë glotodidaktikës “Epokës së vjetër” dhe nga ana tjetër i referohet glotodidaktikës që bazohet në përfshirjen tërësore dhe në relaksimin që quhet “Epokë e re”. (Vignozi, 2001:3-19)

Epoka e vjetër	Epoka e re
	Community language learning (C.Curran)
TPR (J. Asher)	Sugestopedia (Lazanov)
S.A.L.T Suggestive-accelerative learning and teaching (Shuster dhe Gritton)	S.A.L.T Suggestive-accelerative learning and teaching (Shuster dhe Gritton)
Silent Way (C. Gategno)	
Qasja Komunikuese (D.Hymes)	
Project Work (N.Prabhu)	
Strategic interaction (R. Di Pietro)	
Kompetenca Ndërkulturore (S. Bachmann)	
Qasja Leksikore (Weillis dhe Lewis)	
Qasja Natyrore (S. Krashen)	Qasja Natyrore (S. Krashen)
Të mësuarit shumëgjuhësh (C.Benveniste)	Të mësuarit shumëgjuhësh (C.Benveniste)
Të mësuarit individual (L. Dickinson)	Të mësuarit individual (L. Dickinson)
Teknologjitetë reja (R. Marigliano)	Teknologjitetë reja (R. Marigliano)

Fig. 5 – Klasifikimi i Catricalà-së

### 1.4 Klasifikimi sipas kriterit të llojit kronologjik

Kriteri i llojit kronologjik është mjaft i përhapur dhe i thjeshtë për t'u ndjekur, me qëllim klasifikimin e qasjeve dhe metodave. Ky kriter analize merret me studimin e rrymave kryesore dhe propozimeve didaktike, duke filluar pak a shumë në një datë apo

periudhë historike në të cilat ato shfaqen. Kjo ndarje kronologjike në bazë të një date apo periudhe bëhet për të përcaktuar çfarë ka qenë para dhe pas. Ndaj dhe data simbolike e lindjes së glotodidaktikës si shkencë është viti 1942, kur Bloomfield publikoi një ese që revolucionoi botën e mësimdhënies së një gjuhe të huaj. (Gambiaghi et alii, 2004: 22)




Fig. 6 – Ndarja kronologjike

## 2. Renditje e shkurtër e disa qasjeve dhe metodave

Lidhur me këtë rubrikë, është më se e quartë pamundësia për të sjellë çdo qasje dhe metodë në veçanti, ndaj do të paraqesim qasjet apo metodat me karakteristikat e tyre, sipas një ndarjeje kronologjike në periudhat kohore të shfaqjes së tyre dhe sipas grupimit të kryer nga Balboni. (Balboni, 2001: 234-243).

- periudha e parë: Shek XVIII – XIX, Qasja formaliste;
- periudha e dytë: Metodat Natyrale/ Direkte 800- 1940;
- periudha e tretë: 1940 – 1960 Qasja Strukturaliste;
- periudha e katërt: 1960- Qasja kommunikative dhe Humaniste afektive;

### 2.1. Qasja formaliste

E gjen formalizimin e saj në Prusi në fund të 700-s dhe përhapet në Evropë në shekullin pasardhës, derisa arriti në ditët tona (Rizzardi&Barsi, 2017:28). Fillimisht nuk pati ndonjë emërtim të saktë për këtë lloj mësimdhënieje, e cila u ndikua nga një realitet që shndërrohej vazhdimi (Rizzardi&Barsi, 2017:28).

Në këtë qasje futen:

- Metoda gramatikore përkthyese
- Metoda e leximit (Reading Method)

Duke e nisur me metodën gramatikore përkthyese që fillesat dhe konceptimin e saj e hasim që në fillim të viteve 1770. Kjo konsiderohet si metoda e bazuar në teoritë

gjuhësore e llojit përshkrues dhe e gramatikës së Port Royal. Studiuesit Seidenstück e Plitz, me procedim deduktiv, kryesor ishte mësimi i rregullave gramatikore të shpjeguara nga mësuesi dhe aplikimi i tyre në ushtrime, analiza dhe mësimi i gjuhëve klasike aplikuar kjo në gjuhët moderne, përsëritje e vazhdueshme mekanike e rregullave dhe strukturave gjuhësore, memorizmi i listave të fjalëve. Fjalia, njësia bazë për t'u analizuar. Aftësitë që zhvilloheshin, ishin lexim e përkthim. Përdorimi i Gj1 i rëndësishëm në përkthim, por edhe në krahasimet ndërmjet gjuhëve. Gabimi konsiderohet i pafalshëm. Roli i mësuesit, qendror dhe direktiv, paraqet modelin që duhet të ndiqet. Roli i nxënësit pasiv, receptiv. Aspektet negative janë kryesisht në disfavor të nxënësit, i cili nuk arrin të ketë jo vetëm një shqiptim të saktë, por edhe vështirësi në lidhje me komunikimin, duke qenë se mungesa e situatave komunikative sjell pikërisht mungesë të zhvillimit të aftësive prodhuese komunikuese.

## 2.2 Metodat Natyrale/ Direkte

Përfshihen:

- Metoda Natyrale
- Metoda Orale
- Metoda e Berlitz

Ato u quajtën në këtë mënyrë, pasi në filozofinë e tyre bazë kanë stimulimin e mësimit natyror të gjuhës në kushte të njëjta me ato të Gjh1. Metodat natyrale/direkte e kanë zanafilën e tyre si një reagim ndaj qasjes formaliste dhe problematikave të saj të dukshme. Reformë kjo që pati përfaqësuesit e saj gjuhëtarë si: Vietor (1882), Gouin (1980) Passy, Jespersen (1904) etj. Ato pikënijsen e kanë në Angli, Amerikë dhe Zvizër, dhe bazohen në mësimin e gjuhës së huaj, duke ndjekur të njëjtin përvijim të mësimit të gjuhës mëmë. Pra koncepti thelbësor i mësimit të gjuhës bazohet në infantilizmin e studentit, i cili duhet të ndjekë të njëjtat hapa të mësimit të gjuhës. Në këto metoda gjuha i ofrohej nxënësit në formën globale të saj. Vetëm më pas dhe në mënyrë të reduktuar i ofrohen sérish në formë të shtjelluar. Aftësia komunikuese konsiderohet si ajo më e rëndësishmja ndaj dhe komunikimi është parësor, por i bazuar në modele që jepen të gatshme nga mësuesi. Këto metoda kanë karakter induktiv. Ato përdorin teknika të bazuara në dramatizim, imitim, imazhe dhe gjeste. Karakteristika kryesore e tyre është përdorimi vetëm i gjuhës së huaj dhe mundësish sa më autentike në mësim. Inputi është original në gjuhë të huaj, duke u konsideruar kështu metoda monolinguiste, e cila përashton totalisht përdorimin e Gjh1, ku dhe mësuesi duhet të jetë italofon, anglofon etj., duke pasur parasysh faktin që ai është ofrues i stimujve, i feedback-ut dhe modelit përfshirës i cili u ndryshojnë: mësuesi është tashmë një mësues ftues, nxitës, motivues, përfshirës i cili u

ofron input-et studentëve, duke u mundësuar atyre zhvillimin e aftësive komunikuese dhe autonome. Megjithatë këto metoda, bazuar mbi imitimin dhe përsëritjen, rezultojnë akoma mekanike, pasi nuk i ofrojnë studentit mundësinë që të krijojë strategjitet e nevojshme për t'u përballur me çdo lloj situate komunikuese jashtë territorit të klasës, pasi përdorimi i situatave komunikuese kufizohet në ato të sjella nga mësuesi.

### 2.3. Qasja Strukturaliste

Qasja strukturaliste lindi në Amerikë dhe bazohet në gjuhësinë taksonimike të Bloomfield dhe në psikologjinë e sjelljes (Behaviorizmi) të Skinner (Skinner, 1931) dhe Watson, Antropologut Boas dhe në gjuhësinë kontrastive të Lado-s (Lado, 1968:123-135)

Këtu futen metodat:

- A.S.P.T (The Army Specialized Training Program);
- Audio- orale.

Këto metoda lindin si domosdoshmëri e ndryshimeve në kontekstin historiko-politiko-ekonomik dhe social të botës në tërësi. Kontaktet ndërkontakte kërkonin një njojje të gjuhëve të huaja shumë më praktike dhe jo vetëm me karakter edukues dhe formues.

Në këto kushte dhe kërkesa të kohës, reforma e nisur nga studiuesit e lartpërmendur, duke cituar një artikull të Vietor (Howatt & Abercrombie, 1984: 340–363), i cili kritikonte fort mënyrën e ngurtë të mësimit të gjuhëve, ku theksohej që gramatika nuk duhet konsideruar një faktor vendimtar në mësimin e gjuhëve. Siç vëren edhe Stern (Stern, 1983: 45), në bazat e kësaj reforme kërkohet:

1. T'i jepet gjuhëve të huaja i njëjtin pozicion i barabartë me atë të lëndëve të tjera.
2. Emancipimin e gjuhëve moderne në krahasim me ato klasike.
3. Shndërrimin rrënjos të mënyrës së të mësuesit të gjuhëve të huaja.

Fillesat e tyre i gjejmë në Amerikë në fund të Luftës së Dytë Botërore dhe deti në vitet '60. Ato lindin si nevojë e domosdoshme e kohës dhe karakterizohen nga forma e mësimit masiv, me një numër të madh nxënësish, për një periudhë të shkurtër kohe, por mjaft intensive, ku kërkohet një përfshirje e plotë i nxënësit në mësimin e gjuhës.

Një ngjarje e rëndësishme në këtë kohë është themelimi i Association Phonétique International, kryesuar nga Vietor, i cili së bashku me fonetistin Passy përpunoi një sistem traskriptimi fonetik, që vijon të jetë në fuqi edhe sot. Passy (Passy, 1939: 31-59) në artikullin e tij shkruan:

- Mësimi i një gjuhe të huaj duhet të fillojë nga e folura e përditshme dhe jo nga letërsia.

- 
- Objektivi i mësuesit është që të bëjë të mundur që nxënësi të fitojë familjaritet me tingujt e një gjuhe të huaj.
  - Mësuesi duhet të japë për studim fjali të përdorimit të përditshëm dhe shprehje idiomatike më të përdorshme.
  - Ai do të qartësojë gramatikën në mënyrë induktive, duke filluar nga vëzhgimi i teksteve të lexuara. Studimi sistematik i saj duhet bërë në nivele më të përparuara.
  - Duhet të shpjegojë shprehje të gjuhës së huaj, duke i lidhur ndërmjet tyre pa iu referuar gjuhës mëmë. Përkthimi do të zëvendësohet me shpjegimin e kuptimin e fjalëve nëpërmjet objekteve, imazheve në gjuhën e huaj, duke i bërë që këto metoda të koniderohen si monolinguiste, ku Gj.h. 1 nuk zë vend.

Modeli i mësimdhënies së këtyre metodave bazohet në: interiorizimin e skemave të sjelljes të nënkuptuara si mekanizma të pandërgjegjshme që shfaqen në formë reagimi si rrjedhojë e stimujeve të jashtëm dhe mësimi realizohet nëpërmjet ekspozimit ndaj një serie të pandërprerë sekuencash stimul-përgjigje-përforcim dhe përsëritja e vazhdueshme, e cila përcakton një nxenie mekanike automatike. Ajo çfarë mësohet në klasë, duhet të transformohet në komunikim autentik në botën e jashtme. Mësuesi vijon të mbetet modeli për t'u imituar. Është ai që drejton laboratorin gjuhësor, teknologjitet glotodidaktike, verifikon përgjigjet, jep informacione kulturore në lidhje me vendin nga ku vjen gjuha. Nxënësi ka një rol pasiv. Detyra e tij është të mësojë e memorizojë sekuanca të tëra gjuhe që do t'i përdorë në situata të ndryshme, gjë që pengon autonominë dhe kreativitetin e nxënësit, i cili u referohet vetëm atyre strukturave të mësuara në klasë. Kjo i bën këto metoda të ofrojnë një të mësuar mekanike të gjuhës, përsëritës, pa i krijuar nxënësit ato strategji konjitive të nevojshme për t'u përballuar me çfarëdo lloj situate komunikuese edhe të patractuar më parë në klasë.

Gjithsesi këto metoda sollën mjaft risi në fushën e mësimdhënies si:

1. Studimi fonetik i tingujve të çdo gjuhe në specifikën që ato paraqesin;
2. Iu dha rëndësi kuptueshmërisë dhe prodhimit oral të gjuhës;
3. Zhvillimi i tipologjive të reja të ushtrimeve dhe ajo që i dallon këto metoda, është nociioni i ri i *Pattern Drills*;
4. Përdorimi i magnetofonit dhe i laboratorëve të gjuhës.

## 2.4 Qasja Komunikuese

Nga vitet '50 vihet re një lëvizje e gjerë e gjuhësë post-strukturaliste që vë në diskutim shumë parime, mbi të cilat bazoheshin studimet e kryera deri në atë moment. Kjo e ndikuar nga shumë faktorë si:

1. Ndërkombëtarizimi marrëdhënieve kulturore dhe tregtare;
2. Emigrimi në zona jashtë Evropës;
3. Shkëmbimet kulturore të studentëve që gjithnjë e më shumë shkojnë të studiojnë jashtë shtetit, etj.

Gjuha fillon të konsiderohet jo më vetëm nga optika e karakteristikave të sistemit formal, por edhe në një formë veprimi në një kontekst komunikimi dhe kështu si një mënyrë për të vepruar në realitetin e përditshëm. Ky konceptim do të vijojë deri në vitet '80 dhe do të ketë një ndikim të madh në fushën e mësimdhënies, duke sjellë një koncept të ri, atë të *kompetencës komunikuese*, e nënkuqtaur si përdorimi i gjuhës në katër parimet e saj themelore:

1. Gramatikore
2. Psikolinguistike
3. Sociokulturore
4. Faktike

Kjo qasje bazohet në teoritë antropologjike të Malinowsky (1923) e Firth (1957) - rëndësia e kontekstit situacional, nocioni i komptencës komunikative të Dell Hymes (1972), Niveli Prag Van Ek (1975) Galli di Paratesi (Galli di paratesi, 1981:79), Teoria e akteve gjuhësore të ndërgjuhës Austin (1962), Searle 1969, (Searle, 1976), Teir (1975), Corde dhe Selinker, sociolinguistike të Fishman e Hymes dhe pragmalinguistike të Searle dhe Wittgenstein.

Metodat e kësaj qasje janë:

- Metoda Situacionale
- Nocional – Funksionale

Risitë e sjella në këtë qasje janë të lidhura ngushtë me faktin që të mësuarit jo vetëm që duhet të jetë i llojit iduktiv, por duhet të bazohet kryesisht te nevojat e nxënësit. Gjuha konceptohet si një mjet komunikimi, si veprim shoqëror dhe ku mbizotëron vlera pragmatike e saj. Ajo mbi të cilën vihet theksi, është zhvillimi i kompetencës komunikuese shumë më tepër se njohja e gjuhës nga ana formale e saj. Sigurisht, kompetenca gjuhësore është e rëndësishme dhe nuk duhet anashkaluar, por kompetenca gjuhësore është ajo mbi të cilën duhet të vihet theksi. Gjuha nuk konceptohet më e shkëputur nga aspektet me të cilat ajo është e lidhur ngushtësisht si ato pragmalinguitike, paralinguitike dhe sociopragmatike.

Pra qasja komunikuese bazohet në një vizion pragmatik të gjuhës dhe nuk e sheh atë vetëm si një seri rregullash gramatikore, termash dhe strukturash, por si një mjet për të vepruar në botë duke komunikuar. Çdo shprehje gjuhësore ka kështu një funksion dhe ky funksion duhet të përshtatet në kontekstin ku ai do të shprehet. Karakteristika më thelbësore e kësaj qasje është strukturimi i leksioneve në njësi didaktike. Gjithashtu edhe roli i mësuesit mvishet me funksione të tjera. Ai nuk njeh vetëm gjuhën, por edhe kulturën, qytetërimin, rregullat shoqërore të vendit nga ku ka origjinën gjuha si objekt

studimi. Ai njeh dhe përdor teknologjitet e kohës.

Nxënësi vendoset në qendër të mësimdhënies dhe mësimi zhvillohet duke u bazuar në nevojat specifike të tij.

## 2.5 Qasjet Humaniste Afektive / Alternative

Nga fundi i viteve '60 dhe fillimi i viteve '70, filluan të shfaqeshin në Evropë dhe në SHBA disa qasje, të cilat u përkufizuan si “Qasjet humaniste- afektive” apo “Alternative”. U quajtën *humaniste – afektive*, pasi ia drejtojnë krejtësisht vëmendjen e tyre individit-nxënës me karakteristikat specifike që paraqet si ato psikologjike, sociale etj. Dhe, *alternative* sepse i kundërviheshin metoda ekzistuese, duke i konsideruar pak apo aspak efikase në mësimin e gjuhës së huaj, si ajo gramatikore – përkthyese dhe audiorale. Teoritë në të cilat bazohen, janë ato të psikologjisë humaniste të Maslow e Roger, teorive psikodidaktike, studimeve mbi inteligjencën emotive, nxënies së gjuhës në moshë të hershme, roli i filtrit afektiv të Krashen (Krashen, 1981).

Qasjet dhe metodat që përfshihen në këtë grupim janë:

- Community Counseling (Curran 1976);
- Silent Way (Gattegno 1976);
- Total Physical Response (Asher 1977);
- Metoda sugjestedike (Lozanov 1979);
- Natural Approach (Krashen e Terrel 1983);
- Ndërveprimi strategjik (Di Pietro 1987).

Karakteristikat kryesore të përbashkëta të këtyre qasjeve në aspektin psikologjiko-pedagogjik janë të lidhura me:

- Përparësinë e pedagogjisë
- Vëniën në qendër të nxënësit
- Reduktimin e stresit

Në lidhje me aspektet konjitive:

- Multimodaliteti – aksesi input-it nëpërmjet shumë kanaleve receptive;
- Infantilizmi – kthimi në hapat e fëmijërisë, të njëjta për mësimin e gjuhës së huaj si ajo e gjuhës mëmë.

Në lidhje me të mësuarit ai është i llojit induktiv, ku në qendër të vëmendjes është nxënësi në tërësinë e qenies së tij, me të gjitha problematikat që ka dhe shfaq, duke u përpjekur pikërisht në lehtësimin dhe zgjidhjen e tyre, krijimin e një klime pozitive dhe relaksuese në klasë, përdorimi i shumë mjeteve, teknikave dhe instrumenteve për të mundësuar një akses sa më të favorshëm të input-ve të ofruara, ndjekje individuale e

nxënësit në rast problematikash të pazgjidhura, analiza e nevojave të nxënësit në të gjitha aspektet.

Konsiderohet i rëndësishëm zhvillimi i aftësive komunikuese, pa i vënë theksin shumë formës. Gabimi konsiderohet si një fazë kalimtare e nevojshme për të kaluar në një fazë tjetër më të përparuar.

Roli i mësuesit është ai i drejtuesit, lehtësuesit, këshilluesit dhe mbështetësit psikologjik. Motivimi është një aspekt shumë i rëndësishëm, i marrë në konsideratë nga këto qasje, duke vënë theksin te domosdoshmëria e këtij aspekti të lidhur ngushtë me efektivitetin, nxënien dhe memorizimin e informacionit.

Nxënësi është mjaf aktiv. Ai ndërvepron lirshëm si me anëtarët e tjerë të klasës, ashtu edhe mësuesin në detyrat të cilat i ngarkohen në grup, çift apo individual. Ai ndjehet i lirshëm të shfaqë nevojat dhe problematikat e tij, duke kërkuar përmirësim dhe zgjidhje të tyre.

Materialet e përdorura dhe teknologjitet janë të shumëllojshme, ndaj mësuesi duhet të jetë i përgatitur dhe i aftë në përdorimin e tyre. Materialet duhet të janë mundësishët sa më autentike.

Leksionet janë të strukturuara në njësi didaktike të organizuara në mënyrë të tillë, që të zhvillojnë të katër aftësitet primare dhe ato të integruara në mënyrë harmonike dhe në të njëjtin nivel, në mënyrë të tillë që mos të kemi vetëm zhvillimin e një aftësie në kurriz të të tjera.

## Përfundime

Për sa parashtruam më sipër, domosdoshmëria dhe njohja e qasjeve dhe metodave në mësimin e gjuhëve, duke nisur që në fazat më të hershme të tyre deri më sot, është e një rëndësie të veçantë për formimin profesional të mësuesit të gjuhëve të huaja. Ato i shërbejnë si burim i pashtershëm informacioni, nga ku ai mund të vjelë atë që është e nevojshme jo vetëm për formimin e tij të përgjithshëm, por dhe atë specifik në lidhje me përdorimin e qasjeve apo metodave të caktuara apo teknikave specifike. Më tej, këto mund t'i aplikojë në realitetin e përditshëm mësimor në bazë të nevojave të nxënësve të tij, të tipologjisë së nxënësit, të nivelit përkatës etj. Ndaj dhe njohja e vetëm një qasjeje apo metode duhet konsideruar si e mangët dhe e pamjaftueshme për t'iu përgjigjur nevojave të mësimdhënies së gjuhëve të huaja.

Duke e mbyllur do të donim të sillnim këtu citimin e një mësuesi i cili thotë:

*“E konsideroj të gabuar formimin e mësuesve të gjuhës së huaj duke i ofruar ata vetëm me një metodë të caktuar. Çdo metodë ka diçka të vlefshme nga e cila çdokush mund të mësojë diçka. Ndaj si rrjedhojë është e nevojshme të njihen, nëse është e mundshme, të gjitha metodat në mënyrë që të merret ajo çka është më e mira nga secila prej tyre”.* (Weber, 1933)<sup>2</sup>

2 Weber, Methodik des Deutschunterrichts, mit Ausländern, Wolfenbüttel, Schulverlag, 1933.

## BIBLIOGRAFÍA

- Balboni P.E., (2002) Le sfide di Babele, Insegnare lingue nelle società complesse, Utet libreria, Torino.
- Borneto, C., S., (1988), C'era una volta il metodo. Tendenze attuali nella didattica delle lingue straniere, Carocci, Roma
- Cecilia R. M, Barsi M., (2006) Metodi in classe per insegnare la lingua straniera. LED Edizioni Universitarie, Milano.
- Galli di Paratesi N., Livello soglia per l'insegnamento dell'italiano come lingua straniera, 1981
- Insegnare italiano a stranieri (2001), a cura di P. Diadòri, Firenze, Le Monnier.
- Krashen, S. (1981), Second Language Acquisition and second Language Learning Oxford, Pergamon.
- Krashen, S. (1981), Second Language Acquisition and second Language Learning Oxford, Pergamon P-55I.
- Lado, R., Contrastive linguistics in a mentalistic theory of language learning', in J.E. Alatis (ed.) Contrastive Linguistics and Its Pedagogical Implications. Report of the Nineteenth Annual Round Table Meeting on Linguistics and Language Studies, Washington D.C.: Georgetown University Press (Monograph Series on Languages and Linguistics; 21), pp. 123-135, 1968.
- M. Danesi, (1988). Manuale di tecniche per la didattica delle lingue moderne., Guerra Edizioni, Perugia.
- M. Danesi, (2005), Il cervello in aula - Neurolinguistica e didattica delle lingue. Guerra Edizioni, Perugia.
- Manuale di glottodidattica (2000), a cura di A. De Marco, Roma, Carocci Editore
- Rodgers C., Languagge Teaching Methodology, "Erik Clearnghouse on Language and Linguistic" Artikull, 2001. [http://www.cal.org/resources/digest\\_rodgers.html](http://www.cal.org/resources/digest_rodgers.html)
- Searle J., (1976), Atti Linguistici.Saggio di filosofia del linguaggio, përkthimi në it., Torino, Boringhieri.
- Sharwood Smith M., Rutherford W. (nën kujdesin e) (1988), Grammar and Second Language Teaching, New York, Newbury House Publisher
- Selinker, L.,(1972), Interlanguage, IRAL; International Review of Applied Linguistics in Language Teaching, 10:3
- Skinner B. F. (1931), The Behavior of Organisms: an Experimental Analysis, New York: Appleton-Century-Crofts.
- Skinner B. F. (1953), Science and human behavior, New York: The MacMillan Co.
- Stern H.H.,(1983) Fundamental coincepts of language teaching, Oxford, Oxford university Press.
- Vignozzi L., (2001) Linee di evoluzione della moderna glottodidattica: teorie di apprendimento, approcci e metodi, in Insegnare italiano a stranieri, a cura di P. Diadòri, Firenze, Le Monnier.
- Weber, Methodik des Deutschunterrichts, mit Ausländern, Wolfenbüttel, Schulverlag, 1933.

# PËRQASJE KULTURORE DYGJUHËSHE PËRMES PËRQASJES GJUHËSORE TË SHPREHJEVE FRAZEOLOGJIKE

**Dr. Alnida Shano Koroshi**

Departamenti i Gjuhës Italiane  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: alnida.shano@unitir.edu.al

**Dr. Kozeta Noti**

Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë  
Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës  
E-mail: kozeta.noti@unitir.edu.al

## PËRMBLEDHJE

Në këtë trajtesë, së pari kemi përcaktuar kriteret mbi të cilat do të bëhet analiza kontrastive e njësive frazeologjike në gjuhën italiane dhe shqipe, të cilat përmbajnë elementin “sy”. Më pas kemi paraqitur një klasifikim, i cili nis nga barasvlefshmëria totale për të mbërritur tek ajo zero, e njësive frazeologjike të marra në analizë në të dy gjuhët. Metoda kërkimore e përdorur është ajo krahasimore. Qëllimi i këtij punimi, nëpërmjet përqasjes së korpusit gjuhësor, është të nxjerrë në dukje pikëtakimet dhe dallimet të cilat pasqyrojnë vlerat kulturore të një populli, përmes gjuhës. Ky punim i vjen në ndihmë të gjithë atyre që studiojnë gjuhën italiane për një përvetësim sa më korrekt të strukturave gjuhësore si dhe të gjithë të apasionuarve të gjuhësës.

Fjalët çelës: barasvlefshmëri, frazeologji kontrastive, gjuha italiane, gjuha shqipe.

## ABSTRACT

In this paper, we have firstly defined the criteria on which the contrast analysis of phraseological units in Italian and Albanian will be performed, which contain the element “eye”. Then we have presented a classification, which starts from the total equivalence to arrive at zero one, of the phraseological units taken into analysis in both languages. The research method used is the comparative one. The purpose of this paper, through the approach of the linguistic corpus, is to highlight the similarities and differences which reflect the cultural values of a people, through language. This paper is addressed to all of them who study the Italian language for a more correct acquisition of language structures as well as those that are interested in linguistics.

Keywords: Albanian, contrastive phraseology, equivalence, Italian.

## Hyrje

Studimet në fushë të frazeologjisë kontrastive, me në fokus gjuhën shqipe, i gjemë që në fillimet e shekullit XX si nga gjuhëtarë të huaj [Raffo: 200] po ashtu edhe nga studiues shqiptarë [Çabej: 174]. Përsa u përket studimeve mbi frazeologjinë kontrastive të gjuhës shqipe dhe asaj italiane, këto të fundit janë shprehur përgjithësisht përmes publikimit të fjalarëve të ndryshëm dygjuhësh [Balla: 2007].

Ky artikull, pjesë e një punimi më të gjerë, synon të evidentojë ngashmërinë dhe natyrisht dallimet që paraqesin dy gjuhë si italishtja dhe shqipja të krahasuara ndërmjet tyre. Këtë krahasim më së miri e përcjell frazeologjia e cila mbart në vetvete vlera mjaft të mëdha kulturore e mendësie të të dy popujve.

## Barasvlefshmëria e njësive frazeologjike

Përgjithësisht të gjitha tendencat përkijnë me tre nivele ekuivalencash ndërgjuhësore [Casadei: 147] ekuivalencë totale, të pjesshme dhe zero. Termi ekuivalencë ka qenë gjithmonë i lidhur me teorinë e përkthimit, por me të është marrë dhe frazeologjia kontrastive [Wotjak: 70], objekti i së cilës është të analizojë analogjitë dhe diferençat e dy sistemeve gjuhësorë të krahasuar, nëpërmjet kritereve që shërbejnë si bazë e krahasimit ndërgjuhësor. Për ta përgjithësuar do të pohonim se kemi dy lloj ekuivalencash, të cilat varen totalisht nga fusha e zbatimit të tyre:

- Ekuivalanca semantike ose funksionale, objekti i frazeologjisë kontrastive që mund ta përkufizojmë si kuptimin e njësive frazeologjike;
- Ekuivalanca komunikative ose tekstore, objekt i përkthimit, në të cilën luajnë një rol mjaft të rëndësishëm aspekte pragmatike si situata komunikative, regjistrat, stilet etj.

Objekt i këtij punimi sipas perspektivës së frazeologjisë kontrastive është ekuivalanca semantike e një njësie frazeologjike në L1 dhe korrespondentes së saj në L2. Aty ku nuk do të jetë e mundur gjetja e një gjegjëse në L2 atëherë do i referohemi ekuivalencës zero.

## Kriteret e krahasimit

Nisur nga prezuposti se në gjuhët e marra në shqyrtim kemi ngashmëri dhe dallime formale dhe semantike, mund të themi se dy njësi frazeologjike kanë të njëjtin kuptim frazeologjik kur kanë të përbashkët këta element [Navarro: 399]

- Kuptimin global të njësisë frazeologjike;

- Strukturën morfosintaksore;
- Zgjedhjen leksikore;
- Imazhin që krijojnë.

Kur flasim për kuptimin global të njësive frazeologjike i referohemi natyrisht kuptimit tërësor të shprehjes dhe jo shumës së kuptimeve që mund të kenë elementët e saj. Këtu bëjmë dhe dallimin e njësive të motivuara dhe atyre të pamotivuara. Të parat përcaktojnë një lidhje ndërmjet kuptimit denotativ dhe atij të fjalë për fjalë p.sh., *accogliere a braccia aperte/të presësh dikë me krahë hapur; annegare in un bicchier d'acqua/të mbytesh me një pikë ujë* kuptimi i këtyre njësive është lehtësish në gjetshëm në sajë të paralelizmave që krijohen ndërmjet rendit sintaksor dhe analizës kuptimore. Në raste të tjera, metafora nuk na e lehtëson kuptimin e shprehjes si p.sh., *alzarsi con il piede sinistro; dormire con un occhio solo; e la me duart në gjit; u bë një dorë*. Këto të fundit janë rezultat i një kombinimi fjalësh ndonjëherë arkaik që në ditët e sotme e kanë humbur lidhjen ndërmjet kuptimit fjalë për fjalë të shprehjes dhe atij idiomatik. I referohemi këtu shprehjeve si *i jap dum*, sipas Gustav Majer-it *dum* vjen nga greqishtja *dhromos*, “*udhë*” pra “*i jap udhë*” [Thomai: 144]. Këto janë njësi frazeologjike të pamotivuara të cilat kanë nevojë për një reflektim *a posteriori* për të kuptuar kuptimin global të shprehjes, pasi kur motivimi është i pakët, idiomaticiteti është gjithmonë i madh.

Nga kriteret e lartpërmendura, interesi ynë është kuptimi frazeologjik si kusht i domosdoshëm për të realizuar krahasimin ndërmjet dy gjuhëve të marra në analizë.

### **Analiza dhe shkallët e barasvlefshmërisë**

Në analizë janë marrë njësitë frazeologjike të të dy gjuhëve të cilat kanë në brendinë e tyre elementin *sy*. Kjo zgjedhje u bë pasi të dy gjuhët paraqesin një sasi të madhe të këtyre shprehjeve, të cilat janë të një përdorimi të përditshëm, në mënyrë që të mund të na lejonin një analizë krahasuese. Korpusi i shprehjeve në gjuhën shqipe është marrë nga Fjalori i Shqipes së Sotme [Toena: 2002] dhe nga Fjalori Frazeologjik i gjuhës shqipe [Thomai: 1999], gjithashtu edhe për gjuhën italiane janë konsultuar Fjalori i gjuhës italiane [Lo Zingarelli: 2012] dhe ai frazeologjik [Quarto: 2001].

Objekt i këtij punimi nuk është mbledhja në tërësi e të gjitha njësive frazeologjike apo renditja e tyre në këtë punim, por vendosja e kritereve mbi të cilat të mundësohet një punim mirëfilli krahasues, punim i paplotë deri më tanë dhe që do të kërkojë në të ardhmen zgjerimin e tij dhe shtrirjen mbi të gjitha njësitë frazeologjike të gjuhëve të marra në analizë.

Njësitë frazeologjike janë analizuar dhe janë grupuar sipas shkallës së ekuivalencës që paraqesin mbështetur edhe në eksperiencia studimore të gjuhëve të tjera [Wotjak: 71].

Në këtë analizë propozojmë 7 nivele korrespondencash, duke nisur nga ekuivalenca totale për të mbërritur tek ajo zero.

**1. Në grupin e parë** kemi përfshirë njësitë frazeologjike të cilat na paraqesin barasvlefshmëri totale në të dy gjuhët. Kjo barasvlefshmëri lidhet së pari me kuptimin, së dyti me imazhin që vetë njësia përcjell, së treti me strukturën morfosintaksore dhe së fundmi me zgjedhjen leksikore të fjalëve në brendi të saj.

<b>Avere davanti agli occhi</b> – avere a portata di mano un oggetto che si stava cercando, la soluzione di un problema, o la prova evidente di qualcosa. Può essere riferito sia a qualcosa di concreto che a qualcosa di astratto.	<b>E kam para syve</b> – (diçka) që po kërkoj e kam në dorë apo shumë pranë por nuk më sheh syri.
<b>Chiudere gli occhi</b> – morire; non voler vedere una realtà in genere spiacevole, convincersi che le cose stiano in un certo modo, credere quello che fa piacere; anche tollerare una mancanza, ignorarla, fingendo di non aver visto niente poiché in quel momento si tenevano gli occhi chiusi.	<b>Mbylli sytë</b> (dikush) – nuk vuri re asgjë ose bëri sikur nuk shikonte; nuk mori parasysh asnjë vështirësi a rrezik, u hodh në rrezik pa vënë re asgjë; vdiq, mbaroi.
<b>Non credere ai propri occhi</b> – stentare a credere quanto si vede nonostante la prova della sua realtà fornita dalla vista. Si dice di qualcosa d'impensato, d'insperato, che comunque suscita meraviglia, stupore.	<b>S'u beson as syve të vet (dikush)</b> – kérkon t'i vërtetojë e t'i saktësojë mirë gjërat, éshtë shumë i kujdesshëm e nuk beson asgjë pa e vërtetuar mirë; éshtë mosbesues.

Tabela 1. Njësi frazeologjike të njëjta

*Avere davanti agli occhi/e kam para syve* janë dy shprehje të tjera të njëjta të cilat hapin grupin e shprehjeve me elementin *sy*. I referohen situatës kur jemi duke kërkuar diçka konkrete por nuk arrijmë ta gjejmë megjithëse e kemi para syve. Kjo mund të jetë si rezultat se jemi shumë të lodhur apo jemi të hutuar për shkak të një problemi që kemi dhe mendimet apo shqetësimet tonë nuk na lënë të shohim atë që éshtë mjaft e dukshme e që ndodhet pikërisht para syve tanë. Mund t'i referohen një objekti konkret apo një ideje abstrakte. *Chiudere gli occhi* në gjuhën italiane si kuptim të parë mbart konceptin e vdekjes, pra të mbyllësh përgjithnjë sytë e të ndahesh ngajeta, ndërsa si kuptim të dytë, do të thotë të mbyllësh qëllimi sytë para diçkaje pasi nuk do të bëhesh pjesë e saj apo nuk do të pranosh një të vërtetë të hidhur e kësisoj sytë mbahen mbyllur pikërisht për të penguar pamjen. Në gjuhën shqipe me shprehjen *mbylli sytë* kemi një përbysje të rendit të kuptimeve, të mbyllësh qëllimi sytë para një rreziku të madh e të hidhesh në veprim pa llogaritur rreziqet éshtë kuptimi i parë i shprehjes e të ndahesh ngajeta éshtë kuptimi i dytë. *Non credere ai propri occhi/s'u beson as syve të vet*, sërisht dy shprehje të tjera të njëjta të cilat mbartin imazhin e dikujt që përparrë një fakti real megjithëse sheh provat e asaj që ka

ndodhur nuk mund ta besojë që është e vërtetë pasi ajo që pritej të ndodhë me gjithëse shumë e dëshiruar dukej se ishte e pamundur. Shpesh i referohet dikujt që është shumë mosbesues edhe atëherë kur nuk është e nevojshme duke e ironizuar kështu situatën apo duke e bërë atë qesharake.

**2. Në grupin e dytë** barasvlefshmëria e njësive frazeologjike nuk është më totale por e pjesshme. Këtu kemi grupuar ato shprehje me të njëjtin kuptim, pra kuptimi denotativ i njësive sërisht shërben si kriter kryesor për seleksionimin e tyre. Imazhi që ato përfaqësojnë sërisht është i njëjtë, po ashtu dhe zgjedhjet leksikore. Elementi dallues i këtij grupe është pikërisht ndryshimi në strukturën morfosintaksore. Këto ndryshime janë grupuar si më poshtë:

<b>Covare con gli occhi</b> – guardare continuamente, amorosamente qualcuno o qualcosa, come a volerne controllare la sicurezza, il benessere e simili.	<b>E përpju me sy</b> (dikë a diçka) – ia nguli fort vështrimin e s’ia ndante, e shikoi me lakmi e me dëshirë të papërmabjatur.
<b>Perdere d’occhio</b> – non riuscire a vedere più qualcosa o qualcuno; anche non prestarle la dovuta attenzione, riferito per lo più all’argomento principale di un discorso, a un aspetto di una situazione o simili.	<b>Më iku nga sytë</b> – (dikush) u largua pa u vënë re, iku tinëz, nuk e shoh më; (diçka) më shpëtoi pa e vënë re një gabim, një të metë etj., më rrëshqiti.
<b>Uscire dagli occhi</b> – provocare saturazione, stancare, riferito a cose o persone che sono venute a noia per eccesso di quantità o di presenza, come se il tedium interiore fosse cresciuto a dismisura e ormai traboccasse anche dagli occhi.	<b>Më mbiu në sy</b> (dikush a diçka) – më del përpara aq shpesh sa më mërziti, nuk e shoh dot më.

Tabela 2. Ndryshim në numrin e elementit kyç të shprehjes, pra të gjymtyrës trupore

*Covare con gli occhi/e përpju me sy* do të thotë të shohësh dikë me shumë kënaqësi, me endje, me dëshirë të zjarrit për t’i qëndruar pranë e për ta pasur. Shohim se në njësinë në gjuhën italiane elementi kryesor (occhi) është shprehur në numrin njëjës në të shquar, ndërsa në shqip elementi kyç i shprehjes (sy) është në trajtë e pashquar në numrin njëjës.

Kur dikush të ikën nga rrëzja e shikimit, kur mjafton një çast i vetëm hutimi për të mos e pasur më para syve apo ku një detaj na ka kaluar pa u vënë re mirë përdorim njësitë e mëposhtme: *perdere d’occhio* dhe *më humbi nga sytë*. Në njësinë në gjuhën shqipe elementi kyç i shprehjes është në numrin shumës në trajtë e shquar, ndërsa në gjuhën italiane është shprehur në numrin njëjës në të pashquar.

*Uscire dagli occhi/më mbiu në sy* përdoret kur dikush apo diçka prej një kohe të gjatë

ka qenë i pranishëm në përditshmërinë tonë dhe kësisoj është bërë i mërzitshëm dhe i bezdisshëm për pamjen, aq sa duket sikur pamja e dikujt apo e diçkaje na është fiksuar në sy e sikur del prej tyre. Në gjuhën italiane elementi *occhi* është në numrin shumës ndërsa në gjuhën shqipe në numrin njëjës.

Në rastet kur bëjmë një analizë të një ngjarje, apo të një personi nën një këndvështrim krejt tjetër nga sa e kemi konceptuar apo hasur më parë dhe kur kësisoj zbulojmë aspekte të panjohura më parë (kryesisht pozitive), atëherë përdorim këto dy njësi: *veder qualcosa/ qualcuno con occhi diversi* dhe *e shoh me një sy tjetër*. Njësia në gjuhën italiane është e shprehur në numrin shumës ndërsa njësia në shqip në numrin njëjës në trajtën e pashquar.

<b>Perdere il lume degli occhi</b> – perdere la capacità di ragionare per ira e sim.	<b>M'u mjegulluan /errën /errësuan /veshën /verbuan/qorruan sytë</b> – humba qartësinë e shikimit e të kuptimit të gjérave; u inatosa dhe s'vija re më se çfarë bëja.
<b>Tenere gli occhi addosso</b> – sorvegliare attentamente qualcuno e il suo operato, senza mai distrarsi, quasi sempre per cercare di coglierlo in fallo.	<b>Ia nguli/ngjiti/qepi sytë</b> (dikujt a diçkaje) – e shikoi me vëmendje e për një kohë të gjatë; e shikoi me ngulm, nuk ia ndau shikimin.

Tabela 3. Më shumë se një variant foljor në gjuhën shqipe

Të humbasësh aftësinë e arsyetimit nga zemërimi apo inati jepet me shprehjen në gjuhën italiane *perdere il lume degli occhi* dhe në gjuhën shqipe vjen sërisht me më shumë se dy variante follore *m'u mjegulluan /errën /errësuan /veshën /verbuan/qorruan sytë*. Sytë në këtë rast kanë privilegjin e të parit si shqisë mjaft e rëndësishme në gjykimin apo arsyetimin e botës përreth.

Kuptim të njëjtë me shprehjen që lartpërmendëm *non levare gli occhi di dosso*, pra të mos ia ndash sytë dikujt, por tanimë në formën pohore kemi *tenere gli occhi addosso* dhe *ia nguli/ngjiti/qepi sytë*. Qëllimi i këtij shikimi kaq këmbëngulës është pikërisht përpjekja për të kapur dikë në gabim, sikur në atë çast që sytë nuk do ta shohin personin që jemi duke vëzhguar pikërisht atëherë ai do të bëjë një lëvizje të gabuar. Është mjaft interesante që i njëjti kuptim jepet në të dy gjuhët me shprehje në formën mohore sikurse edhe pohore, por mbi të gjitha duhet theksuar se nuk kemi përsëritje të foljeve tek asnjerë nga njësitet frazeologjike, me gjithë variantet e shumta që janë përdorur në gjuhën shqipe. Për formën mohore kemi: (nuk) *shkëpus, heq, shqis, ndaj sytë* dhe për formën pohore: *ngulis, ngjis, qep sytë*. Provë kjo e pakundërshtueshme e pasurisë së gjuhëve dhe e gjuhës shqipe në veçanti.

<b>Alzare/mettere/levare gli occhi su</b> – aspirare a un rapporto soprattutto matrimoniale con una persona di classe sociale o economica superiore; aspirare al possesso di una determinata cosa, posizione o simili; in genere, implica l'inadeguatezza del soggetto a quel dato bene, carica, situazione o simili, e a volte il suo intento ad arrivarcì con qualsiasi mezzo.	<b>Ia vuri/shtiu syrin</b> – (dikujt) e zgjodhi midis të tjerëve përtak përtak ngarkuar një punë, përtak caktuar në një vend; përtak fejuar a përtak martuar me të etj.; (diçkaje) e lakmon ta shtjerë në dorë, vendosi të përpinqet përtak pasur.
<b>Guardare/vedere di buon occhio</b> – avere simpatia, benevolenza o stima per una persona, vederla volentieri; di una situazione, un'iniziativa e simili, esserne convinti, approvarla, appoggiarla.	<b>E sheh/e ka me sy të mirë</b> (dikë) – e shikon me dashamirësi e me simpati, ka mendim të mirë përdikë; e përkrah duke u nisur nga mendimi i mirë që ka përtak.

Tabela 4. Më shumë se një variant foljur në të dy gjuhët

*Alzare/mettere/levare gli occhi su* ..., sërisht njësia në gjuhën italiane na paraqet tri variante follore ndërsa shprehja në gjuhën shqipe vetëm dy të tilla, *ia vuri/shtiu syrin*. Tjetër dallim që bie menjëherë në sy eshtë ndryshimi i numrit të elementit kyç të shprehjes, në gjuhën italiane eshtë dhënë në numrin shumës *gli occhi* (sytë), ndërsa në gjuhën shqipe eshtë në numrin njëjës, *syri*. Në gjuhën italiane të ngresh sytë drejt dikujt krijon imazhin e një njeriu që ndodhet apo qëndron më poshtë se personi apo objekti drejt të cilët ka ngritur sytë e nënkupton idenë se ky i fundit qëndron në një pozitë më të lartë. Pra ai që i ka vënë *syri* dikujt sidomos me qëllim përtu martuar apo diçkaje përtak arritur apo të ra pasur, do të thotë që nuk eshtë mjaft i përshtatshëm përtak këtë synim që i ka vendosur vetes, megjithatë nënkupton edhe arritjen e qëllimit me çfarëdolloj mjeti. Në shqip, t'ia vësh apo t'ia shtiesh *syri* dikujt do të thotë të lakmosh të kesh dikë me qëllim fejese apo martese, apo diçka përtak pasur, përtak shtënë në dorë me çdo kusht. Gjithashtu nënkupton edhe t'ia vësh *syri* dikujt në mes të një grupi, përtak ngarkuar me një detyrë apo përtak caktuar në një vend tjetër.

*Guardare/vedere di buon ochio*, këtu kemi përdorimin e dy foljeve sinonimike të njëratjetërs, të shohësh me sy të mirë përdikë. Në gjuhën shqipe kemi barasvlerësen *e sheh/e ka me sy të mirë*. Tek të dy gjuhët kemi të njëjtin kuptim, të shohësh dikë me dashamirësi, me simpati, të kesh mendim të mirë përdikë dhe si pasojë ta përkrahësh nëse eshtë e nevojshme në një situatë të caktuar.

**3. Në grupin e tretë** do të gjejmë njësitë frazeologjike të cilat paraqesin kuptim të njëjtë, struktura morfosintaksore nuk përmban ndryshime thelbësore, zgjedhja leksikore është identike, gjithashtu është dhe imazhi që reflektojnë. Deri këtu duket sikur po rimarrim tiparet e grupit të parë ku ekuivalenca ishte totale. Në fakt, tipari thelbësor i këtij grupi është sinonimia. Paraqet sinonimi gjuha italiane, ajo shqipe ose të dyja së bashku. Sinonimia e shprehur në këtë grup lidhet sërisht me elementët që shprehin organe, gjymtyrë apo pjesë të tjera trupore. Edhe ky grup do të jetë i ndarë në tre nëngrupe sipas sinonimisë së shprehur.

<b>Avere gli occhi che si chiudono</b> – avere molto sonno, essere sul punto di addormentarsi. <i>Avere le palpebre che si chiudono.</i>	<b>Më mbyllen sytë</b> – më flihet shumë; jam shumë i lodhur, jam i këputur; sa s'më bie të fikët nga kënaqësia.
<b>Avere gli occhi pesanti</b> - avere sonno, avvertire lo stimolo a chiudere gli occhi per la pesantezza delle palpebre. <i>Sentirsi gli occhi pesanti; sentire le palpebre pesanti.</i>	<b>M'u zvogëluan sytë</b> – më vjen për të fjetur, s'duroj më dot pa gjumë; nuk i shoh më punët aq qartë, nuk i kuptoj më aq shpejt e aq mirë.

Tabela 5. Gjuha italiane paraqet sinonimi

*Avere gli occhi che si chiudono* do të thotë të të mbyllen sytë për gjumë, të jesh gati duke të tē zënë gjumi, ndërsa në gjuhën shqipe gjegjësja e kësaj njësie, *më mbyllen sytë*, përvèç këtij kuptimi, pra të jesh gati duke fjetur, mbart edhe një kuptim tjetër. Në fakt akti i mbylljes së syve mund të jetë për shkak të lodhjes së madhe e pra të gjumit që vjen si pasojë, por i referohet edhe rasteve kur jemi duke provuar një kënaqësi të madhe dhe kjo na çon në mbylljen e syve. Pra siç e shohim kemi një kuptim të dytë në gjuhën shqipe të cilin gjuha italiane nuk e shpreh, por duke qenë se gjuha italiane na paraqet shprehje sinonimike për këtë njësi, *avere le palpebre che si chiudono* (të të mbyllen qepallat e syrit), na u duk më e drejtë ta gruponim këtë njësi frazeologjike në këtë nëngrup.

*Avere gli occhi pesanti/m'u zvogëluan sytë*, këto dy shprehje nuk paraqesin të njëjtën zgjedhje leksikore, megjithëse kanë kuptim të njëjtë. Le t'i analizojmë ato. Në gjuhën italiane *avere gli occhi pesanti*, t'i kesh apo t'i ndjesh sytë e rënduar do të thotë të jesh aq i lodhur saqë edhe sytë apo më saktë qepallat e syrit të të rëndojnë, pra të jesh aq i sfilitur saqë të mos mbash dot as qepallat e syrit lart. Në këtë kuptim ky veprim çon në zvogëlimin e syrit, pasi dikush që është shumë i lodhur e nuk ka fuqi të mbajë sytë hapur do të thotë që zvogëlon hapjen e qepallave duke bërë që syri të hapet më pak e si pasojë të duket më i vogël. Nga ky arsyetim del përdorimi i njësisë frazeologjike në gjuhën shqipe me foljen zvogëloj, *m'u zvogëluan sytë*, një gjetje mjaft e spikatur. Gjuha italiane paraqet edhe dy njësi të tjera me të njëjtin kuptim, *sentirsi gli occhi pesanti* (të ndjesh sytë e rënduar) dhe *sentire le palpebre pesanti* (të ndiesh qepallat e rënduara).

<b>Aver la benda agli occhi</b> – essere offuscato da passione e sim.	<b>I kanë vënë sytë ag</b> (dikujt) – i kanë vënë perde sytë; nuk i sheh qartë punët, nuk i kupton drejt gjërat; është verbuar; <i>I janë veshur sytë; iu mjegulluan sytë.</i>
<b>Avere le lacrime agli occhi</b> – essere sul punto di piangere.	<b>Iu njomën sytë (dikujt)</b> – iu mbushën sytë me lot. <i>I lagu sytë (dikush).</i>

Tabela 6. Gjuha shqipe paraqet sinonimi

Kur dikush nuk i sheh gjërat qartë ashtu siç janë apo nuk arrin t'i kuptojë drejt gjërat, pasi i janë mjegulluar sytë apo i janë veshur ato, atëherë gjejnë përdorim njësitë frazeologjike: *avere la benda agli occhi/i kanë zënë sytë ag*. Të tjera shprehje në gjuhën shqipe janë: *i janë veshur sytë; iu mjegulluan sytë*.

Çasti para fillimit të lotimit, pra kur jemi gati duke qarë pasqyrohet mjaft mirë nga dy njësitë *aver le lacrime agli occhi/iu njomën sytë (dikujt)*. Gjuha shqipe na paraqet një tjetër njësi sinonimike me të parën, *i lagu sytë (dikush)*.

<b>Aguzzare gli occhi</b> – cercare di vedere qualcosa di lontano o indistinto, guardando attentamente. È normale in questi casi socchiudere le palpebre per ridurre l'ampiezza del campo visivo a favore della sua profondità, come se gli occhi diventassero in tal modo più “aguzzi”, più penetranti. <i>Aguzzare la vista; aguzzare le ciglia.</i>	<b>Mpreh sytë</b> – përpinqem të shoh edhe më mirë, përqëndrohem shumë që të shoh diçka; kam kujdes të mos më ndodhë gjë. <i>Hap sytë; mpreh shikimin.</i>
<b>Avere gli occhi foderati di prosciutto</b> – non vedere le cose più evidenti. <i>Avere le fette di prosciutto sugli occhi; avere le fette di salame sugli occhi.</i>	<b>I kanë vënë (i kanë zënë) sytë cergë</b> (dikujt) - nuk e sheh qartë gjendjen rrëth e rrötull, është verbuar e nuk i kupton gjërat siç janë. <i>I janë veshur sytë; i kanë vënë (i kanë zënë) sytë perde; i kanë zënë sytë lesh.</i>

Tabela 7. Të dy gjuhët paraqesin sinonimi

Në këtë nëngrup janë seleksionuar njësitë frazeologjike të cilat paraqesin sinonimi në të dy gjuhët. Siç vërejmë dhe nga tabelat të dy gjuhët paraqesin shumë shprehje sinonimike. *Aguzzare gli occhi/mpreh sytë*, i referohet një situate ku dikush që kërkon të shohë një send apo një njeri që ndodhet paksa larg, mbyll paksa qepallat e syve në mënyrë

që të zvogëlojë fushën e shikimit me qëllim që ta bëjë atë sa më të thellë, pra të përpinqet të shohë sa më larg. Njësi të tjera me të njëjtin kuptim: *aguzzare la vista/mpreh shikimin* dhe *aguzzare le ciglia* (mpreh qerpikët) dhe *hap sytë*.

*Avere gli occhi foderati di prosciutto/i kanë vënë (zënë) sytë cergë*, i referohet dikujt i cili nuk arrin të shohë gjérat ashtu siç janë, edhe ato më të qarta, pasi i ka sytë e zëna. Në gjuhën italiane sytë janë të zënë nga fetat e proshutës ndërsa në gjuhën shqipe sytë kanë zënë cipë apo perde, megjithatë kuptimi i shprehur është i njëjtë, duke qenë se përrpara syve ka diçka që e pengon shikimin, kësisoj ky i fundit nuk mund të jetë i qartë. Të tjera variente në gjuhën italiane janë: *avere le fette di prosciutto sugli occhi* (të kesh fetat e proshutës mbi sy); *avere le fette di salame sugli occhi* (të kesh fetat e sallamat mbi sy) ndërsa në gjuhën shqipe kemi shprehjet: *i janë veshur sytë; i kanë vënë (i kanë zënë) sytë perde; i kanë zënë sytë lesh.*

**4. Në grupin e katërt** vijojmë sërisht me shprehjet frazeologjike me kuptim të pjesshëm. Këtu kemi seleksionuar ato njësi frazeologjike të cilat kanë strukturë morfosintaksore të njëjtë ose të ngjashme, zgjedhje leksikore të njëjtë, imazhi që përfaqësojnë është i njëjtë ose i ngjashëm, por kuptimi i tyre nuk është i njëjtë. E thënë ndryshe, njëra nga të dy gjuhët shfaq një kuptim më tepër, të dytë apo të tretë, që gjuha tjetër nuk e ka. Edhe këtu do të kemi ndarje në nëngrupe duke u bazuar tek kuptimi:

<b>Aprire gli occhi</b> – rendersi conto di una verità generalmente spiacevole che non si era immaginata prima, e in particolare di avere sbagliato la valutazione di qualcosa, in genere riferito a persone false o fraudolente; vale anche per le situazioni che si scoprono più rischiose di quanto si pensava.	<b>Hap sytë</b> – çuditem nga diçka e papritur, befasohem; kam kujdes të mos më ndodhë gjë, jam syçelë; arsimohem, marr dije e njohuri.
<b>Aprire gli occhi a qualcuno</b> – rivelare a qualcuno una realtà che non conceva, in genere spiacevole; in particolare, indurre una persona a rendersi conto della possibilità di un inganno, della pericolosità di una situazione, delle vere intenzioni di qualcuno e così via.	<b>I hap sytë dikujt</b> – i jap dije a kulturë, i zgjeroj horizontin, e zhvilloj; e bëj t'i shohë gjérat ashtu siç janë në të vërtetë, i zbuloj të vërtetën, e bëj të kuptojë si qëndron puna.

Tabela 8. Gjuha italiane paraqet kuptim të pjesshëm në krahasim me gjuhën shqipe

Në këtë nëngrup kaq interesant do të analizojmë njësitë frazeologjike në imtësinë e kuptimeve të shumta që ato mbartin duke kuptuar më mirë vlerat e secilit komb të shprehura përmes gjuhës. *Aprire gli occhi apo hap sytë* i referohen dikujt i cili zbulon se mendimet apo ajo çka ka besuar deri më tanë lidhur me një çështje apo me një njeri tjetër ka qenë e gabuar dhe e pavërtetë. Mund t'i referohet edhe një situate të rezikshme

në të cilën duhet bërë mjaf kujdes kështu që duhen hapur mirë sytë në mënyrë që të minimizohet apo parandalohet rreziku. Kuptimi i tretë që në këtë rast vetëm gjuha shqipe e mbartështë të arsimohesh, të shkollohesh. Pra njësia në gjuhën shqipe, hap sytë, mund t'i referohet edhe dikujt që rishtazi ka filluar të shkollohet, të marrë dije e kulturë. Ky kuptim nuk është i shprehur nga njësia frazeologjike në gjuhën italiane.

E njëjtë shprehje por tanimë kur i referohet dikujt tjetër, mbart të njëjtat kuptime. *Aprire gli occhi a qualcuno/i hap sytë dikujt*, në këtë rast jemi ne ata që përpinqemi të bëjmë dikë të kuptojë se si janë gjërat në të vërtetë, duke i shpjeguar dhe treguar qëllimet e vërteta të dikujt që hiqet si njeri i mirë por që në të vërtetë nuk është, apo përfundimisht se si një situatë nuk është ashtu siç ai e mendon. Edhe këtu gjuha shqipe mbart një kuptim më shumë, atëherë kur përpinqemi t'i hapim sytë dikujt duke i dhënë dije e kulturë, duke i zgjeruar horizontin e duke e zhvilluar më tej atë.

<b>Avere un'occhio alla padella e uno al gatto</b> – badare contemporaneamente a due cose, persone o situazioni che richiedono uguale sorveglianza o che potrebbero entrare in conflitto tra loro.	<b>I bëri sytë katër</b> – shikonte me kujdes të madh që të mos i shpëtonte asgjë, rrinte syhapët.
<b>Parlare con gli occhi</b> – avere gli occhi molto espressivi, capaci di trasmettere sensazioni, emozioni, e in generale quello che si pensa. Anche comunicare qualcosa ad un'altra persona con l'espressione degli occhi, senza che gli altri altri se ne accorgano. Oppure, non riuscire a nascondere quello che si pensa.	<b>Flet me sy e me vetulla</b> – kur flet i lëviz shumë sytë e vetullat; bashkë me fjalët përdor edhe lëvizjet e syve e të fytyrës përfundimisht shprehur mendimet e ndjenjat e veta.

Tabela 9. Gjuha shqipe shfaq kuptim të pjesshëm në lidhje me gjuhën italiane

Në këtë nëngrup kemi seleksionuar shprehjet frazeologjike të cilat në gjuhën italiane shfaqin një apo disa kuptime më shumë se gjuha shqipe. *Avere un'occhio alla padella e uno al gatto/i bëri sytë katër*, po të shohim strukturën e shprehjeve do të kuptojmë se nuk është e njëjtë, por duke qenë se kuptimi i shprehur nga njësia në gjuhën italiane mbart disa elementë që gjuha shqipe nuk i ka, e menduan me vend ta vendosnim këtu këtë njësi frazeologjike. T'i bësh sytë katër do të thotë të jesh shumë i kujdeshëm në mënyrë që të mos shpëtojë asgjë. Të dyfishosh numrin e syve bëhet me qëllimin e vetëm që të mund të shohësh më mirë e kësosoj të jesh më i vëmendshëm. Ndërsa në gjuhën italiane t'i hedhësh një sy tiganit dhe një tjetër maces do të thotë jo vetëm të jesh shumë i vëmendshëm përfundimisht që ndodh rrëth e rrotull, por mbi të gjitha të kesh shumë kujdes pasi palët mund të futen në konflikt njëri me tjetrin.

*Parlare con gli occhi* do të thotë të kesh sy që janë në gjendje të shprehin ndjenja apo të arrijnë të komunikojnë edhe pa qenë nevoja të përdoren fjalët. Në gjuhën shqipe, gjegjësja është relativisht e ndryshme në strukturë, *flet me sy e vetulla*, që i referohet dikujt i cili kur flet është mjaft ekspresiv dhe së bashku me fjalët përdor edhe sytë e vetullat pér të shprehur ndjenjat apo emocionet. Kur sytë flasin apo qeshin është pak e vështirë që vetullat të rrinë pa lëvizur, ndoshta pér këtë arsyе është zgjedhur edhe përdorimi i elementit vetull krahas syve. Kuptimi tjetër që mbart shprehja në gjuhën italiane është se dikush që ka sy që flasin vetë, i përdor këto të fundit pér t'i komunikuar dikujt diçka në prani të njerëzve të tjerë pa qenë e nevojshme që këta të fundit ta marrin vesh. Apo situata e kundërt, kur dikujt i flasin sytë është vështirë që të mund të arrijë të fshehë ndjenjat e tij të vërteta para njerëzve të tjerë.

**5. Në grupin e pestë** kemi seleksionuar njësitë frazeologjike me kuptim të njëjtë, imazh të njëjtë ose të ngashëm, por me strukturë morfosintaksore dhe zgjedhje leksikore të ndryshme. Elementi që e dallon këtë grup përveç kuptimit është imazhi që njësitë frazeologjike pasqyrojnë:

<b>Aprire gli occhi ai ciechi</b> - indurre qualcuno a rendersi conto di qualcosa, in genere spiacevole. Anche insegnare, spiegare, far capire qualcosa d'importante.	<b>I hap sytë dikujt</b> – i jap dije a kulturë, i zgjeroj horizontin, e zhvilloj; e bëj t'i shohë gjërat ashtu siç janë në të vërtetë, i zbuloj të vërtetën, e bëj të kuptojë si qëndron puna.
<b>Avere ancora negli occhi</b> – avere un vivo ricordo di qualcosa, come se lo si avesse ancora davanti agli occhi o vi fosse rimasto dentro.	<b>Më del para syve</b> (dikush a diçka) – e përfytyroj qartë, sikur e shoh tani; më kujtohet mirë.

Tabela 10. Ndryshime në imazhin e pasqyruar

*Aprire gli occhi ai ciechi/i hap sytë dikujt*, këtu kemi të bëjmë me dy kuptime të mbartura nga njësitë frazeologjike të njëjta pér të dy gjuhët. Së pari këto shprehje i referohen një situate ku dikujt i flasim me sinqeritet dhe e bëjmë të kuptojë si janë gjërat në të vërtetë, zakonisht përdoret pér t'i treguar dikujt diçka të pakëndshme. Kuptimi tjetër i shprehur i referohet rastit kur dikujt i japim dije a kulturë apo i mësojmë diçka të rëndësishme, e bëjmë ta kuptojë atë.

Kur dikë apo diçka nuk e kemi më pranë, por kujtimi i tij është kaq i gjallë saqë duket sikur në të vërtetë na gjendet përballë, para syve, përdoren shprehjet *avere ancora negli occhi/më del para syve* (*dikush a diçka*). Imazhi i përfytyruar nga gjuha italiane është ta kesh kujtimin brenda në sy, pasi aq i gjallë është ky i fundit saqë duket sikur ka ngelur brenda syve e nuk ka dalë më prej tyre.

**6. Në grupin e gjashtë** kemi njësitë frazeologjike të cilat paraqesin vetëm një element të përbashkët, kuptimin që vijon të jetë i njëjtë. Ndërsa tre elementët e tjera: imazhi, struktura morfosintaksore dhe zgjedhja leksikore, tek të cilët jemi bazuar për të mundësuar analizën tonë, janë të ndryshme.

<b>Anche l'occhio vuole la sua parte</b> – si dice quando si desidera che qualcosa, oltre a essere utile, possa appagare anche il senso estetico.	<b>E ha syri</b> (diçka) – e pëlqen nga pamja e jashtme, e pranon.
<b>Costare un occhio</b> – riferito a concetti come spendere, valere, pagare e simili, indica una somma di denaro molto elevata. <i>Costare un occhio della testa.</i>	<b>(Kushton) sa qimet e kokës</b> – jep një çmim jashtëzakonisht shumë të lartë; e mban shumë shtrenjtë diçka.

Tabela 11. Ekuivalencë vetëm në kuptim

*Anche l'occhio vuole la sua parte*, do të thotë se diçka përvçe se duhet të jetë e dobishme është mirë që të plotësojë edhe kriterin estetik, pra të jetë e kënaqshme për syrin, pikërisht nga ky arsyetim lind shprehja *edhe syri do pjesën e tij*. Në shqip gjegjësen e kemi *e ha syri*, pra kur syri e pranon diçka si të pëlqyeshme, njësoj si goja që e ha diçka pasi e pëlqen.

*Costare un occhio* i referohet një situate ku për të pasur diçka duhet të paguajmë një shumë të konsiderueshme, mjaft të kripur aq sa mund të themi se diçka ka vlerë të paçmueshme, pra kushton shumë aq sa mund të kushtojë një sy. Po kështu në shqip gjegjësja kushton sa qimet e kokës jep të njëjtin kuptim. Është mjaft interesante të kuptojmë këtu veçantitë e dy gjuhëve, nëse për italianët një çmim jashtëzakonisht shumë i lartë barasvlerësohet me çmimin e një syri, në gjuhën shqipe kjo vlerësohet me çmimin e qimeve të kokës. Një tjetër variant i kësaj shprehje në gjuhën italiane është *costare un occhio della testa*.

**7. Në grupin e shtatë** dhe të fundit mbërrimë tek ekuivalanca zero e shprehjeve në të dy gjuhët. Këtu kemi seleksionuar ato njësi frazeologjike të cilat na paraqiten me strukturë morfosintaksore të njëjtë, zgjedhje leksikore të njëjtë, imazhin e pasqyruar të njëjtë, por me kuptim të ndryshëm, herë-herë të kundërt. Pra, kuptimi, kriteri kryesor tek i cili jemi bazuar për të bërë analizën përqasëse këtu na del i ndryshëm dhe është pikërisht ky i fundit që përbën në këtë grup veçorinë dalluese:

<b>Avere gli occhi fuori dalle orbite</b> – essere furibondi, infuriati, con un'espressione talmente distorta dall'ira da far pensare a una fuoriuscita degli occhi dalla sua sede. <i>Avere gli occhi fuori dalla testa.</i>	<b>I dolën sytë nga vendi</b> (dikujt) – u zgurdullua fort nga tmerri; po heq një mundim të madh; ka shumë zor a u çudit shumë. <i>I dolën sytë jashtë; i dolën sytë dokërr; iu çapëlyen sytë.</i>
<b>Fare gli occhi alle pulci</b> – essere molto abili in ogni tipo di attività e lavoro, specie per quanto riguarda lavori minuziosi, di precisione o pazienza. Per estensione, anche essere eccessivamente pignoli.	<b>I kërkon pleshtit syrin</b> – dikush kërkon të dijë gjëra të hollësishme e të panevojshme, hyn në çikërrima.

Tabela 12. Ekuivalenza zero

*Avere gli occhi fuori dalle orbite/i dolën sytë nga vendi (dikujt)*, këtu kemi të bëjmë me strukturë të njëjtë, por me kuptim të ndryshëm. Në gjuhën italiane të të dalin sytë nga vendi ndodh për shkak të zemërimit që ndien dikush, e pikërisht nga ky zemërim njeriu shpërfytyrohet aq sa duket sikur sytë nuk i ka më në vendin e tyre. Për gjuhën shqipe, shkaku i daljes së syve nga vendi i tyre verifikohet atëherë kur dikush tmerrohet aq shumë sa i zgurdullohen sytë.

*Fare gli occhi alle pulci*, t'i bësh pleshtit sytë, do të thotë të jesh shumë i përpiktë në çdo punë që kryen sidomos në ato punë që kérkojnë saktësi shumë të madhe, edhe të jesh pedant, të merresh me vogëlsira e hollësira. Ndërsa në gjuhën shqipe *i kërkon pleshtit syrin*, do të thotë të jesh i bezdisur e të kerkosh të dish vogëlsira e çikërrima, të merresh me gjëra të hollësishme e të panevojshme të cilat kryhen nga të tjerët. Pra nëse në gjuhën italiane është vetë njeriu që i zbaton gjérat me përpikëri nga ana formale, në gjuhën shqipe është ai që interesohet për punën e të tjerëve në detaje.

## Përfundime

Qëllimi i këtij punimi mbetet, së pari, përcaktimi i kritereve që mundësojnë krahasimin e njësive frazeologjike në të dy gjuhët, italiane dhe shqipe dhe nxjerrjen në paq të tipareve themelore të njësive frazeologjike, të tillë si qëndrueshmëria, leksikalizimi, idiomaticiteti. Këto tipare të analizuara dhe të qartësuara përmes punimit dëshmojnë afërsinë kulturore dhe të *formamentis* të të dy popujve që ndajnë ndjesi, mendime dhe reagime shpeshherë të njëjta dhe shpeshherë me ndryshime të vogla hera herës thelbësore.

Për të krahasuar dy sistemet frazeologjike u bazuam në 4 kriterë: kuptimi, struktura, imazhi dhe zgjedhja leksikore. Arritëm të ndërtojmë 7 nivele krahasimi, bazuar tek

kriteret e lartpërmendur, duke nisur nga grupi i parë, tek i cili ishin klasifikuar njësitë me ekuivalencë totale, për të vijuar me njësitë frazeologjike me ekuivalencë të pjesshme nga grupi i dytë deri tek ai i pestë, për të përfunduar me njësitë me ekuivalencë zero tek grupi i shtatë. Ky punim evidentoi se njësitë frazeologjike me ekuivalencë të pjesshme janë më të shumta në numër, duke përcjellë ndryshime në strukturën morfosintaksore, në zgjedhjen leksikore, në imazhin e pasqyruar dhe së fundmi pjesërisht në kuptimin që këto të fundit mbartin.

Në përfundim të analizës tonë duam të theksojmë se mbi të gjitha janë pikërisht faktorët ekstragjuhësorë, pra ata sociokulturorë, përcaktues të drejtpërdrejtë në një shkallë shumë të lartë të të gjithë procesit të idiomaticitetit, aspekt ky mjaft i rëndësishëm në krahasimin e sistemeve gjuhësore frazeologjike në përgjithësi dhe atij të marrë në shqyrtim nga kjo trajtesë në veçanti. Prania e këtyre të fundit përligj dallimet në mendësi, traditë e kulturë. Megjithë shkallën e ndryshme të zhvillimit ekonomiko-kulturor, megjithë përkatësinë e ndryshme në familjet e gjuhëve duhet pranuar se janë të shumtë elementët që i lidhin dhe i bashkojnë këto dy gjuhë, dëshmuar kjo edhe përmes studimit të këtyre njësive frazeologjike.

## BIBLIOGRAFIÁ

- Akademia e Shkencave të Shqipërisë. *Fjalori i shqipes së sotme*. Tiranë: Botimet Toena; 2002.
- Balla, Naim. & Ymeri Eshref. & Lama, Irena. *Dizionario maggiore dei modi di dire italiano-albanese*. Tiranë: EDFA; 2007.
- Çabej, Egerem. *Parallele Ausdrücke und Redensarten in den Balkansprachen*. Revue international des études balkaniques. 1936; 3; 172-184.
- Casadei, Federica. *Metafore ed espressioni idiomatiche. Uno studio semantico sull'italiano*. Roma: Bulzoni, 1996.
- Lo Zingarelli. *Dizionario della lingua italiana*. Bologna: Zanichelli; 2012.
- Navarro, Carmen. *Fraseología contrastiva del español y el italiano (análisis de un corpus bilingüe)*, Variis Linguis, Verona, 2004, p. 397- 411.
- Quartu, Bruno. *Dizionario dei modi di dire della lingua italiana*. Milano: Bur; 2001.
- Raffo, Anton. *Balcanismi e non*. Europa Orientalis 8. Contributi italiani al VI Congresso Internazionale di studi Sud-Est-Europei. 1989, 199-207.
- Thomai, Jani. *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë: Shkenca; 1999.
- Thomai, Jani. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Botimet Toena; 2006.
- Wojak, Barbara and Ginsburg Carla. *Zu Interlingualen Äquivalenzbeziehungen bei verbalen Praseolexemen*. “Das Wort: Germanistisches Jahrbuch DDR-UdssR”. 1987, 67-78.

**CREATION DES COMPETENCES, EN PRESENCE DES TICE,  
POUR UN APPRENTISSAGE AUTONOME DE FRANÇAIS  
AUTHENTIQUE**

**Dr. Klementina Shiba**

Département de Français

Faculté des Langues Etrangères, Université de Tirana

E-mail: klementina.shiba@unitir.edu.al

**ABSTRACT**

Distance learning/teaching as a new reality and inevitable consequence of the application of technology in the field of teaching of foreign languages, has become a subject of frequent analysis in regard to the increased efficiency that it brings to the learning process compared to traditional methods. However, the transition from theory to the use of this process in practice can pose numerous challenges. For the learner of a foreign language, the acquisition of reading skills involves the development of vocabulary and the training of skills that allow the transfer of habits from the classroom to the natural context of language use in the real world. By analyzing more concretely the creation of skills during the learning of FFL (with the aim of autonomous learning of authentic French), the teacher and learner must identify and overcome key obstacles. The purpose of this study is to analyze the impact of ICT on the development of these skills and to demonstrate that learning/teaching a language through Web-based tools accelerates and enriches the experience compared to the traditional classroom setting. Research indicates that the reasons behind this phenomenon are related to the extraordinary facilities Web-based tools create for learners while studying a text. On the one hand, there is the practicality of the presence of explanatory virtual dictionaries for any unknown terms encountered during reading, and on the other hand, there is the ease of using other sites to obtain authentic, in-depth, and detailed information, ultimately leading to an improved understanding of the text.

Keywords: authentic, ICT, interaction, learning, skills.

**PËRMBLEDHJE**

Leximi duhet të kuptohet si një process dinamik që përfshin lexuesin dhe tekstin e leximit. Në teori, gjërat duken të qarta dhe të thjeshta, por në praktikë vështirësitë dhe pengesat me të cilat përballet ky proces janë të shumta. Leximi, një aktivitet gjuhësori përqëndruar më shumë në marrjen e informacionit, i ndihmon nxënësit të ndërtojnë të kuptuarin e tyre në sajë të një ndër veprimi shumë kompleks me gjuhën e shkruar, përmes një praktike të vazhdueshme, për të krijuar aftësitë vetëvlerësimit të të kuptuarit, për të identifikuar dhe për të kapërcyer vështirësi të gjatë përvetësimit të një gjuhe. Për nxënësin e një gjuhe të huaj, përvetësimi i aftësisësë leximit është një proces që përfshin zhvillimin e fjalorit dhe formimin e aftësive që lejojnë transferimin e praktikave nga auditori në botën reale, aty ku gjuha përdoret në konteksin e saj natyror. Ky studim synon të analizojë ndikimin e TIK në lexim përtej mureve të klasës dhe të demonstrojë se mësimi i një gjuhe përmes internetit përspejton dhe pasuron aftësitë e leximit tek nxënësit duke rezultuar më produktiv nëse marrin një detyrë leximi online, sesa kur detyra jepet në klasë. Siç tregojnë rezultatet e hulumtimit, arsyet e këtij fenomeni janë të lidhura ngushtë me faktin se për të studiuar një tekst, interneti krijon lehtësira të jashtëzakonshme për nxënësit. Nga njëra anë karakteri praktik i pranisë së fjalorëve virtual shpjegues për terma dhe fjalë kyçe të panjohura, të hasura gjatë leximit, nga ana tjetër ata mund të përdorin adresë të ndryshme për të marrë informacione të sakta, autentike, të thelluara dhe të hollësishme duke sjellë aktivitete të pasura dhe informacione plotësuese për të përmirësuar të kuptuarin.

Fjalët çelës: autentik, lexim, ndërveprim, të mësuarit, TIK.

## Introduction

L'enseignement /apprentissage à distance, une nouvelle réalité, conséquence inévitable des applications technologiques dans le domaine de l'enseignement en général et des langues étrangères en particulier est récemment devenu un sujet de discussions fréquentes sur les aspects d'efficacité qu'il peut apporter à ce processus par rapport aux formes traditionnelles. Le principe est simple : l'apprenant de la maison, du bureau accomplit ses devoirs impliqué dans un processus de communication continue avec le professeur via Internet. « *Théoriquement on croit que la puissance de l'ordinateur et d'Internet permet aux programmes à distance de développer la flexibilité, l'interopérabilité et le rythme de travail, mais la manière comment cela se réalise dans la pratique, reste à prouver.* » (Warschauer, Shetzer, Meloni, 2000 : 75)

La reconception des philosophies de l'enseignement/apprentissage des langues étrangères doit affecter de manière irréversible la manière comment les enseignants et les apprenants, en tant qu'acteurs centraux du nouvel environnement d'apprentissage, prennent de nouveaux rôles et responsabilités. De l'analyse des enquêtes dans le cadre des projets de la Commission Européenne ayant comme objets l'éducation contemporaine, s'avère que la plupart des professeurs de langues étrangères dans différents pays européens considèrent l'enseignement en présence des TIC comme le plus favorable par rapport à celui traditionnel, tout en étant conscient de différents obstacles à sa mise en œuvre. Comme l'apprentissage de la langue vise aussi l'apprentissage de la culture, cet article se propose d'adresser des questions de l'application de l'enseignement de FLE authentique à un nouveau contexte socioculturel où l'enseignement centré sur l'enseignant laisse la place à celui centré sur l'apprenant. Analysons plus concrètement la création de la compétence de la lecture au cours de l'enseignement/apprentissage de FLE visant un apprentissage autonome du français authentique.

La lecture doit être conçue comme un processus dynamique impliquant à la fois le lecteur et le texte de lecture. La lecture, une activités langagières de la réception concentrée plutôt sur l'information, aide les apprenants à construire son propre sens grâce à une interaction très complexe avec le langage écrit, à travers une pratique continue dont l'objectif est de créer des habiletés d'autoévaluation du niveau de la compréhension, d'identifier et de surmonter les difficultés pendant l'apprentissage d'une langue.

Pour l'apprenant d'une langue étrangère, l'acquisition de la compétence de la lecture est un processus qui implique le développement du vocabulaire et la formation des aptitudes permettant le transfert des habitudes du cours de la salle de classe vers le monde réel, là où la langue est utilisée dans son contexte naturel. Cette étude se propose d'analyser l'impact des TIC à la lecture au-delà des murs de la classe et de démontrer que l'enseignement/apprentissage d'une langue à travers le site Web en ligne accélère et enrichit les compétences en lecture des apprenants, qui sont plus productifs lorsqu'ils prennent un travail de lecture en ligne que lorsque la tâche est donnée en classe.

Comme en témoignent des recherches en didactique, les raisons qui expliquent ce phénomène sont étroitement liées au fait que pour étudier un texte, le site Web en ligne crée des facilitations extraordinaires aux apprenants. D'une part le caractère pratique de la présence des dictionnaires virtuels explicatifs pour les termes et les mots clés inconnus rencontrés pendant la lecture, d'autre part ils peuvent utiliser des adresses supplémentaires pour obtenir des informations précises, authentiques, approfondies et détaillées évoquant des activités riches et fournir des informations complémentaires afin d'améliorer la compréhension.

Les technologies numériques (TN), considérés essentiellement comme un moyen de prise d'information ou un espace de divertissement, ont une grande contribution positive dans divers domaines professionnels tel que dans l'enseignement en général et particulièrement dans celui des langues étrangères. « Cette montée en puissance du numérique n'a pas manqué d'affecter le secteur de l'enseignement, celui des langues en particulier. » (Desmet, 2006 :119)

La tendance humaine, à considérer la technologie de manière anthropomorphique, augmente le potentiel d'Internet pour soutenir le processus d'enseignement /apprentissage authentique des langues à l'aide des TIC.

Ainsi des recherches et de la pratique soutiennent également le modèle sociolinguistique interactif, qui met l'accent en premier lieu sur l'aspect social de la langue et la découverte des barrières linguistiques dans le processus de communication orientant l'enseignement authentique des langues vers un enseignement de compétences centré sur l'apprenant.

Au cours de l'enseignement /apprentissage d'une langue on enseigne la langue et des modèles lexico-grammaticaux et l'apprenant adopte également un nouveau système de pensée. Cela nécessite une plus grande exposition des apprenants à de nouveaux contextes de communication authentiques en présence des technologies de l'information et de la communication (TIC), étant donné que les matériaux simplement didactiques ne peuvent pas l'offrir. « Pour ce faire il faut définir les concepts de base nécessaires à la production d'un enseignement de langues étrangères, qui permettent à l'apprenant d'intégrer une nouvelle langue ainsi qu'« une nouvelle culture au moyen d'une *pédagogie adaptée.*» (Byram, 2011:256)

Compte tenu de la manière dont les langues sont apprises, de nombreux enseignants et apprenants, exposés quotidiennement à Internet et aux TIC, qui ont fortement influencé l'enseignement /apprentissage par leurs moyens, en ont beaucoup profité en y introduisant de nouvelles stratégies et techniques, en vue de réussir à l'apprentissage de FLE. L'expérience pédagogique montre que pour étudier un texte, l'environnement d'enseignement /apprentissage en ligne peut créer des facilitations extraordinaires aux apprenants. «La technologie numérique offre des avantages évidents pour atteindre les objectifs ambitieux de l'enseignement.»<sup>1</sup> (Turkle, 1996 :12)

1 La traductions est faite par moi ( Shiba, K).

Les TIC avec leur caractère autodidacte d'utilisation ont mis en évidence leur caractéristique à l'apprentissage autonome. « Le domaine de l'enseignement des langues assisté par ordinateur n'ait cessé de se développer pour devenir, à l'heure actuelle, un domaine de recherche assez important au sein de la linguistique appliquée en général, et dans le domaine de la didactique des langues en particulier.» (Desmet, 2006: 119)

Les TIC, multipliant le degré et la qualité d'exposition à de nombreux contextes linguistiques authentiques, soutiennent fortement l'enseignement /apprentissage de FLE authentique en facilitant les enseignants à communiquer avec leurs étudiants en dehors de la salle de classe, à discuter sur les devoirs, à leur envoyer des corrections et les aidant également à partager leurs intérêts, publiant, téléchargeant de différentes services pour qu'ils aient de nombreuses informations utiles à propos d'un sujet précis. « Il doit favoriser les interactions entre les apprenants et leur proposer des situations de communication stimulantes. » (Hirschsprung, 2005 : 14)

La compétence de la compréhension écrite ou de la lecture se considère comme un composant très important de l'enseignement /apprentissage d'une langue, ayant au centre l'apprenant. « Cette méthodologie place l'apprenant au centre de son apprentissage. » (Hirschsprung, 2005 : 14)

L'apprenant n'est plus considéré comme un simple récepteur passif des instructions de l'enseignant, au contraire, les apprenants interagissent mutuellement en partageant les connaissances et la responsabilité des tâches, ce qui entraîne un changement du focus de l'enseignement vers un enseignement de la construction des connaissances et des compétences centré sur l'apprenant. « De toute évidence, il s'agit d'un contexte typique d'enseignement centré sur l'apprenant, où l'accent se met sur la nature communicative, le dialogue social et la construction des connaissances. » ( Powell & Kalina, 2009 : 243) La lecture conçue comme un processus dynamique dans la construction du sens implique à la fois le lecteur et le texte lui grâce à la création d'un cadre mental qui aide l'apprenant à construire *un sens* à travers le langage écrit. L'un des objectifs de l'enseignement est de développer des habitudes pour identifier les difficultés, définir et mettre en œuvre les stratégies appropriées pour une bonne compréhension. Pour l'apprenant d'une langue étrangère, l'acquisition de la compétence en lecture est un processus qui implique le développement du vocabulaire et la création des compétences nécessaires.

Toutefois, si en théorie, les choses semblent claires et simples, les difficultés et les obstacles auxquels se heurte ce processus en pratique sont nombreux, un défi ouvert pour l'enseignement des langues étrangères en général et du FLE en particulier. A ce stade de l'enseignement /apprentissage les chercheurs et les enseignants doivent viser de « Différencier la pédagogie pour mieux lutter contre l'échec scolaire; rénover les contenus et les didactiques; développer les pédagogies actives, participatives, coopératives.» ( Perrenoud, 1994 : 9)

L'habitude de lecture en présence des TIC face à celui traditionnel en salle de classe a une contribution importante à l'apprentissage du FLE *authentique*. En fait les TICE

créant une espace de communication interactive peuvent être utilisées comme un *outil parallèle*, un support pédagogique ou bien une source pour renforcer le contenu du cours de l'enseignement/apprentissage des langues, pour le rendre plus efficace et plus attrayant afin d'assurer de hauts niveaux de la motivation du succès à l'apprentissage des langues.

## 1. Crédit de la compétence de lecture en présence des TIC

En quoi les TIC soutiennent et enrichissent le processus de l'enseignement / apprentissage de FLE authentique, accélérant la création de la compétence de lecture en vue de pouvoir en profiter une meilleure performance à la communication ?

Des recherches en didactiques, inclue la présente étude, tentent de confirmer qu'en utilisant les TIC comme support pédagogiques, cela peut améliorer les *résultats* et la satisfaction des apprenants pendant l'apprentissage d'une langue étrangère.

Afin de produire des résultats objectifs, on a pris soin de déterminer diverses constantes, pour chaque environnement d'enseignement, du contenu et de la structure formelle du matériel de lecture, à travers lequel cette étude s'actualise. Pour obtenir des opinions à comparer, en vue des conclusions, on a enquêté les apprenants sur le niveau de la compétence de lecture au début et à la fin de l'expérimentation, alors que pour évaluer l'efficacité de chaque environnement d'enseignement à la performance des apprenants en lecture, on a conçus deux autres tests, effectués au début et à la fin de l'expérimentation, au respect des objectifs de l'étude dont la comparaison des résultats a servi d'indicateur du degré d'amélioration des performances de la compétence de lecture dans les deux environnements.

L'analyse statistique des valeurs d'amélioration, obtenue dans chaque environnement, met en évidence leur efficacité dans le développement des compétences de lecture en français. Pour mesurer le niveau de la *motivation* et de la satisfaction lors de la pratique de la lecture dans les deux environnements, les étudiants ont effectués une évaluation à deux étapes ; au début et à la fin de l'expérimentation. Enfin pour mettre en évidence certains aspects concrets du plaisir lors de l'apprentissage utilisant les TIC, nous avons mené auprès des étudiants une enquête détaillée d'indicateurs.

Dans le but de promouvoir la compétence de lecture en FLE des étudiants, pour créer un environnement d'apprentissage plus riche et *autonome* au-delà des murs de la salle de classe, on a conçu du matériel pédagogique actualisé, *authentique* adapté à leur niveau, à leurs besoins et leurs intérêts.

Le principe essentiel à la création de cette expérimentation est le modèle de la lecture interactive. La conception du matériel pédagogique prévoyait des mécanismes, des activités et des pratiques facilitant l'établissement de liens entre les connaissances antérieures et les nouvelles informations à recevoir, il repose également sur un ensemble de principes nécessaires à la création d'un programme de lecture dans un environnement

d'enseignement hybride tels que:

- choisir du matériel approprié au niveau des étudiants
- prendre en compte : - des besoins - des intérêts des étudiants
- soutenir l'utilisation des TIC
- favoriser l'interaction
- encourager la motivation
- évaluer leur performance

L'enseignement/apprentissage d'une langue étrangère en présence des TIC accélère et enrichit la compétence de lecture, par rapport à l'enseignement traditionnel en salle de classe. Pour répondre à cette question, on a évalué certains indicateurs lors de l'expérience d'apprentissage du français en présence des TIC tels que :

- l'accessibilité numérique
- la performance d'apprentissage
- la motivation
- la satisfaction

Les séances prévues pour cette étude sont conçues conformément aux stratégies de développement des habitudes en lecture guidées par le modèle contemporain de structuration des séances de lecture en activités de *prélecture*, de *lecture* et de *post-lecture*. Les textes de lecture choisis sont des documents authentiques, des informations publiées dans des sources fiables sur des sujets qui concernent les intérêts actuels des étudiants en matière d'*environnement*, des *droits de l'homme*, des *traditions*, des *loisirs* etc., appropriés à l'enseignement en général.

Les activités de *prélecture* ; des fiches pédagogiques envoyées par courrier électronique revêtent un caractère évocateur et très pratique, des vidéo en ligne et des questions suggestives afin d'éveiller la sensibilité des étudiants sur les thématiques concernées, enrichissant leurs connaissances, leurs expériences et contribuant à l'intégration des connaissances linguistiques et culturelles en utilisant tous les *sens*, en vue de préparer les étudiants à un processus de lecture approfondie.

Pendant la phase de *lecture*, pour la pratique en ligne, les étudiants sont invités à relire le document et à effectuer les activités proposées de la fiche en se concentrant sur l'analyse sémantique et le vocabulaire clé du texte. Les sources de références permettent d'approfondir les connaissances sur des concepts en général et l'explication des termes de caractère technique.

L'étape de *post-lecture* dans la fiche s'actualise à travers des activités créatives à caractère de discussion et de recherche, où les étudiants sont invités à *réfléchir* et à apporter des solutions au problème rencontré dans le document. Cette étape prend une nouvelle dimension car les discussions, débats et suggestions sont publiés au forum de sorte qu'ils deviennent accessibles à tous les étudiants du groupe où ils interagissent de manière asynchrone en laissant des commentaires.

Le programme de lecture en classe traditionnelle suit la même structure qu'en ligne. Il en va de même pour les activités en phase *de lecture*, tout en modifiant les activités en phase de *prélecture*, qui évoquent des informations par l'exploration des photos et à l'étape de *post-lecture*, les étudiants sont invités à réfléchir en écrivant des commentaires.

## Conclusions

Choisisissant l'utilisation les TIC et Internet dans l'enseignement/ apprentissage des langues prouve que ces outils sont perçus comme favorisant, enrichissant et accélérant ce processus.

Les données traitées statistiquement démontrent l'avantage indéniable de l'enseignement en ligne par rapport à celui traditionnel en termes de capacité à favoriser une interaction durable de leurs acteurs. Par la comparaisons des indicateurs de l'enquête résulte la participation active des étudiants aux deux environnements, ce qui signifie que ce programme de lecture a suscité beaucoup d'intérêt.

Deux indicateurs importants, qui font référence à la *motivation* et à la *satisfaction* pendant les séances de lecture, ont connu une progression supérieure importante en présence des TIC. Les étudiants décrivent la tâche donnée comme motivante, intéressante, stimulante et très utile pour leur formation, et affirment le plaisir de lire des matériaux intéressants.

L'utilisation de liens supplémentaires joue un rôle indispensable dans l'amélioration du niveau de *compréhension* et dans la promotion des *capacités d'expression* des étudiants qui ont des évaluations très positives sur la manière dont les séances sont organisées, la communication virtuelle asynchrone adaptées à un apprentissage autonome.

Le travail qualitatif effectué en ligne, en fournissant des productions écrites réflexives et variées, respecte les consignes de rédaction d'un essai. Nos étudiants sont donc plus productifs en ligne que quand on leur donne un devoir en salle de classe grâce à la présence des dictionnaires virtuels et l'utilisation des liens supplémentaires pour trouver des *informations précises, authentiques, approfondies* afin d'améliorer leur compréhension écrite.

## BIBLIOGRAFÍA

- Byram, Michel. 2011: *La compétence interculturelle* Blanchet, Philippe, et Chardenet, Patrick, *Guide pour la recherche en didactique des langues et des cultures*. Éditions des archives contemporaines (EAC).
- Desmet, Piet. 2006/1. *L'enseignement/apprentissage des langues à l'ère du numérique : tendances récentes et défis*. Revue française de linguistique appliquée (Vol. XI), 119,124,126,129.
- Hirschsprung, Nathalie. 2005. Le multimédia in *Apprendre et enseigner avec le multimédia*. Hachette, Paris.
- Perrenoud, Philipe. 1994. *La formation des enseignants entre théorie et pratique*. Paris : L'Harmattan.
- Powell, Katherine., & Kalina, Cody. 2009. *Cognitive and Social Constructivism: Developing Tools for an Effective Classroom*, Education, 130/2.
- Turkle, Sherry. 1996. *Life on the screen: Identity in the age of the Internet*, New York: Touchstone.
- Warschauer. Marc, Shetzer. Heidi, Meloni. Christine. (2000). *Internet for English Teaching*. Alexandria.

## TERMAT NË LIDHJE ME STRUKTURËN SEMANTIKE TË FJALËS NË SHQIPE NË PËRQASJE ME GREQISHTEN

**Prof. Asoc. Dr. Eda Shehu**

Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: eda.shehu@unitir.edu.al

### PËRMBLEDHJA

Në studimet rrith leksikut të çdo gjuhe vend të veçantë zënë marrëdhëniet e fjalëve dhe termave, sidomos, vështrimi i termave të ngritur mbi bazën e fjalëve të zakonshme nga ku mund të krahasohen struktura semantike e fjala me strukturën konceptore të termit. Përqasja e dukurive që vihen re në këtë vështrim me një gjuhë të huaj hedh dritë dhe çon më tej studimin në të dyja gjuhët rrith kësaj shtrese të leksikut. Këtu, në këtë studim trajtohen termat njëfjalësh të ndërtuar mbi bazën e kuptimit të fjalëve të zakonshme dhe zhvillimin e tyre në terma togfjalëshash në shqipe dhe në greqishte, nga ku vërehen mjaft dukuri interesante në anë të përbashkëta e të veçanta në secilën gjuhë, siç mund të sillen si shembuj në shqipe: rrënje (fjalë e zakonshme) → rrënje (term në matematikë) dhe më tej: rrënje katrore, rrënje kubike dhe përkatësisht në greqishte: τετραγωνική ρίζα, ρίζα κύβου.

Fjalët çelës: leksik, gjuhë, strukturë konceptuale, strukturë semantike, terma.

### ABSTRACT

In the study about the lexicon of each language a special place is occupied by the relations of words and terms, especially, the look of terms raised on the basis of ordinary words from where the semantic structure of the word can be compared with the conceptual structure of the term. The approach of the phenomena observed in this view with a foreign language sheds light and leads further the study in both languages about this layer of lexicon. Here, in this study, are treated the one-word terms built on the basis of the meaning of common words and their development into phrase terms in Albanian and Greek, from where many interesting phenomena are observed in common and specific aspects in each language, as can be brought as examples in Albanian: rrënje (common word) → rrënje (term in mathematics) and further rrënje katrore, rrënje kubike and respectively in Greek: τετραγωνική ρίζα, ρίζα κύβου.

Keywords: lexicon, terms, conceptual structure, semantic structure, language.

Fjalët dhe termat në studimet rrith leksikut në çdo gjuhë, sikurse në shqipe dhe në greqishte, janë pranuar si njësi emërtuese të ndryshme, me tipare të dallueshme, që veçohen në fondin tërësor të leksikut si pjesë e mëvetësuar e tij, ndonëse kanë edhe anë të përbashkëta, si edhe raste kalimesh nga njëra njësi tek tjetra<sup>1</sup>. Duke nxjerrë në pah fjalët dhe termat, si dy shtresa njësish që kundërvihen brenda leksikut tërësor të gjuhës e që përbëjnë kështu të dyja së bashku fondin leksikor të gjuhës, prof. A.Kostallari<sup>2</sup> i ndan njësitë leksikore të gjuhës në joterma dhe terma, duke i diferencuar si pjesë të mëvetësuarë. Duke i vështruar këto dy kategori leksikore në lidhje me njëra-tjetrën, mund të pohohet, se fjalët (jotermat), janë parësore ndaj termave, kështu që, këto të fundit, dalin në funksionin e tyre në gjuhë, si dytësore dhe si bazë për formimin e tyre janë fjalët, (këtu kihen parasysh këtu fjalët e zakonshme.) Megjithatë një pjesë termash, mund të konsiderohen si njësi të mirëfillta terminologjike (terma), nga ku zbulohet vetëm përkatësia e tyre në një fushë dije, si në shqipe, ashtu edhe në greqishte, si p.sh.: tretësirë (kim.) / (το διάλυμα) (greq.), trekëndësh (mat.) / ( το τρίγωνο) (greq.), diferencial (το διαφορικό) (greq.). Kryesisht, pjesa tjetër vjen nga fjalët (e zakonshme), ku fjalët ngrihen në terma, kur përdoren në ligjërimin e një fushe të veçantë dije ose kur përdoren dhe si fjalë dhe si terma, si p.sh.: nga vesh (njeriu) (fjalë e zakonshme dhe term) (në mjekësi) → vesh (plugu) (term) (në bujqësi) dhe pikërisht në greqishte αντί (άντρας) (fjalë e zakonshme dhe term), αντί (άροτρο) (term) (në bujqësi). Megjithatë, nga ana e formimit të tyre në çdo gjuhë, fjalët dhe termat kanë rrugë të afërta a të përbashkëta, por ka raste kur ato ndërtohen në mënyra origjinale, sidomos termat që ngrihen, si të tilla, mbi bazën e fjalëve të zakonshme, sikurse sollën më sipër vesh si fjalë dhe si term. Fjalët dhe termat jepen si gjegjëse barazvlerëse, kur ballafaqohen në rrafshë ndërgjuhësore, ku ato ruajnë në të dyja gjuhët (ose në të gjitha gjuhët që përqasen) individualitetin e tyre.

Konceptimi i fjalëve dhe i termave si një fond i përbashkët leksikor, por me anë të përbashkëta dhe të kundërtë, me lidhje të brendshme e kalime të njësive njëra tek tjetra, jep mundësinë të vështrohen edhe lidhjet e kuptimeve përkatëse të tyre brenda strukturave kuptimore të secilës njësi<sup>3</sup>. Kështu brenda strukturave kuptimore të fjalëve nxirren edhe lidhjet e tyre me kuptimet e termave<sup>4</sup>, kur një njësi me strukturat e saj del edhe si fjalë edhe si term, e shprehur nga e njëjta shenjë, si në shqipe, ashtu edhe në greqishte: rrënëjë1 (fjalë) - rrënëjë2 (term) / (gr.) η ριζα1 (fjalë) - η ριζα2 (term), (shq.) kokë1 (fjalë) - kokë2 (term) / (gr.) το κεφάλι1 (fjalë) - το κεφάλι2 (term), pikë1 (fjalë) - pikë2 (term) / (gr.) η τελεια1 (fjalë) - τα στιγματα2 (term).

1 A.Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.

2 A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, Sf., Nr.4, f.42. Tiranë, 1984.

3 E. Lafe, A.Çepani, *Rreth pasqyrimit të fushave terminologjike në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"* në Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektive», Tiranë, 2004.

4 Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"*, "Studime filologjike", 1986/2.

Secili term i mësipërm, si rrënje<sup>2</sup> - kokë<sup>2</sup> - pikë<sup>2</sup> krijon lidhje brenda të njëjtës shenjë, duke shprehur koncepte të fushave të ndryshme, si rrënje<sup>1</sup> (bot.) - rrënje<sup>2</sup> (dhëmbi) (mjek.) - rrënje<sup>3</sup> (katrore) (mat.) etj., të cilat në terminologjitet dalin si homonime. Si njësi barazvlerëse terminologjike në greqishte kemi: η ριζα1 (bot.) - η ριζα2 (δοντιών) (mjek.) - τετραγωνικη ριζα3 (mat.)

Nga paraqitura e mësipërme del se, lidhjet e brendshme të strukturave kuptimore të termave në nivel homonimesh (rrënje<sup>1</sup>(bot.) - rrënje<sup>2</sup> (mjek.) - rrënje<sup>3</sup> (mat.), që u dalin nga struktura kuptimore e fjalës (në rastin tonë rrënje / (gr.) η ριζα1 (fjalë), - η ριζα2 (mjek.) - η ριζα3 (mat.), pasqyrohen në strukturat semantike të fjalëve në fjalorët dygjuhësh të gjuhës së përgjithshme në gjuhën dhënëse dhe marrëse si gjegjëse barazvlerëse leksiko-semantikë, si, p.sh. në shqipe rrënje<sup>1</sup> (fjalë) - rrënje<sup>2</sup> (term) - rrënje<sup>3</sup> (term) dhe përkatesisht në greqishte: η ριζα1 (fjalë) - η ριζα2 (term) - η ριζα3 (term) siç e përmendëm dhe më sipër. Ky proces ka vlera teorike e praktike, meqë mbështetet mbi një lëndë shumë të gjerë leksikografike. Megjithatë në këtë trajtesë ne mbështetemi në dy fjalorë dygjuhësorë: shqip - greqisht<sup>5</sup> / greqisht-shqip (për fjalët dhe termat)<sup>6</sup>.

## **1. Përbajtja e strukturave semantike të fjalëve dhe ballafaqimi i tyre në shqipe dhe në greqishte**

Kur vështrojmë fjalët e një gjuhë në përgjithësi (p.sh. të gjuhës shqipe) në ballafaqim me një gjuhë tjetër (me greqishten ose me disa gjuhë njëkohësisht), sidomos në fjalorët dygjuhësh (në rastin tonë shqip-greqisht dhe greqisht-shqip), realisht konstatohen se ato pasqyrohen të kundërvëna në strukturat semantike të tyre. Në paraqitjen ballafaquese të strukturave kuptimore të fjalëve ne zbulojmë për secilin kuptim të veçantë a ngjyresë kuptimore të tyre në njëren gjuhë, barasvlerësit kuptimorë në gjuhën tjetër, të shfaqura si barasvlerës shenjorë-kuptimorë. Kështu, p.sh., kuptimet e fjalës shqipe pikë jepen të zërbytyra në një varg barasvlerësish shenjoro-kuptimorë në gjuhën greke që pasqyrohen në strukturën semantike të tyre, si: pikë (shq.) / (gr.): 1. η σταγονα, η σταλα, 2. τα στιγματα, 3. η αποπληξια, 4. η τελεια, 5. κατευθυνση, 6. το σημειο, το οριο, 8. ποντος, etj. Këtu futen edhe kuptime të tjera të fjalës shqipe pikë, të pasqyruara në barasvlerës kuftimorë në gjuhën greke, kryesisht të nivelit të figurshëm, si: ακριβως, νταμπλας, καταρα etj.

Mund të theksohet se, në mënyrë ballafaquese, çdo barasvlerës shenjor-kuptimor në gjuhën e huaj (greke) jepet vetëm në një kuftim të tij, si p.sh. pikë në raport me η σταλα të (kuft. 2), në lidhje me η τελεια të (kuft. 5), në lidhje me το σημειο (kuft. 6), po pikë në raport me η σταλα, ακριβως, νταμπλας, καταρα, etj., meqë në vetvete, secili barasvlerës,

5 N.Gjini, *Fjalor shqip-greqisht*, Janinë, 1998.

6 N.Gjini, *Fjalor greqisht - shqip*, Janinë, 1993.

si fjalë më vete në greqishte (si η σταγονα, η σταλα, τα στιγματα, η αποπληξια, η τελεια, το σιμειο,) ka strukturën e vetë kuptimore me barasvlerësit përkatës. Kështu, pikë e greqishtes ka si barasvlerës: pikë; njollë; vrimë; shenjë; vend etj. në shqipen. Nga ana e vet, edhe fjala pikë në shqipe, e marrë në vettete, bashkëlidhet me fjalë të tjera shqipe, mbi bazën e kuptimeve të tyre të njëjtë me fjalen pikë, në çdo kuptim të saj, si: pikë: 1.grimcë; 2. qendër; 3. njollë e vogël; 6. shenjë pikësimi; 7. vend referimi; 9. drejtim; 10. kufi; etj. / (në greqisht) Υ σταγονα (Αλβανο-Ελληνικο Λεξικο) 1.η σταγονα, 3.το στιγμα, 6.η τελεια, 6.το σιμειο, 7.το στιγμα 10.το σιμειο, 11.η αποπληξια,

Pra, në rrashin e kuptimeve leksikore sistemet leksikore nuk përputhen ndërmjet gjuhëve. Ato mund të jenë të ngjashme, të afërtë ose edhe të ndryshme dhe, si të tilla, paraqiten në forma shumë komplekse.

Ballafaqimi i strukturave kuptimore të dy gjuhëve dëshmon se marrëdhëniet e ndërmjet barazvlerësve shenjoro-kuptimore mund të krijojnë lidhje të caktuara, të ngjashme me lidhjet sinonimike të një gjuhe të veçantë. Në këtë rast mund të flitet për sinoniminë ndërgjuhësore, ndërmjet së cilës mund të studiohen marrëdhëniet kuptimoro-leksikore ndërmjet gjuhëve në bazë të përqasjes së strukturave semantike të fjaleve.

Megjithatë, karakteri (natyra) e lidhjeve ndërmjet kuptimeve mund të jenë të formave të ndryshme. Ato mund të jenë të drejtpërdrejta, por ato mund të jenë të zhdrojta, duke u shmangur nga kuptimet themelore. Këto kalime kuptimesh ndonjëherë brenda një fjale në një gjuhë të dhënë mund të jenë të tilla, që lidhjet ndërmjet kuptimeve bëhen shumë të kapshme, sidomos kur dalin nga një bazë e përbashkët, si edhe kur dalin njëri nga tjetra, por ato mund të jenë më të largëta deri sa mezi ndahen si të tilla, duke përfunduar në homonime.

Duke i modeluar lidhjet kuptimore në struktura semantike të fjaleve mund të përcaktojmë këto tipologji rastesh:

- a) lidhjet me kalime të drejtpërdrejta: pikë1 në shqipe / (greqishte)- η τελεια
- b) lidhjet me kalime të zhdrojta: pikë2 në shqipe (njollë, shenjë) / (në greqishte) - τα στιγματα
- c) lidhjet me kalime komplekse (kur kombinohen lidhjet e drejta me të zhdrojtë): pikë3 - / (greqisht) ακριβως i rëntë pika (sëmundje) - νταμπλας (καταρα).

Kjo do të thotë se, sa më komplekse të jenë lidhjet ndërmjet kuptimeve brenda një gjuhe, të zbuluara në strukturat kuptimore të fjaleve, aq më e vështirë bëhet gjetja e barasvlerësve shenjoro-kuptimorë në gjuhën tjetër që përqaset me të. Për këtë arsyе në shumë raste vetëm konteksti mund t'i zgjidhë gjetjen e barasvlerësit përkatës në gjuhën tjetër, ku kompleksiteti i lidhjes kuptimore është shumë i madh. Në këtë rast sa më e gjerë të jetë struktura kuptimore e fjaleve, aq me vështirë gjenden barasvlerësit në gjuhën që ballafaqohet, siç del nga fjala me strukturë të gjërë kuptimore, si tek foljet: bëj, marr, jap; tek emrat: rrugë, bukë etj.

## 2. Paraqitura e termave në lidhje me strukturën semantike të fjalëve

Ndërmjet fjalës (së zakonshme) dhe fjalës së ngritur në term (fjalës term), nga njëra anë, si edhe kuptimeve terminologjike, në strukturën semantike të fjalës dhe kuptimeve të tjera të saj, nga ana tjetër, krijohen marrëdhënie të ndryshme, të cilat kushtëzohen nga natyra jo e njëjtë e këtyre kuptimeve dhe e njësive leksikore që i shënojnë ato. Kështu, një pjesë kuptimesh kanë një karakter të drejtpërdrejtë special terminologjik, të qartë e të kristalizuar, secili nga të cilët ka në fushën përkatëse të dijes fjalën term si shënues të pavarur, si, p.sh. kuptim terminologjik “*pikë*” (ggeom.) / (gr.) το σημείο dhe termi *pikë*, kuptimi “*rrënje*” (mat.) / (greqisht) η πίσα dhe termi *rrënje* (gr.) η πίσα Tek disa të tjera ky kuptim terminologjik nuk mëvetësohet si i tillë, por zbulohet si kuptim i përgjithshëm special në lidhjet leksiko-sintaksore, në të cilat hyn fjalë si fjalë e zakonshme me fjalët e tjera si p.sh. kuptimi special’cak deri ku arrin të zhvillohet një proces i fjalës *pikë* në lidhjet leksiko-sintaksore që hërbejnë si terma *pikë shkrirje*, *pike ngrirje*, *pikë vlimi*, *pikë vese* (term) / (greq.) σημείο τήξης, σημείο πήξης, σημείο βρασμού, σημείο δρόσου. Disa kuptime terminologjike mund të zbulohen edhe brenda lidhjeve leksiko-sintaksore që përdoren në strukturën semantike të fjalës së lëndë ilustruese, si p.sh. *shpim mekanik*, *shpim elektrik* (= “*shpim*”), “*shpim*” (elektik),/ (greq.) μηχανική διάτρηση, ηλεκτρική διάτρηση (= “διάτρηση”), “διάτρηση” (ηλεκτρική) d.m.th. kuptimi terminologjik “*shpim*” në mek,” si proces përpunimi me prerje për hapjen e vrimave ...”); *lodhje fizike* / (greq.) σωματική κόπωση ( d.m.th kuptimet terminologjike “*lodhje*” në mek, dhe fizioli / (greq.) “*κούραση*”; goditje *në krahë* =”*goditje*” në usht.) / (greq.) κυύπημα στα φτερά etj.

Një pjesë kuptimesh terminologjike nuk pasqyrohen si të tilla në strukturën semantike të fjalës, por ato përbahen pjesërisht në njëren nga kuptimet e saj. Ky kuptim “shndërrohet”, ngrihet në kuptim terminologjik me elementet e veta plotësuese semantike në një fushë të caktuar të dijes. Kështu p.sh. mund të sjellim si shembull kuptimet e fjalëve shqipe: *rrënje*, *lumë*, *kokë*, si kuptime të zakonshme dhe kuptimet terminologjike po të këtyre fjalëve terma në fusha të ndryshme si *rrënje* (bot.), *mal*, *lumë* (gjeogr.), *kokë* (anat.) etj. në forma barzvlerëse në greqishte: η πίσα (bot.), το βουνό, το ποτάμι (gjeogr.), το κεφάλι (anat.).

Duke e vështruar strukturën semantike të fjalës nga pikëpamja e rrafshit të fjalës term mund ta përfytyrojmë këtë të fundit si një strukturë të gjerë semantike speciale, brenda së cilës në rastin më të mundshëm mund të zbulohen katër lloje kuptimesh<sup>7</sup> me veçori specifike për secilin prej tyre<sup>8</sup>: 1) kuptime speciale terminologjikisht të kristalizuara, të veçueshme si kuptime të mirëfillta brenda strukturës semantike të fjalës; 2) kuptime speciale terminologjikisht të pakristalizuara; 3) kuptime speciale të dyzuara, brenda të cilave bashkëjetojnë në simbiozë kuptimi i zakonshëm i fjalës me kuptimin terminologjik:

<sup>7</sup> S.Kurti, *Fjalor politeknik anglisht-shqip*, Tiranë, 1991.

<sup>8</sup> S.Kurti, *Fjalor politeknik rusisht-shqip*, Tiranë, 1981.

4) kuptime terminologjike të zbuluara në lidhjet leksiko-sintaksore të fjalës, të përdorura si lëndë ilustruese në fjalar.

### **3. Paraqitura terminologjiko-konceptore (e termave njëfjalësh e togfjalësh) në fjalarët terminologjikë në të dyja gjuhët (shqip - greqisht)**

Mbi bazën e strukturës kuptimore të fjalës mund të zbulohet struktura konceptore e termit si e veçuar mbi bazën e strukturës semantike të fjalës, ku çdo term si shënuar i një koncepti mëvetësohet sipas fushës së dijes, por secila strukturë mund të plotësohet më tej me zërthime të tjera, ku konceptet dalin si “zhvillime” të njëri-tjetrin. Struktura konceptore del kështu me shkallë largësie të ndryshme ndërmjet koncepteve, të cilat (shkallët) mund të indeksohen numerikisht. Po sjellim një shembull me *kokë* si term, si përfaqësues për fusha të ndryshme, por edhe për koncepte të identifikuara në lidhjet sintagmatike të termit, që shërbejnë si kontekste të tillë.

<b>Shqip</b>	-	<b>Greqisht</b>
<i>kokë</i> 1 (mjek.) <i>kokë</i> (njjeriu)		(gr. <sup>9</sup> ) κεφάλι 1 (mjek.)
↓		το κεφάλι (άντρας)
<i>kokë</i> 2 (mjek.) <i>kokë</i> (organi) (e ndërtuar, mbi bazën e konceptit të shprehur nga <i>kokë</i> 1)		(gr.) κεφάλη (όργανο)
↓		↓
↓		↓
<i>kokë</i> 3 (bot.) ( <i>kokë</i> e pistilit)		(gr.) (κεφάλη πιστολι)
↓		↓
<i>kokë</i> 4.1 (mek.) ( <i>kokë</i> buloni)		(gr.) (κεφαλή μπουλονιού)
↓		↓
<i>kokë</i> 4.2 (mek.) ( <i>kokë</i> prerëse)		(gr.) (κεφαλή κοπής)
↓		↓
<i>kokë</i> 5 (mek.) <i>kokë</i> (blloku i motorrit)		(gr.) κεφαλή (μπλοκ κινητήρα)
↓		↓
<i>kokë</i> 6 etj.		το κεφάλι...

9 N.Gjini, *Fjalar greqisht - shqip*, Janinë, 1993.

Megjithatë vështruar nga pikëpamja terminologjike. d.m.th., nëse të tëra këto lidhje di t'i shihnim si shenja termformuese në kuadrin e tërë sistemit terminologjik, atëherë secila shenjë do të ishte bazë e ndërtimit të termave togfjalësh dhe gjithë struktura mund të shihet si strukturë homonimike<sup>10</sup>. Kjo mund të dilte e qartë nëse do t'i shihnim këto lidhje shkurt edhe në kuadrin e 2-3 fushave të dijes. Si shembull këtu mund të sillnim termin pikë, të përdorur në disa fusha dije si term më vete dhe në përbërje të termave togfjalësh, si elemente përcaktuese.

<b>Shqip</b>	<b>Greqisht</b>
pikë (gjeom.)	το σημείο (gjeom.)
↓	↓
pikë prerjeje - pikë ndërprerjeje -	σημείο τομής - σημείο διακοπής -
pikë rakordimi	σημείο συμφιλίωσης
↓	↓
pikë (usht.)	το σημείο (usht.)
↓	↓
pikë zjarri - pikë vrojtimi	σημείο πυρκαγιάς - σημείο παρατήρησης
pikë kontrolli	σημείο ελέγχου
↓	↓
pikë (fiz.)	το σημείο (fiz.)
↓	↓
pikë ngrirjeje - pikë shkrirjeje	σημείο πήξης - σημείο τήξης
pikë vlimi;	σημείο βρασμού;
↓	↓
pikë etj.	το σημείο...

Pra, kemi:

pikë: pikë (fjalë) - pikë (term njëfjalësh) - pikë shkrirje (term togfjalësh), sikurse në greqishte: η σταγόνα (fjalë) - το σημείο (term njëfjalësh) - σημείο πήξης (term togfjalësh).

Si përfundim mund të theksohet se ballafaqimi i shqipes me një gjuhë të huaj në rastin tonë me greqishten, anasjelltas ushqen, nxit, si dhe çon përpëra studimin shkencor të këtyre gjuhëve në drithën e njëra-tjetrës, duke nxjerrë në pah tiparet e përbashkëta e veçoritë dalluese të njëra-tjetrës, në rrafshin e formës dhe të përbajtjes, çka shërben

10 Xh. Lloshi, *Rreth disa shfaqjeve të homonimisë në gjuhën shqipe*, në: "Studime për leksikun...", I, Tiranë, 1972.

në mënyrë të veçantë në punën për hartimin e fjalorëve dygjuhësh e shumëgjuhësh, joterminologjikë dhe terminologjikë, në procesin e mësimdhënies së gjuhës së huaj në shkollë, në hartimin e teksteve mësimore etj.

## BIBLIOGRAFIÁ

- Duro A.,2009, «Termi dhe fjala në gjuhën shqipe», Tiranë.
- Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë, 1980.
- Gjini N.,1993,»Fjalor greqisht - shqip», Janinë.
- Gjini N.,1998, «Fjalor shqip-greqisht», Janinë.
- Hornby A., 1959, 1961, 1962,*The Teaching of Structural Works and Sentences Patterns*, stage I, II, III, L.
- Kostallari A., 1984, “*Gjuha letrare Kombëtare shqipe dhe epoka jone*”, Sf., Nr.4, f.42.
- Kurti S., 1991,”*Fjalor politeknik anglisht -shqip*”, Tiranë, 1991.
- Kurti S., 1981, “*Fjalor politeknik rusisht - shqip*”, Tiranë.
- Lafe E., Çepani A., 2004, «*Rreth pasqyrimit të fushave terminologjike në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe»* në Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektive», Tiranë.
- Lloshi Xh.,1972, “*Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe*”, në “*Studime mbi leksikun...*”, Tiranë.
- Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik* në «*Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*», «*Studime filologjike*», 1986/2.

## MËSIMDHËNIA E FJALORIT TË GJUHËS SË RE GREKE SI GJUHË E HUAJ

**Dr. Isida Metaj (Foçi)**

Departamenti i Gjuhës Greke

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

E-mail: isida.metaj@unitir.edu.al

**Ma. Edlira Jorgaqi**

Departamenti i Gjuhës Greke

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

E-mail: edlira.jorgaqi@unitir.edu.al

### PËRMBLEDHJE

Në këtë kumtesë do të analizojmë mësimdhënien e fjalorit të gjuhës së dytë tek studentët e ciklit të parë. Fillimisht paraqiten qasjet kryesore teorike, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e fjalorit. Në vazhdim referohen dy procedurat bazë në lidhje me mësimdhënien e fjalorit dhe propozohen teknika praktike, të cilat njehsohen dhe aplikohen me qëllim mësimdhënien e fjalorit të gjuhës së dytë. Në përfundim, në këtë punim përshkruhet kuadri i mësimdhënies së fjalorit të gjuhës së dytë gjatë leximit të historive në klasë dhe propozohen praktika leximi, të cilat kontribuojnë në mënyrë efikase në shpjegimin e fjalëve të panjohura dhe si rrjedhojë zhvillimin e fjalorit të gjuhës së dytë. Fjalë **çelës**: fjalor, mësimdhënie e drejtpërdrejtë, mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë, strategji përvetësimi.

### ABSTRACT

In this paper we will analyze the teaching of second language vocabulary to undergraduate students. First, the main theoretical approaches to vocabulary development are presented. The following are two basic procedures related to vocabulary teaching and practical techniques are proposed, which are calculated and applied in order to teach a second language vocabulary. In conclusion, this paper describes the teaching framework of a second language vocabulary while reading stories in the classroom and proposes reading practices that contribute effectively to the explanation of unfamiliar words and consequently the development of a second language vocabulary.

Keywords: direct teaching, indirect teaching, learning strategies, vocabulary.

Si nxënës të gjuhëve të huaja të gjithë mund të kemi vënë re se shumë fjalë që na kanë mësuar mund të mos i kujtojmë, por të kujtojmë shumë më tepër fjalë nga ato që u kemi mësuar të tjerëve. Nga ky konstatim rezulton se nga njëra anë mësimdhënia e drejtpërdrejtë e fjalorit nuk është gjithmonë rezultative dhe nga ana tjetër rezulton se nuk është e vetmja mënyrë për të mësuar fjalorin. Por cilat janë mënyrat me të cilat mësojmë fjalët? Në cilat raste i përdorim? Si mund të bëhen më rezultative?

Në përgjithësi ka dy mënyra të qasjes së fjalorit: **e drejtpërdrejtë** dhe **jo e drejtpërdrejtë**. E para ka të bëjë me mësimdhënien e qëllimshme (Nation 2001:120,232-3), Schmitt 2000: 116, 146-149) gjatë të cilës vëmendja jonë përqendrohet tek gjuha dhe synojmë të mësuarit e fjalëve, ndërsa e dyta ka të bëjë me të mësuarin jo të qëllimshëm (Nation 2001:120, 232-3, Schmitt 2000:116), d.m.th. të mësuarit e fjalëve gjatë të kuptuarit të gjuhës së shkruar e të folur, teksa interesi dhe vëmendja jonë fokusohen tek mesazhi që përcillet dhe jo tek gjuha. Kjo është mënyra me të cilën përvetësojmë jo vetëm fjalorin, por edhe gjuhën si folës natyral të saj.

Sipas Nation (2001:232), një program i mirëorganizuar për mësimdhënien e gjuhës së huaj do të duhet të kombinojë si mësimdhënien e qëllimshme të fjalorit, ashtu edhe veprimitaritë që do të sigurojnë të mësuarit e paqëllimshëm të tij, pasi secila nga dy mënyrat mund të mbulojë nevoja të ndryshme. Për fillestarët është e domosdoshme të përdoret mësimdhënia e qëllimshme e fjalorit deri sa të kenë përvetësuar një fjalor bazë që do t'i lejojë të kuptojnë fjalët e panjohura që do të hasin në tekste. Gjithashtu, mësimdhënia e qëllimshme na ndihmon dhe kur duam të japid një fjalor specifik me një tematikë të caktuar. Pra, mësimdhënia e qëllimshme rekandomitet për të mësuarit e një fjalori të caktuar me numër të përcaktuar fjalësh në një periudhë të shkurtër kohore.

Por nga ana tjetër, mësimdhënia jo e qëllimshme është njësoj e domosdoshme në një program mësimi të një gjuhe të huaj, sepse përmirëson cilësinë e leksikut, por kërkon një periudhë më të gjatë kohore dhe kontakt më të madh me tekste të ligjëratës së shkruar e të folur, si dhe zhvillimin e strategjive për të cilat do të flasim në vijim. Ndaj, të dyja qasjet janë të domosdoshme për mësimin e fjalorit dhe nuk përashtojnë, por plotësojnë përdorimin e njëra tjetrës.

Le të vazhdojmë të shpjegojmë në mënyrë më të hollësishme të dyja këto qasje.

Një nga pyetjet e shumta që duhet t'i përgjigjemi kur për mësimin e një gjuhe të huaj zgjedhim mësimdhënien e qëllimshme të fjalorit është “Si do ta shpjegojmë kuptimin e fjalëve?”. Teknikat e përdorura i ndajmë në dy kategori (Nation 1990:51 me ndryshime):

1. Teknika me anë të të cilave tregojmë ç'do të thotë fjala me përdorimin e elementeve jashtë gjuhësorë si: objekte, figura, fotografji, skica, diagrame, gjeste dhe mimikë.
2. Teknika me anë të të cilave shpjegojmë me fjalë në gjuhën amtare të nxënësve apo në një gjuhë tjetër që njohim se çfarë do të thotë fjala ose shpjegojmë me

fjalë në gjuhën që synojmë të mësojmë duke dhënë një përkufizim analistik, duke përdorur fjalë sinonime, duke e përdorur fjalën brenda një fjalie për të zbuluar kështu kuptimin e saj.

Por këto teknika kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Avantazh është se objektet reale, figurat, diagramat, gjestet konsiderohen si mënyra më e vlefshme për të shpjeguar kuptimin e një fjalë. Nxënësit shohin zbatimin e kuptimit dhe kjo përforcon mundësitetë përtakta mbajtur mend. Por ka dhe disa disavantazhe pasi jo të gjitha fjalët mund të shpjegojen me objekte. P.sh nuk mund të shpjegojmë lehtësisht nocionet abstrakte si: ideologji, nocion, përshtypje, informoj, fatmirësish etj. Gjithashtu duke qenë se ky shpjegim bëhet me një mënyrë jo të drejtpërdrejtë, mundësia e keqkuptimit të nocionit përbën rrezik.

Ndaj, kjo teknikë është e përshtatshme për disa kuptime konkrete fjalësh dhe mund të bëhet më rezultative nëse kombinohet me ndonjë përkufizim të fjalës, që të arrijmë atë që quhet kodim i dyfishtë, d.m.th. magazinim në kujtesë optik dhe gjuhësor njëkohësisht.

Teknika tjetër ka të bëjë me shpjegimin e fjalës në gjuhën amtare të nxënësve ose në gjuhën e synuar. Përkthimi në gjuhën amtare ndoshta është metoda më e shpejtë, më e thjeshtë dhe më e lehtë për të kuptuar nxënësit fjalën, por dhe kjo ka disavantazhet e veta: supozon se të gjithë nxënësit kanë të njëjtën gjuhë amtare dhe që mësuesi duhet ta njoftë atë, gjë që nuk ndodh gjithmonë, është mënyrë jo e drejtpërdrejtë dhe i largon nxënësit nga gjuha e synuar, nxit përdorimin e gjuhës amtare dhe ul kohën në dispozicion për gjuhën e synuar, përforcon idenë se ka lidhje respektive tek fjalët e gjuhës amtare dhe asaj të synuar dhe mund të shpjerë në transmetim negativ të elementeve gjuhësorë. Ndërsa shpjegimi në gjuhën e synuar disavantazhet e sipërpërmendura i ka avantazhe. Është mënyrë e drejtpërdrejtë, na lejon të vlerësojmë gjuhën e synuar, por presupozon që nxënësit është një fjalor elementar për të kuptuar përkufizimin dhe mësuesi duhet të ketë aftësinë të jepë një përkufizim të mirë. Ka disa mënyra për të shpjeguar kuptimin e një fjalë në gjuhën e synuar. Sipas Richards & Taylor (1992), siç edhe referohen në Nation (2001:90) më kryesoret janë:

Sinonim:	«όμορφος» do të thotë «ωραίος»
Antonim (e kundërta):	«νέος» do të thotë «όχι γέρος»
Përkufizim takstativ:	«vjeshta» është një stinë ....
Përkufizim me shembuj:	«mobilie» quhen kolltuku, karrigia etj
Përkufizim funksional:	«lapsin» e përdorim për të shkruar
Përkufizim gramatikor:	«më i keq» shkalla krahasore e I keq
Përkufizim kategorik:	«familje» një grup njerëzish

Për të ndihmuar nxënësit që të kuptojnë fjalët duhet të kenë parasysh (Nation 2001:90-2):

- Duhet të japim shpjegime sa më të qarta, sa më të shkurtra dhe sa më të thjeshta. Përkuqizimet e gjata dhe të ndërlikuara do t'i ngatërrojnë më shumë. Është e rëndësishme të vëmë bazat e duhura për njohjen e leksikut duke e filluar procesin, që për hir të së vërtetësës është gradual, me një mënyrë të qartë.
- Është shumë e rëndësishme që në rastin e fjalëve polisemike, të fokusojmë vëmendjen e nxënësve tek kuptimi ekzistues, nga i cili mund të nxjerrin dhe kuptimet e tjera.
- Të térheqim vëmendjen e nxënësve tek fjalët që I kanë hasur dhe më parë.
- Të ndihmojmë nxënësit të zhvillojnë aftësinë për të njohur dhe kuptuar përkufizimet e fjalëve brenda në tekst.
- Duke pasur parasysh se të kuptuarit e një fjale jo domosdoshmërisht nënkupton dhe të mësuarin e saj, duhet t'i ndihmojmë nxënësit për ta memorizuar atë. Mënyra me të cilën shpjegojmë një fjale mund të ndikojë jo vetëm për ta kuptuar, por edhe për ta mbajtur mend atë.
- Të shmangim ngatërrimin me fjalë të tjera të ngjashme. Mësimdhënia e disa fjalëve, kryesisht sinonime dhe antonime, por edhe të fjalëve që i përkasin të njëjtës fushë leksikore si p.sh., pjesët e trupit, frutat etj., mund të ngatërhoen, kryesisht në nivel fillestarësh. Ndaj propozohet të mësohet fillimisht kuptimi i një fjale dhe në një fazë të mëvonshme antonimi apo sinonimi i saj.

### Si do t'i trajtojmë fjalët?

- Fjalët e panjohura ishmangim ose i zëvendësojmë me fjalë të njohura para se tekstin t'ua japim nxënësve ose nuk i shpjegojmë e nuk u dedikojmë kohë. Fjalë që nuk kanë shumë përdorim dhe që nuk janë të nevojshme për nxënësit dhe nuk janë të rëndësishme për kuptimin e tekstit, mund të hiqen apo të zëvendësohen.
- Shpjegojmë shpejt kuptimin ose japim shpjegime përfjalët e panjohura në fund të tekstit. Me anë të shpjegimeve nxënësit mund ta vazhdojnë leximin pa e ndërprerë dhe pa humbur shumë kohë.
- Fjalët e panjohura mund t'i fusim në një fjalorth. Zakonisht kjo ndodh me fjalë që kanë përdorim të shpeshtë, por nuk duam t'u kushtojmë shumë kohë.
- Mund t'ua mësojmë fjalët që më parë. Kjo mund të ndodhë përfak fjalë, në rast të kundërt mund të mos arrihet rezultati i synuar.
- I ndihmojmë nxënësit të gjejnë kuptimin e fjalëve duke u nisur nga konteksti apo me ndihmën e një fjalori.

- 
- I kushtojmë kohë të mësuarit të kuptimit të fjalëve, duke i përforcuar me ushtrime lidhur me to.

Mësimdhënia jo e drejtpërdrejtë, në antitezë me mësimdhënien e drejtpërdrejtë ka të bëjë me përvetësimin e leksikut nëpërmjet teksteve të ligjërata së folur dhe të shkruar. Ndërkaq qëllimi dhe interesi jonë nuk është thjesht të mësojmë fjalë, por të komunikojmë. Kjo mënyrë e të mësuarit realizohet nën disa kushte të caktuara dhe ndikohet nga disa faktorë që rrisin apo ulin mundësitë që nxënësit të kenë një logjikë të drejtë leksikore dhe si përfundim të mësojnë fjalën (Jenkins & Dixon (1983), Schmitt (2000:153) dhe Nation (2001:243-4)).

### Raporti fjalë të njohura / fjalë të panjohura

Është përllogaritur (Liu & Nation 1985) se që të kenë mundësi nxënësit për të vlerësuar treguesit e tekstit, domethënë të dhënat rr Ethanore dhe gjuhësore, në të cilat bazojmë përfundimet leksikore, (p.sh, një apo më shumë fjalë në të njëjtën fjalë me fjalën e synuar apo në ndonjë fjalë tjetër në tekst, elemente fonologjikë, morfologjikë të fjalës, të cilët nxënësi mund t'i lidhë me njohurinë përkatëse që ka në gjuhën e synuar, atë amtare apo në ndonjë gjuhë tjetër), duhet që 95 % e fjalëve që janë në tekst, të jenë të njohura, domethënë nxënësit të hasin 1 fjalë të panjohur në çdo 20 fjalë të njohura.

Se sa ndihmues është një tekst, varet nga prezenca e disa treguesve, numri i tyre, afërsia me fjalën e synuar dhe se sa të qarta janë. Tekstet udhëzuese përbajnjë mjaft tregues të qartë dhe sigurisht që mund të vlerësohen. Është parë se nxënësit mund të përdorin më lehtë tregues që ndodhen më afér fjalës së synuar se sa tregues të përgjithshëm dhe më të largët (Haastrup 1991, Huckin & Bloch 1993, Fraser 1999).

Njohja që ka për botën mund të luajë rol të rëndësishëm në përfundimet leksike. Nxënësit që tashmë kanë një skenar apo skemë të lidhur me temën, mund ta përdorin për të kuptuar tekstin në përgjithësi dhe në veçanti fjalët e panjohura në të.

Njohja e mëparshme e kuptimit të fjalës së synuar, ndihmon në të kuptuarit e tekstit të dhënë. Por nëse nxënësi njeh një kuptim tjetër të fjalës, me shumë mundësi do të mbetet aty dhe nuk do të përpiqet të marrë vesh kuptimin e saj në këtë tekst. Por jo të gjithë nxënësit kanë aftësinë për të vlerësuar treguesit dhe të përdorin strategjinë e rezultateve leksikore. Sigurisht, ata që e kanë, mund të zbërthejnë një numër të madh fjalësh, na lejon të supozojmë se dhe nxënës të tjerë me arsimin e duhur, nëse përftojnë apo përmirësojnë këtë strategji, do të mund të kenë rezultatet e duhura. Sa më të rëndësishme ta konsiderojë fjalën nxënësi, aq më shumë do të përpinqet për ta kuptuar. Sa më shpesh shfaqet një fjalë, aq më shumë mundësi ka nxënësi për ta kuptuar dhe për ta mësuar.

Këtu duhet bërë një dallim midis të kuptuarit të kuptimit dhe përvetësimit. Të kuptuarit e kuptimit të një fjalë nuk siguron përvetësimin e saj, pavarësisht se është kusht

për të. Në bazë të studimeve, është konstatuar një paradoks se sa më lehtë të arrijmë të gjejmë kuptimin e një fjale, aq më pak mundësi ka që ta ruajmë në kujtesë (Mondria & Wit-de-Boer 1991). Kjo shpjegohet me bazë teorinë e përpunimit të thellë, sipas së cilës të mësuarit varet mjafthueshmë nga përpjekja mendore dhe thellësia e përpunimit të informacionit. Pra, nëse është shumë e lehtë për ta kuptuar një fjale, atëherë do të konkludojmë në kuptimin e saj shpejt dhe me shumë mundësi me shumë pak përpjekje. Ky përpunim sipërfaqësor mund të mos sigurojë ngulitjen e saj në mendje. Veç kësaj, nëse teksti është shumë i pasur me tregues, atëherë mund ta kuptojmë duke e anashkaluar fjalën e panjohur. Por, sidoqoftë për të mësuar një fjale nuk mjaftron ta hasim dhe ta kuptojmë vetëm një herë. Siç edhe është përllogaritur, duhet të haset 5-16 herë (Nation 1990:43-4). Nuk është e rastësishme se shumica e studimeve tregojnë përqindje të ulët të rezultateve të suksesshme dhe për rrjedhojë dhe të mësuarit të fjalëve.

Nga sa u tha më lart, lind pyetja: A është të mësuarit jo të drejtpërdrejtë, mënyrë produktive e të mësuarit të një gjuhe të huaj?

Të mësuarit jo të drejtpërdrejtë nuk duhet parë si një mënyrë e mëvetësuar e të mësuarit, por si një kombinim me të mësuarin e drejtpërdrejtë. Përfitimet që sjell të mësuarit jo të drejtpërdrejtë janë:

- Përfitimi i vogël mund të bëhet i madh, nëse tekstet që lexojnë nxënësit janë shumë. Është përllogaritur (Nagy 1997) se nëse do të lexonin një milion fjalë në tekst në vit dhe nëse 2% e tyre janë të panjohura, numri do të shkonte në 20.000 fjalë në vit. Dhe nëse do të mësonin 1 në 20, shuma vjetore do të ishte 1000 fjalë. Një milion fjalë janë afersisht 10-12 romane.
- Me leximin e teksteve nuk mësojmë vetëm fjalë të reja, por edhe pasurojmë dijen leksikore të fjalëve tashmë të njobura. Për më tepër, përmirësojmë njoburitë gramatikore, familjarizohemi me strukturën e tekstit, përmirësojmë aftësinë në të lexuar, mësojmë informacione të reja.

### **Strategjité e përvetësimit të fjalorit**

Diçka shumë e rëndësishme që mund t'i ndihmojë nxënësit në përvetësimin e fjalorit të gjuhës së huaj është zhvillimi i strategjive. Studimi lidhur me strategjítë i ka fillesat në vitet '70 paralelisht me tendencën për kalim nga mësimdhënia me qendër mësuesin tek mësimdhënia me qendër nxënësin. Përfitimi më i madh i strategjive për nxënësit është se i ndihmojnë të bëhen të pavarur dhe të vazhdojnë të mësojnë dhe jashtë klasës përgjatë gjithë jetës.

## Klasifikimi i strategjive për përvetësimin e fjalarit

Schmitt (1997) dallon dy kategori të mëdha:

- 1) Strategjitetë për gjetjen e kuptimit të një fjale
- 2) Strategjitetë e konsolidimit të kuptimit

1) Strategjitetë e gjetjes së kuptimit të fjalës janë determinative kur i përdorim për të zbuluar kuptimin e një fjale të panjohur pa iu drejtar dikujt tjetër. Mund të na ndihmojë për gjetjen e kuptimit njohja e kategorive gramatikore, analiza e pjesëve përbërëse të fjalës, vlerësimi i figurave në ligjëratën e shkruar dhe i gjesteve apo theksimit në ligjëratën e folur, vlerësimi i kontekstit, përdorimi i fjalarëve njëgjuhësh ose dygjuhësh, listat e fjalëve.

Strategjitetë mund të janë sociale kur i përdorim për të zbuluar kuptimin e një fjale duke iu drejtar dikujt tjetër, mësuesit, një shoku klase apo një folësi natyral të gjuhës për të na dhënë përkthimin e fjalës, një sinonim, një përkufizim apo një fjali me këtë fjalë.

2) Strategjitetë e konsolidimit i përdorim për të ruajtur në kujtesë kuptimin e një fjale. Këto dallohen në: sociale, të memories, kognitive dhe metakognitive.

Studime të mëpasshme (Fraser 1999, Huckin & Bloch 1993) kanë vënë në dyshim propozimin e Clarke & Nation (1980) për vonesë të strategjisë leksiko – qendrore që ka të bëjë me analizën e fjalës sipas përbërësve të saj, pasi analiza morfollogjike e fjalës është një proces i drejtpërdrejtë dhe automatik që realizohet gjatë njohjes së fjalës. Për rrjedhojë, vonesa nuk është efikase, por ajo që mund të bëjmë është të fokusohemi në rrezikun që ekziston që nxënësit t'i drejtohen një përfundimi të gabuar, nëse bazohen vetëm në analizën e fjalës sipas përbërësve të saj dhe t'i ushtrojmë të kontrollojnë dhe të përpunojnë përfundimet e startegjisë në fjalë nëpërmjet vlerësimit të konsistencës së drejtpërdrejtë.

Në këtë eksperiment rezultatet treguan se pavarësisht se mësimdhënia e strategjive nuk ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e njohurive leksikore, kishte ndikim jo të drejtpërdrejtë pasi nga njëra anë uli numrin e fjalëve që nxënësit shmangnin të kuptonin dhe nga ana tjetër përmirësoi cilësinë e përfundimeve.

## BIBLIOGRAFÍA

- Bower, G. H & Clark, M. C. (1969), "Narrative stories as mediators for social learning. *Psychonomic Science*, 14(4), 181-2.
- Clarke, D. F. & Nation, I. S. P. (1980), "Guessing the meanings of words from context: strategy and techniques", *System* 8, 211-220.
- Haastrup, K. (1991), Lexical Inferencing Procedures or Talking about words.
- Nagy, W. (1997), *On the role of context in first and second language vocabulary learning* in Schmitt, N & McCarthy, M. *Vocabulary: Description, Acquistion and Pedagogy*, Cambridge: C.U.P.
- Nation, I.S.P. (1990), *Teaching and Learning Vocabulary*, Massachusetts: Newbury House.
- Nation, I.S.P. (2001), *Learning Vocabulary in Another Language*, Cambridge: C.U.P.
- Schmitt, N. (1997), *Vocabulary Learning Strategies* in Schmitt, N. & McCarthy, M. *Vocabulary: Description, Acquistion and Pedagogy*, Cambridge: C.U.P.
- Schmitt, N. (2000), *Vocabulary in Learning Teachnig*, Cambridge: C.U.P.

**SPROVË PËR KRAHASIM MES “CIKLIT TË KRESHNIKËVE” DHE  
EPOSIT SPANJOLL “KËNGA E MIO SIDIT” NË KUADËR TË HAPËSIRËS  
EVROPIANE**

**Dr. Drita Isufaj**

Departamenti i Letërsisë

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

E-mail: dritaisufaj@yahoo.com

**PËRMBLEDHJE**

Ngjashmëritë ndërmjet eposeve që u përkasin vendeve të ndryshme europiane zakonisht vijnë si rezultat i kontaktave të drejtpërdrejta hapsinore. Kontaktet e shkëmbimet e drejtpërdrejta në më të shumtën e rasteve ndodhin natyrshëm midis kulturash fqinje, por qëllimi i këtij studimi do të jetë përqasja e eposeve mesjetarë të dy popujve që kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet tyre, në periudhën kur këto krijime epike zunë fill, i kanë pasur relativisht të pakta. Kjo përqasje do të bëhet duke vënë përballë njëri-tjetrit eposin spanjoll *Kënga e Mio Sidit* dhe *Ciklin e Kreshnikëve*.

Në punim, synohet që të kryhet një krahasim duke u rrekur të prekim sa më shumë aspekte të dy eposeve, si dhe duke argumentuar mbi arsyet e ngjashmërive dhe ndryshimeve midis tyre. Krahasimi i këtyre dy krijimeve folklorike, njëri evropiano-perëndimor dhe tjetri ballkanas, do të përcillet përmes pranëvënieς së dy kulturave, dy psikologjive, dy realiteteve mesjetare të këtyre rajoneve të Evropës, por njëkohësisht edhe duke pasur parasysh karakteristikat e eposit si lloj i epikës në vargje. Pra, do të kemi të bëjmë me një krahasim kryesish tipologjik.

Fjalë çelës: Cikli i Kreshnikëve, epikë, europian, krahasim, Mio Sid.

**ABSTRACT**

The similarities between the epics belonging to different European countries usually come as a result of direct spatial contacts. Direct contacts and exchanges in most cases occur naturally between neighboring cultures, but the purpose of this study will be to approach the medieval epics of the two peoples that have had relatively few direct contacts between them, in the period when these epic creations began. This approach will be made by juxtaposing the Spanish epic *The Song of Mio Cid* and the Albanian *Epic of Kreshnik*.

In this paper, it is intended to make a comparison by trying to touch as much as possible aspects of the two epics, as well as arguing on the reasons for the similarities and differences between them. The approach of these two folk creations, one Western European and the other Balkan, will be conveyed through the comparison of two cultures, two psychologies, two medieval realities of these regions of Europe, but at the same time considering the characteristics of the epic as a literary genre. So we are going to be dealing with a mostly typological comparison.

Keywords: comparison, epics, europian, Kreshnik Epic, Mio Cid.

Ngashmëritë ndërmjet eposeve që u përkasin vendeve të ndryshme europiane zakonisht vijnë si rezultat i kontaktave të drejtpërdrejta hapësinore. Kontaktet e shkëmbimet e drejtpërdrejta në më të shumtën e rasteve ndodhin natyrshëm midis kulturash fqinje, por qëllimi i këtij studimi do të jetë përqasja e eposeve mesjetarë të dy popujve që kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet tyre, në periudhën kur këto krijime epike zunë fill, i kanë pasur relativisht të pakta. Kjo përqasje do të bëhet duke vënë përballë njëri-tjetrit eposin spanjoll *Kënga e Mio Sidot* dhe *Ciklin e Kreshnikëve*.

Në punim, synohet që të kryhet një krahasim duke u rrekur të prekim sa më shumë aspekte të dy eposeve, si dhe duke argumentuar mbi arsyet e ngashmërive dhe ndryshimeve midis tyre. Krahasimi i këtyre dy krijimeve folklorike, njëri europiano-perëndimor dhe tjetri ballkanas, do të përcillet përmes pranëvënieve së dy kulturave, dy psikologjive, dy realiteteve mesjetare të këtyre rajoneve të Evropës, por njëkohësisht edhe duke pasur parasysh karakteristikat e eposit si lloji i epikës në vargje. Pra, do të kemi të bëjmë me një krahasim kryesisht tipologjik.

### Marrëdhëniet feudale në dy eposet

Eposi spanjoll *Kënga e Sidot* sjell një shprehje të gjallë të zhvillimit të marrëdhënieve feudale në Spanjë në periudhën e sundimit të mbretit Alfons VI. Sipas Gustavo Correa-s, marrëdhënia mbret-vasal te kjo poemë është e lidhur me temën e nderit dhe është pikërisht kjo temë që i jep qëndrueshmëri strukturës artistike të poemës.<sup>1</sup>

Nëse vëzhojmë vargjet e para të poemës, vërejmë se nderi i Sidot, është i lidhur me pasurinë materiale të dhënë nga mbreti. Me t'u internuar, Sidi humbet pasurinë dhe pendohet thellë për këtë humbje:

De los sus ojos tan fuerte mientras llorando,  
Tornaba la cabeza y estabalo catando,  
Vio puertas abiertas y uzos sin cañados,  
Alcándaras vazías sin pieles y sin mantos  
Y sin falcones y sin adtores mudados.<sup>2</sup>

Në heshtje tekxa qante hidhërueshëm,  
Ktheu kokën e po vështronate.  
Pa dyer të hapura, që lëkundeshin pa brava,  
varëse rrobas bosh, pa mantelë a pelerina,  
Asnjë skifter a fajkua nuk vinte rrotull

1 Correa, Gustavo. “El Tema de la Honra en *El Poema del Cid*.” *Hispanic Review* XX, 1952: f. 185-199

2 Riaño Rodríguez, Timoteo & del Carmen Gutiérrez Aja, María. *El Cantar de Mío Cid (el manuscrito del cantar)*, Biblioteca virtual ‘Miguel de Cervantes’, pdf, f.13

Marrëdhënia mbret-vasal është e pranishme në të gjithë poemën dhe lidhet me konceptin mesjetar të nderit, mbreti është ai që i jep nderin vasalit. Një nder i tillë dëshmohet prej të mirave materiale dhe respektit shoqëror. Humbja e nderit nxit bëmat e Sudit, ndërsa besnikëria dhe nënshtrimi i tij ndaj mbretit e vënë atë në vend. Prandaj, nderi shërben si një lidhje midis mbretit dhe vasalit, falë tij Sidi ngrihet në kategorinë e heroit. Sidi është modeli shembullor i vasalitetit sepse ai arrin të rivendosë harmoni në marrëdhëni e tij me mbretin, si dhe të përfitojë mirënjojhe dhe favore që vijnë si rezultat i kësaj marrëdhënieje, ndërsa pushteti i mbretit rritet në territorë dhe pasuri falë heroizmit të vasalit të tij besnik. Sidi, duke qenë një vasal i mirë, gjithashtu bëhet “zot” i çetës së tij, kësisoj në poemë ilustrohet ideja se rruga e ngritjes shoqërore lidhet me nënshtrimin ndaj mbretit, pasi vetëm pranë tij rriten si nderi material, ashtu edhe ai moral.

Në *Ciklin e Kreshnikëve* vërejmë se kemi një shfaqje krejt të ndryshme të marrëdhënieve feudale. *Cikli* flet për luftëra kundër sillavëve. Heronjtë e eposit tonë janë në një konflikt të vazhdueshëm me krajlat feudalë, madje mund të themi se krejt *Cikli i Kreshnikëve* përshkohet nga ky konflikt. Pothuajse në çdo këngë të *Ciklit të Kreshnikëve* kemi nga një duel, i cili në epos quhet “mejdan” ose “bejleg”, midis një kreshniku dhe një sillavi ose siç quhet ndryshe në rapsoditë tona “shkiu”, pra kemi si të thuash, një protagonist i cili është “kreshniku” dhe një antagonist që është “shkiu”.

Personazhet e eposit tonë nuk janë vasalë siç ndodh tek *“Kënga e Sudit”*. Muji dhe Halili ishin me të vërtetë prijësa mesjetarë shqiptarë, por ata na paraqiten më tepër si “cuba”, ose e thënë në një shkallë më të lartë si “harambashë” (turq.-kryetar hajdutësh), që kryejnë plaçkitje e rrëmbime vashash.

Tek *“Kënga Cidit”*, luftohet për mbretin, por në luftën për mbretin përcillet gjithashtu dhe ideja e luftës për rritjen e madhështisë së Spanjës. Ndërsa në *Eposin e kreshnikëve*, ideja e atdheut është disi fluide. Tek kreshnikët nuk ekziston një vetëdije atdheu, por është sunduese vetëdija e bashkësisë, ndjenja e dallimit të “të vetëve” prej “të tjerëve”, kuptimi i të qenit ndryshe nga bota e madhe; aty kemi kultin e vendlindjes, të malit, të dheut, të bjeshkës, kultin e atij që konvencionalisht do ta quanim “atdhe shpirtëror”.

Konteksti, qëllimi final i këtyre dyluftimeve duket se është lufta për mbrojtjen e kufijve të trojeve shqiptare, për mbrojtjen e fisit, lufta për mbrojtjen dhe ruajtjen e kanunit dhe zakoneve që i lidhin njerëzit e maleve midis tyre dhe bëjnë që ata të mos humbasin identitetin.

## Roli i personazheve femërore

Figurat e femrave janë gjithmonë të pranishme në eposet e popujve të ndryshëm. Ato zakonisht luajnë një rol të rëndësishëm në këto epose; janë ato që i japin dinamizëm subjektit të tyre. (p.sh. *Helena e Trojës* në eposin homerik, *Brynhilda* dhe *Ziglinda* tek eposi gjerman i Nibelungëve, etj).

Edhe në *Eposin e Kreshnikëve* figurat femërore zënë një vend të veçantë. Femrat më të rëndësishme për kreshnikët janë: nëna, motra, dhe nusja. Rrëmbimi i grave të familjes është shumë i i rëndë për ta, sepse cenon nderin e tyre.

Në *Ciklin e Kreshnikëve*, nëna e Mujit dhe e Halilit nuk na del kurrë me emër, ndërsa femrat e tjera kanë emra, kjo ndoshta sepse nëna është një, e vetme dhe e pazëvendësueshme. Ajo është thjesht “nana” e trimave dhe nuk ka nevojë për një emër të përvëcëm. Emri i saj mund të jetë një emër çfarëdo, por ai nuk ka rëndësi. Duke e lënë si të thuash “anonyme” nënën e trimave, figura e saj është lartësuar.

Një figurë tjetër e rëndësishme femërore është gruaja e Mujit Ajkunë ose Kune, por ngandonjëherë në eposin e shkurtër shqiptar Ajkunë quhet edhe motra e kreshnikëve, pra e Mujit dhe e Halilit. Ajo është një femër e fortë dhe besnikë që i ndihmon kreshnikët.

Një e veçantë tjetër e *Ciklit të Kreshnikëve* janë të ashtuquajturat “vajza burrnesha”. Kemi një numër rapsodish në të cilat na paraqiten figura vajzash që janë trimëresha njëlloj si burrat, ato luftojnë nëpër bejlegë dhe mundin kundërshtarin. Këto vajza janë të gatshme të luftojnë deri në vdekje për të vënë në vend nderin, ato i presin kokën kundërshtarit pa ngurruar, njëlloj siç bëjnë edhe vetë kreshnikët. Heroinat e këtyre këngëve presin flokët tek berberi, vishen si burrat që të mos njihen nga kundërshtari dhe të trajtohen nga ai njëlloj si të ishin burra.

Tek eposi spanjoll *Kënga e Sidot*, personazhet kryesorë femra janë Himena, gruaja e Sidot, si dhe të bijat Elvira e Sol. Në poemë, si Jimena ashtu edhe vajzat, tregojnë dy anë të kundërtë të karakterit të tyre, ato herë shfaqen si gra të ndjeshme dhe emocionale e herë të tjera tregojnë forcë përballë fatkeqësive.

Një nga boshtet kryesore të poemës është humbja e autoritetit prindëror mbi vajzat, ndarja e familjes dhe përpjekjet e heroit për ta ribashkuar atë. Sidi e humb familjen për shkak të internimit dhe, që në çastet e para të largimit, ai dëshmon se të bijat kanë përparësi për të. Si baba ai dëshiron që në të ardhmen t'i shohë ato të martuara më së miri.

Sidi çnderohet për shkak të vajzave të tij, të cilat pësojnë një fyerje të rëndë nga trashëgimtarët Carrion me të cilët ai i marton në mirëbesim, por, në mërgim, janë vajzat dhe e shoqja ato që bëhen viktima si rezultat i internimit që pësoi Campeador-i (kupto kryeluftëtarë, Campeador përdoret si sinonim i Sidot).

Ndër personazhet femra, Jimena, gruaja e Sidot, është ajo e cila, duke qenë e rritur, mund të shprehë qartë dhimbjen e familjes, pasi është edhe më e vetëdijshmja për fatkeqësinë që pësojnë. Pas mërgimit të heroit, fabula merr një kthesë të papritur, pasi rolet ndryshojnë: ashtu si Sidi nuk është fajtor për mërgimin, por mërgimi i tij ndikon negativisht tek e shoqja, po ashtu as të bijat nuk meritojnë të vuajnë, por është për shkak të tyre që Campeador-i çnderohet rishtazi. Brenda një fabule të tillë, ku Jimena nuk është as viktimi dhe as nuk mund të kontribuojë në rikuperimin e nderit të humbur, personazhi i saj kalon në plan dytësor, derisa zhduket krejtësisht.

“Evoluimi i Sidot si personazh është i lidhur ngushtë me evoluimin e familjes së tij, dhe

veçanërisht me atë të të bijave. Nëse ndarja nga familja në mërgim dhe rimëkëmbja e saj tregon dy fazat e kundërtë të mërgimit, fillimi i tij dhe afërsia e faljes, fyerja që pësojnë të bijat çon në poshtërimin e Sudit, por njëkohësisht falë kësaj fyerje Sidi lidhet me shtëpitë mbretërore të Navarra-s dhe Aragoni-t. Prandaj, mund të themi se *Kënga e Sudit* është një poemë me veprim të dyfishtë, gjë që theksohet veçanërisht në rolin e femrave.<sup>3</sup> Të bijat e heroit kalojnë nga anonimia, në të pasurit e emrit të tyre, duke fituar protagonistin e merituar në pjesën e dytë dhe duke shënuar nga ana tjetër kalimin e tyre nga vajza në gra. Dhe në këtë pikë, ato mund të zëvendësojnë zonjën e madhe të poemës, nënën e tyre.

Në të dy eposet femrat e familjes janë protagonistë dhe vënë në lëvizje ngjarjet. Cenimi i tyre shënon humbjen e nderit të heronjve.

### **Mitologjia pagane e Eposit të Kreshnikëve dhe mitologjia kristiane e Këngës së Sudit**

Në çështjen e elementeve mitologjikë eposi spanjoll dhe eposi shqiptar kanë dallime thelbësore nga njëri-tjetri. Këto dallime kanë ardhur si rezultat i botëkuptimeve krejtësisht të ndryshme të dy popujve, atij spanjoll, si një popull perëndimor me një stad tjetër zhvillimi e qytetërimi në Mesjetë, dhe atij shqiptar, si një popull ballkanas që ende edhe sot ruan një botëkuptim arkaik.

Mitologjia e eposit shqiptar është një mitologji pagane. Figurat mitologjike në epos janë një trashëgimi e botës ilire. Në këtë grup bëjnë pjesë yjet dhe hëna që bëhen dorëzanë të heronjve kreshnikë: zanat dhe shtojzovallet, që u japid kreshnikëve fuqi mbinjerëzore; hyjnité mbrojtëse të bjeshkëve, pyjeve dhe fateve njerëzorë; vetë natyra me energjinë e saj çudibërëse.

Figurat qendrore të mitologjisë shqiptare janë zanat e malit. Me të drejtë rapsodia që paraqet takimin e parë të Mujit me zanat dhe marrjen e fuqisë prej tyre është cilësuar si kënga që hap artistikisht Ciklin e Kreshnikëve dhe mund të quhet rapsodia e shugurimit të këtij kreshniku si luftëtar bëmash të mëdha.

Mitet në eposin e kreshnikëve kanë karakter ktonik (tokësor) e matriarkal. Është e vështirë të gjenden në këngët e këtij cikli dëshmi perëndish qellore ose nëntokësore, po ashtu është e vështirë të gjesh hyjni patriarkale.

Duke u ndalur tek elementët mitologjikë të eposit spanjoll, vërejmë se aty është kapërcyer tërësisht fazat e mitologjisë pagane e antike. Për Evropën perëndimore mesjetare monotesite, mitologjia pagane ku njeriu besonte në qenie të mbinatyrrshme, konsiderohej si një fazë e zhvillimit të njerëzimit që tashmë ishte e largët.

3 Jovaní, Alfonso Boix. *Las mujeres del Cid: una respuesta a la variación onomástica de Elvira y Sol frente a la doble autoría del ‘Cantar de Mío Cid’*, e Humanista, vol 34, 2016, f. 385

Por poema *Kënga e Sidot*, është një epos dhe në epos mitologjia është gjithmonë e pranishme, pavarësisht nëse zë një vend te rëndësishëm ose jo dhe pavarësisht se e ç’lloji është. Në eposin spanjoll nuk kemi mitologji pagane si tek *Cikli i Kreshnikëve*, por kemi mitologji kristiane. Aty shfaqen figura të mitologjisë kristiane siç është për shembull Kryeengjëlli Gabriel. Sidot i shfaqet në èndërr kryeengjëlli në çaste vështira, ai e ngushëllon dhe gjithashtu profetizon se e gjithë rruga e tij do të jetë e suksesshme:

Allí se echaba mio Cid después de que cenó,  
le embargó un sueño dulce, muy bien se durmió;  
el ángel Gabriel en sueños le visitó:  
—¡Cabalgad, Cid, el buen Campeador,  
pues nunca en tan buen momento cabalgó varón!  
Mientras vivas, lo tuyo saldrá a la perfección.<sup>4</sup>

Aty ish shtrirë Sidi pas darke,  
një gjumë i ëmbël e kaploi e fjeti thellë;  
në èndërr engjëlli Gabriel iu shfaq:  
-Kalëroni, Sid, o kryeluftëtar i mirë,  
kurrë një burrë nuk ka kalëruar në një çast kaq fatlum!  
Për sa të jetoni, çdo gjë do t’ju shkojë mbarë.

Pra kemi të bëjmë me ndërmjetësinë e rëndësishme të Kryeengjëllit Gabriel si lajmëtar i Zotit.

Në poemën spanjolle kemi kultin e perëndisë sipas mitologjisë kristiane. Uniteti i Atit, i Birit dhe i Shpirtit të Shenjtë janë trinia që përbën “njëshin”, perëndinë e vërtetë. Natyrish, në ndryshim nga Cikli i Kreshnikëve, këtu flitet për perëndi qiellore, jotokësore, sepse i tillë konsiderohet Zoti në fetë monoteiste.

### **Tipet e heronjve epikë**

Sipas tipit të heronjve, eposet mund t’i ndajmë në epose me mite legjendare dhe në epose me mite historike. Nëse në tipin e parë të eposeve, shfaqet mendësia e heronjve jotokësorë, që vijnë të rregullojnë fatin e kësaj bote dhe të ndreqin padrejtësitë e saj, në tipin e dytë zotërojnë mitet historike, krijimi i heronjve të mbifujqishëm prej njeriut vdekatar, lartësimi i individit të zakonshëm .

Eposi shqiptar është një epos që qëndron midis dy tipeve të mësipërm. Kreshnikët janë trima me fuqi mbinjerëzore. Ata paraqiten me veti gjysmë-hyjnore, gjysmë- tokësore.

<sup>4</sup> Riaño Rodríguez, Timoteo & del Carmen Gutiérrez Aja, María. *El Cantar de Mío Cid (el manuscrito del cantar)*, Biblioteca virtual ‘Miguel de Cervantes’, pdf, f. 30

Heronjtë e eposit shqiptar, në thelbin e tyre ngjajnë më shumë me perënditë pagane të periudhës greko-romake, se sa me kalorësit trima të *Këngës së Sidot*. Fakti që eposi shqiptar qëndron midis dy tipeve të eposeve, flet për kohën e ndërmjetme të krijimit të tij, e cila duhet të gjendet midis antikitetit dhe Rilindjes Europiane.

Ndërsa eposi spanjoll është një epos i miteve historike. Sidi dhe heronjtë e tjerë të eposit francez janë të fuqishëm por jo të mbinatyrrshëm; fuqia e tyre qëndron në kufijtë e njerëzoresh. Tek ky epos kemi të bëjmë me mitizimin e njeriut të zakonshëm. Heronjtë dhe ngjarjet e eposit spanjoll janë me burim të drejtpërdrejtë historik.

### **Natyra e vargut në dy eposet**

Kur flitet për epote e për këngë epike një nga çështjet më të diskutuara ndërmjet studiuesve është natyra e vargut të tyre.

*Cikli i Kreshnikëve* është ndërtuar sipas sistemit tonik. Edhe poema *Kënga e Sidot* është ndërtuar mbi bazën e sistemit tonik të vargëzimit. Pikërisht këtu qëndron edhe një lidhje tjetër midis ciklit tonë dhe epopeve europiane, të cilat përgjithësisht janë ndërtuar mbi këtë sistem vargëzimi.

Vargjet e këngëve të Eposit të Kreshnikëve gjithashtu janë përgjithësisht pa rimë. Me gjasë mungesa e rimës është shenjë e vjetërsisë së tyre. *Kënga e Sidot* karakterizohet nga vargje që rimojnë përmes asonancës. Rima me asonancë lejon grupimin e vargjeve në strofa pak a shumë të gjata, që karakterizohen nga monorima. Këto strofa njihen me emrin “laisse” dhe janë tipike të eposeve kalorësiakë europiane. Rima është një fenomen i ri në epos që duhet të ketë ardhur si rezultat i ndikimit të poeziës së kultivuar mbi të.

Për sa i përket strukturës strofike të këngëve tona epike, po të dëgjosh melodinë që i shoqëron, vihet re se ajo i bashkon vargjet në grupe. Siç e shohim për të grupuar vargjet e Eposit të Kreshnikëve në strofa melodike na vijnë në ndihmë formulimet epike hyrëse (*Lum për ty, o i madhi Zot/ që s'jem kanë Zoti na ka dhanë!*), mbyllëse (*Qeshtu thanë, atje nuk jam kanë, /Mos me kanë, nuk kishin thanë!*), por edhe ato që quhen formulësime të ndërmjetme (sërirish me thirrje e lavde drejtuar Zotit).

Formulësime të përdora shpesh në epikën tonë janë edhe epititetet e vazhdueshme që u janë vënë heronjve, agallarëve të Jutbinës: Muji quhet Çetobasho Muji, Bylykbashe Muji; Baca Muji; Halili quhet Sokole Halili, Halil Aga i Ri; të tillë epitete janë kthyer ndonjëherë tek trimat në llagape: Ali Bajraktari, Zuku Bajraktar, Arnaut Osmani, Ganiqe Galani etj. Shumë dukuri apo objekte kanë epitetin e tyre të vazhdueshëm. Kështu hasim dendur: drita e bardhë, sabahi i bardhë, shpata e mejdanit, gjogu i bardhë, bjeshkët e nalta, etj.

Këto lloj formulësimet janë të shpeshta edhe tek *Kënga e Sidot*, kështu Sidi përmes epiteteve të vazhdueshme cilësohet si: *Campeador (Luftëtari)*, *Mjekra fisnike kaq e rritur, I linduri i mirë, Ai që ngjeshi shpatën në çastin e duhur, Ai që ka lindur me orë të mirë*.

Ndryshimi kryesor ndërmjet strukturave poetike të dy eposeve qëndron në atë që eposi spanjoll është organizuar me të njëjtën formë strofike si kur na jepet në formën e tekstit të shkruar ashtu edhe kur është i kënduar. Ndërkohë që këngët tona epike kur i studiojmë në formën e tyre të shkruar si tekst, na paraqiten në monokolonë, ndërsa kur i dëgjomë si këngë mund të bëjmë grupime në strofa melodike siç vërejtëm më sipër. Si laisse-t spanjolle, ashtu edhe grupimet tona melodike përbëhen nga një numër i ndryshueshëm vargjesh. Në të dy eposet ka mjaft raste të së ashtuquajturës *repetitio epica*; varje që janë shndërruar në formulësimë të vërteta.

Këngët e eposit tonë të kreshnikëve janë rapsodi të veçanta të cilat mund të qëndrojnë edhe më vete në formë epesh të shkurtra. Tek *Kënga e Sidot* kjo nuk mund të ndodhë. Ajo është një poemë epike, zhanër i cili imponon një subjekt klasik, ku fabula ka një fillim, një pikëlidhje, një pikë kulmore, dhe një zgjidhje.

## Përfundime

Duke iu referuar objektit tonë të studimit të këtyre çështjeve, pra përqasjes së *Eposit të Kreshnikëve* me eposin spanjoll *Kënga e Sidot*, është e rëndësishme të kemi parasysh se me gjithë ndryshimet që kanë të bëjnë me mënyra të ndryshme të perceptimit të botës dhe të marrëdhënieve njerëzore, eposi ynë dhe eposi spanjoll shfaqin shumë pikëtakime (diku më të largëta, diku më të afërta), pasi i përkasin të njëjtit lloj epik dhe mbi të gjitha janë pjesë e suazës së madhe të cikleve të vjetra paramesjetare e mesjetare të Europës.

## BIBLIOGRAFIA

- Burke, James F. *La lógica de la imagen animal en el Cantar de Mio Cid*, Biblioteca virtual ‘Miguel de Cervantes’, Edición digital a partir de Actas del X Congreso de la Asociación Internacional de Hispanistas, 1989
- Correa, Gustavo. “El Tema de la Honra en *El Poema del Cid*.” *Hispanic Review* XX, 1952
- García Larraín, Federico. *El honor en el poema de Mío Cid*, Revista de Humanidades, no. 30, 2014
- Isufaj, Drita. Paralele mes Ciklit të Kreshnikëve dhe eposit francez ‘*Kënga e Rolandit*’ si pjesë e suazës së cikleve mesjetare e paramesjetare të Evropës, Kultura popullore, nr. 1-2, 2010
- Jakllari, Adem. *Ligjérata për Etnologjinë dhe Mitologjinë*, Albas, 2015
- Jovani, Alfonso Boix. *Las mujeres del Cid: una respuesta a la variación onomástica de Elvira y Sol frente a la doble autoría del ‘Cantar de Mio Cid’*, eHumanista, vol 34, 2016
- Palaj, At Bernardin, Kurti, At Donat. *Visaret e Kombit I-XV* (i gjithë koleksioni), Arkivat digjitale, Shkodër
- Riaño Rodríguez, Timoteo & del Carmen Gutiérrez Aja, María. *El Cantar de Mío Cid (el manuscrito del cantar)*, Biblioteca virtual ‘Miguel de Cervantes’, pdf
- Sinani, Shaban. *Mitologji në Eposin e Kreshnikëve*, Naimi, 2015
- Zheji, Gjergj. *Folklor shqiptar*, Argeta LMG, 1998

## LA SITUACIÓN DE LOS EXÁMENES DELE EN ALBANIA

**Ma. Sandra Pula Gjoka**

Departamento de Lengua Española  
Facultad de Lenguas Extranjeras, Universidad de Tirana  
E-mail: sandra.gjoka@unitir.edu.al

### ABSTRACT

In Albania, DELE exams have been formally operating since 2002 and are the responsibility of the Instituto Cervantes in Rome. From its first call until today, almost every year the May call has been held, despite the fact that these exams are held several times a year worldwide. Since in Albania interest in the Spanish language is growing more and more, referring especially to the influence of Erasmus scholarships with the bilateral agreements between Albanian and Spanish universities, people need to certify their level of Spanish. Having information about the existence of this international diploma, those people who are interested are alerted until the next call. This presentation aims to analyze the situation of DELE exams in Albania.

Keywords: accreditation, Albania, call, DELE, examiner.

### RESUMEN

En Albania, los exámenes DELE han estado presentes oficialmente desde 2002 y están a cargo del Instituto Cervantes de Roma. Desde su primera convocatoria hasta hoy, casi todos los años se ha realizado la convocatoria de mayo, a pesar de que estos exámenes se realizan varias veces al año en todo el mundo. Dado que en Albania el interés por la lengua española está creciendo cada vez más, refiriéndose especialmente a la influencia de las becas Erasmus con los acuerdos bilaterales entre universidades albanesas y españolas, la gente necesita certificar su nivel de español. Teniendo información sobre la existencia de este diploma internacional, se alerta a aquellas personas interesadas hasta la próxima convocatoria. Esta ponencia tiene como objetivo analizar la situación de los exámenes DELE en Albania.

Palabras Clave: acreditación, Albania, convocatoria, DELE, examinador.

## Introducción

En el mundo hispano, los exámenes DELE se reconocen por parte de todos los docentes o aprendices de la lengua española. Pero, ¿qué información tienen los ciudadanos albaneses al respecto de los diplomas DELE? Inicio esta parte de la introducción con la información extraída por la página oficial del Instituto Cervantes para todos aquellos que quizás son principiantes del idioma o que acaban de expresar interés sobre el español y que pueden navegar y saber que los exámenes DELE son títulos oficiales de español como lengua extranjera, exactamente como se definen según <https://examenes.cervantes.es/es/dele/que-es>: “*los diplomas de español DELE son títulos oficiales, acreditativos del grado de competencia y dominio del idioma español, que otorga el Instituto Cervantes en nombre del Ministerio de Educación y Formación Profesional de España, y están diseñados siguiendo las directrices del Marco Común Europeo de Referencia (MCER) y el Manual para relacionar exámenes al MCER, ambas obras del Consejo de Europa*”.

No se puede hablar sobre tales exámenes en Albania sin mencionar el gran papel del Departamento de Lengua Española. El Departamento de Español es parte de la Facultad de Lenguas Extranjeras, en la Universidad de Tirana. Se trata de unos de los departamentos recién abiertos de la facultad a pesar que ya lleva 12 años de experiencia. Al principio de los años ´90, el español se ofrecía para los estudiantes como tercera lengua de selección como una asignatura optativa, mas allá como segunda lengua y sólo en 2008 se convirtió en primer idioma como carrera académica teniendo así su propio departamento. Los exámenes DELE se administran por parte del Instituto Cervantes de Roma en colaboración con la Embajada de España en Albania teniendo lugar en las aulas de la Facultad de Lenguas Extranjeras. Esto significa que a la fecha del examen, estos exámenes físicamente se desarrollan en las salas de la facultad siendo el centro examinador de DELE en Albania.

También se debe mencionar la existencia de “Casa de España en Tirana”, una asociación de la lengua y cultura española en Albania, que hoy en día no existe pero que sí ha sido activa especialmente durante los años 2011 hasta 2015. En realidad si nos referimos a la misma información que comparte esta asociación en su página web <https://sites.google.com/site/casadeespanaentirana/-quienes-somos> se dice que en ella: “*se han impartido clases de español desde los años noventa y se han organizado varias actividades culturales*”. Tuvo su gran éxito cuando fue centro examinador de los DELE, porque también se realizaban cursos preparatorios. Los interesados de aprender el idioma, mejorarla o perfeccionarlo ya tenían un lugar específico a dónde dirigirse, pero siempre refiriéndose a la ciudad de Tirana porque incluso hoy en día es casi imposible encontrar en otras regiones de Albania una asociación u organización que sea abierta hacia el idioma español y su difusión.

No por tanto, todas las unidades que tienen en enfoque este idioma, se encuentran muy unidas entre ellas siendo que comparten el mismo objetivo: difundir la lengua y

cultura española e hispana en Albania. Actualmente, se enumeran como activas de tal fin estas entidades: Embajada de España en Albania que es la representante oficial del Reino de España en la República de Albania; Departamento de Lengua Española en la Universidad de Tirana, siendo la única institución oficial de la educación superior de una carrera académica en el idioma español; Instituto de Lenguas Extranjeras “Asim Vokshi” que es una escuela pública de Educación Secundaria Obligatoria y que tiene un rama donde se estudia español durante 3 cursos académicos; y por último Colegio “Arcoíris” que es una escuela privada de educación primaria con orientación católica y que imparte español como lengua extranjera para los niños de esa edad.

También existen unas academias de lenguas en Tirana o en otras ciudades grandes como Durrës, Vlorë o Shkodër, que son academias privadas donde se enseña español como lengua extranjera pero hay que decir que el número de las personas interesadas apenas consigue formar un grupo de 3 a 5 inscritos. Mayormente se imparten clases particulares o individuales para los interesados. Tampoco puedes encontrar grupos de niños que expresan algún interés sobre el idioma, ni hay padres que opinan que en ese periodo de la vida de sus hijos tenga alguna importancia aprender el castellano pensando que el inglés y el italiano son dos idiomas indispensables del futuro.

Por ello, la situación de los exámenes DELE en Albania, se relaciona directamente con la necesidad de seguir los estudios en uno de los países hispanohablantes o conseguir un puesto de trabajo que sea relacionado con el ámbito del español. A continuación de esta ponencia, a través de unos datos se pretende ver qué ha sucedido con los DELE desde su primera convocatoria en Albania hasta la última, y cuál es la situación del momento con los examinadores DELE del país.

## 1. Análisis de los datos

Gracias a la colaboración con el Instituto Cervantes de Roma, en un intercambio de correos con el Sr. Raúl Alonso Alonso con función de Administrador del presente instituto, fue posible la obtención de unos datos exactos sobre el número de personas inscritas por año presentados en la siguiente tabla:

CDEX	2002	2003	2004	2005	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
ALBANIA	41	30	38	25	58	11	64	36	81	27	16	28	21	38	54	59	25

Y si pasamos estos datos en un gráfico, tendremos lo siguiente:



Echándole un vistazo, se puede ver que en el año 2006, en Albania no hubo convocatoria. El número más bajo de los inscritos se refiere al 2008 con solo 11 candidatos y el año 2011 es el más abundante con un total de 81 inscritos. Si nos regresamos al año 2002 cuando se realizó la primera convocatoria, se puede notar que el número 41 de inscritos parece ser un éxito de aquel entonces, siendo que la información sobre tales exámenes y diploma no era suficiente extensa como la que tenemos hoy en día, a pesar que si nos referimos al último año de este estudio, al 2019, se alcanza un total de 25 personas inscritas.

Si se pretende hacer un pequeño análisis e intentar saber el porqué de los resultados mencionados arriba, hay que decir que generalmente en Albania el español no se considera como “una lengua de trabajo”. El número de inversiones españolas en el país, no es tan alto como las inversiones italianas por ejemplo, y sobre inversiones latinas de países de habla hispana ni se puede hablar porque son casi inexistentes. Aunque no sea una afirmación oficial, se puede decir que el italiano y el inglés, son dos idiomas que cada ciudadano albanés tiene que dominar a la hora de conseguir un trabajo debido a las numerosas empresas italianas que operan en Albania.

En cambio, cuando se habla sobre el español, siempre existe una razón especial de las personas que expresan interés acerca del idioma. El español se estudia en Albania como una carrera universitaria en la Facultad de Lenguas Extranjeras o como una asignatura optativa en varias otras facultades públicas o privadas, pero hay que mencionar que en todo el país, existe solamente un departamento dedicado a la expansión de la lengua y cultura hispánica, y esto es el Departamento de la Lengua Española, mencionado en la

sesión de la introducción.

Los diplomas DELE son un instrumento muy útil para conseguir unas de las becas Erasmus. Los últimos años, gracias a los acuerdos bilaterales de la educación entre España y Albania, muchos estudiantes han obtenido becas del programa Erasmus que hacen posible el intercambio de los semestres del curso académico. Uno de los requisitos y una de las condiciones de ser becario y realizar por lo mínimo un semestre en una de las universidades españolas es tener certificado el nivel de la lengua española. Siendo que en Albania actualmente existe solo el DELE y todavía no se han implementado los exámenes SIELE (Servicio Internacional de Evaluación de la Lengua Española), entonces cada interesado de certificar el idioma debe someterse al DELE y sacar un apto por lo mínimo en B1. Desafortunadamente, en los datos del Instituto Cervantes de Roma, a la pregunta si existe alguna información sobre el número de los ciudadanos albaneses que sí han superado el examen, su edad o su formación, el administrador responde que “no guardamos estadísticas en función de edad, formación, etc.”.

## 2. Examinadores DELE

La Embajada de España en Albania juega un papel muy importante sobre la administración de los exámenes DELE. Junto con el Instituto Cervantes de Roma son responsables para que su desarrollo sea exitoso desde el día de la apertura de las inscripciones hasta el día oficial del examen y también de su entrega desde la ciudad de Tirana hasta la de Roma. Uno de los deberes de la embajada es nombrar los examinadores quienes van a dirigir los exámenes, especialmente la sección de la Expresión Oral para los candidatos que son sujeto de la prueba. Pero, ¿quiénes son los examinadores DELE? y ¿qué formación tienen que poseer?

Según el mismo sitio oficial del Instituto Cervantes <https://examenes.cervantes.es/es/dele/ser-examinador/acreditese>, “los examinadores DELE son aquellos profesores dependientes de los Institutos Cervantes o de las Consejerías de Educación, lectores de AECID (Agencia Española de Cooperación Internacional para el Desarrollo) u otros profesores de español que tienen una titulación universitaria y formación específica en enseñanza de español”. Además, el perfil adecuado de tal examinador es tener experiencia en la enseñanza del idioma. El Instituto Cervantes también aclara que: “para todos aquellos profesores no hispanohablantes es necesario tener un título de Filología Hispánica o contar con un Diploma DELE C1 (para participar en los exámenes de niveles A y B), o el mismo título pero contar con un Diploma DELE C2 (para participar en los exámenes de niveles C)”. De cualquier modo, el único requisito que no cambia y que es universal, es que cada examinador tenga el español como lengua materna o no, tiene que haber superado el curso correspondiente de acreditación del nivel que quiere ejercer como tal.

Para acreditarse como un examinador DELE, hay que saber que existen 4 cursos

en total de acreditación de los niveles correspondientes y que el interesado escoge el nivel que quiere que sea acreditado. Los cursos se desarrollan en formato presencial, semipresencial o en línea para que cada persona escoja la versión que más le convenga según el caso, y constan de unas 16 horas en total. Duran más o menos un mes y están diseñados y repartidos en la siguiente manera:

- Curso de acreditación de examinadores DELE A1 y A2
- Curso de acreditación de examinadores DELE A1-A2/B1 para escolares
- Curso de acreditación de examinadores DELE B1 y B2
- Curso de acreditación de examinadores DELE C1 y C2

Cada curso de formación específica tiene en enfoque la administración y calificación correcta de las pruebas del examen, especialmente a la sección de Expresión e Interacción Orales. Después de realizar con éxito el curso de acreditación, cada examinador recibe un código de acreditación que le identifica en la base de datos de examinadores DELE del Instituto Cervantes.

¿Qué sucede con tales examinadores en Albania? ¿Hay muchos? ¿Consiguen todos que sean activados en las convocatorias correspondientes? ¿Existen cursos preparatorios de DELE? y en caso afirmativo, ¿puede ser que un examinador sea el profesor que prepara los candidatos?

En realidad la Embajada de España en Albania tiene una base de datos de aquellos profesores que a pesar de ejercer su profesión de docente del idioma, son también examinadores DELE y que han superado con éxito el curso de acreditación del nivel. Ya que todos poseen un código único de examinador, la embajada tiene el derecho de nombrarlos cuando sea necesario y al momento que se abre la convocatoria. Hay que volver a decir, que en Albania se realiza solo la convocatoria del mayo debido al pequeño número de los interesados, provocando así un número menor de examinadores activados. El fin del año pasado, la embajada en colaboración con el Instituto Cervantes de Roma, les ofreció a los profesores activos del Departamento de Lengua Española un total de 8 becas para realizar el curso acreditativo de examinadores DELE, siendo los mismos profesores quienes podían escoger el nivel deseado. Cumpliendo todos los requisitos para ser examinadores, tales profesores realizaron en formato en línea el curso de acreditación empezando al mes de abril de 2020 y teniendo la formación cumplida a los principios del mes de mayo. Claro que debido a la situación actual mundial por causa de COVID-19, no hubo ninguna convocatoria el mayo pasado.

Al respecto de la cuestión de los cursos preparatorios de DELE, ni la Embajada de España en Albania ni la Facultad de Lenguas Extranjeras siendo el centro examinador, no organizan tales cursos. Es verdad que una de las direcciones del Instituto Cervantes es que el examinador no tiene que ser ni el profesor del candidato ni una persona de relaciones familiares o cercanas para evitar la desigualdad, pero claro que los profesores

acreditados y que son examinadores pueden impartir clases preparatorias a los candidatos pretendientes con la única condición de no participar en tal convocatoria como examinador. Así que, siendo examinador de DELE para un profesor se traduce en dos posibilidades: participar como examinador al día del examen, o ser profesor de los cursos preparatorios que significa más oportunidades de ser activo como tal. Desafortunadamente, en Albania todavía no se imparten cursos de preparación para los exámenes DELE. Claro que se pueden ofrecer tales cursos en las academias privadas en caso de que haya interesados, pero del momento no existen cursos preparatorios oficiales. En un futuro próximo, también gracias a las políticas gubernamentales entre los dos países, se espera un crecimiento de interés hacia la lengua española y que esto afecte positivamente y mejore la situación de los exámenes DELE en Albania.

## Conclusiones

Los ciudadanos albaneses tienen conocimientos sobre los diplomas DELE y saben su función y su validez, pero deciden defender su nivel de español solo cuando se trata del interés que tienen para obtener una beca Erasmus o realizar los estudios de Grado o Máster en una de las universidades españolas. También tienen prisa de someterse al examen cuando consiguen un buen trabajo al extranjero que requiere la obtención de un diploma DELE. El español en Albania no se considera como uno de los idiomas del futuro y tampoco de la actualidad, debido a las pocas inversiones españolas en el país.

Otro motivo es la inexistencia de los países de América Latina debido a la distancia geográfica también, haciendo lo suyo porque al contrario, si tales países estuviesen presentes con su economía en Albania, tendría mucho más interés sobre su lengua y cultura. La economía y educación son dos puntos clave de la existencia de una cultura en otro país.

Por otro lado, los examinadores DELE en Albania, no tienen muchas oportunidades de que ejerzan su profesión, siendo que desde la primera convocatoria en el año 2002 hasta al año 2019, en Albania se realiza solo una convocatoria al año debido al número bajo de los interesados. Tampoco se imparten cursos preparatorios de DELE quitando de tal manera otra oportunidad de ser un profesor examinador en activo.

Por todo ello, la situación de los exámenes DELE en Albania resulta ser en un proceso crítico, donde se realiza solo una convocatoria al año y el número de los inscritos cada vez es variable y no se puede decir que hay un aumento de los interesados en cada convocatoria con el paso de los años. La inexistencia de los cursos preparatorios de tales exámenes es un punto que se debe revisar por parte de la embajada o del Instituto Cervantes que incluso no tiene una sede suya establecida en Albania. Y por lo último,

siendo que con la existencia de las becas Erasmus se ve una tentativa de los jóvenes de aprender el idioma español y obtener el diploma DELE, el crecimiento de las inversiones españolas e hispánicas en Albania aumentaría el número de los interesados hacia la lengua española y su reconocimiento internacional.

#### SITOGRAFÍA

Siendo que la presente ponencia se refiere a un caso práctico y el tema de estudio más que teoría es un análisis del caso, refiriéndose a unos términos concretos se han utilizado fuentes de páginas oficiales en internet invitando a cada interesado de pincharlas para tener un acceso más fácil y rápido.

- [1] <https://examenes.cervantes.es/es/dele/que-es>
- [2] <https://sites.google.com/site/casadeespanaentirana/-quienes-somos>
- [3] <https://examenes.cervantes.es/es/dele/ser-examinador/acreditese>

LA POETIZACIÓN DE HISTORIA EN MARIANA PINEDA DE F. GARCÍA  
LORCA Y LA NOCHE DE GUERRA EN EL MUSEO DEL PRADO DE RAFAEL  
ALBERTI<sup>1</sup>

